

2019

Aktiviteti Institucional i FSHZH-së

RAPORT VJETOR

Programet e Investimeve

Realizimi Financiar

Projekte te reja

Auditi i Brendshëm

Monitorimi & Vlerësimi

Ndërtimi i Kapaciteteve

Komunikimi & Informimi



FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT
ALBANIAN DEVELOPMENT FUND

SHKURTIME

AB	Auditi i Brendshëm
BB	Banka Botërore
BERZH	Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim
BEI	Banka Europiane e Investimeve
CEB	Banka e Këshillit të Europës
DZHR	Departamenti i Zhvillimit Rajonal
FK	Fondi Kuvajtian
FS	Fondi Saudit
FSHZH	Fondi Shqiptar i Zhvillimit
FUZR	Furnzimi me Ujë e Zonave Rurale
FZHR	Fondi për Zhvillimin e Rajoneve
GoA	Government of Albania - Qeveria Shqiptare
IDA	Agjencia Ndërkombëtare për Zhvillim
IPA	Instrumenti i Ndhmës së Paraaderimit Assistance
IVR	Infrastruktura Vendore Rajonale
KD	Komiteti Drejtues
KfW	Banka Gjermane për Zhvillim
KZHR	Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MZHETTS	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregëtisë dhe Sipërmarrjes
NSPP	National Single Project Pipeline
NJQV	Njësitë e Qeverisjes Vendore
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
PBA	Projekt Buxheti Afatmesëm
PK	Punët në Komunitet
PKST	Plani Kombëtar Sektorial i Turizmit
POZHR	Programi Operacional për Zhvillimin Rajonal
QSH	Qeveria Shqiptare
ToR	Terma Reference
WBIF	Kuadri i Investimeve për Ballkanin Perëndimor (Western Balkans Investment Framework)

Pasqyra e lëndës

PËRMBLEDHJE.....	4
1. Programi i investimeve të Qeverisë Shqiptare	9
1.1 Infrastruktura Vendore Rajonale - Programi Operacional për Zhvillimin Rajonal	9
1.1.1 Infrastruktura Vendore Rajonale 2011 - 2013	10
1.1.2 Infrastruktura Vendore Rajonale 2014 - 2018	10
1.1.3 Infrastruktura Vendore Rajonale 2019 - 2021	11
1.2 Programi 100 Fshatrat.....	12
1.3 Projekti i Rehabilitimit të Segmenteve Rrugore Prioritare	13
1.4 Projekti i Investimeve Prioritare me impakt të lartë në zhvillimin dhe promovimin e turizmit, 2018 - 2019	14
1.5 Projekti “Pakti për Universitetin”	15
2. Programi Punët në Komunitet IV “Zhvillimi i Alpeve Shqiptare dhe Zonës Bregdetare”	16
3. Rikonstruksioni i rrugës së Lumit të Vlorës.....	17
4. Projekti për Zhvillimin e Integruar Urban dhe Turizmin (PZHIUT)	18
5. Programi i Rrugëve Lidhëse Rajonale.	24
6. Programi i Furnizimit me Ujë të Zonave Rurale	25
6.1“Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale III”.....	25
6.2“Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale IV”,	27
7. Programet e financuara nga IPA, Bashkimi Evropian.....	29
8. Përgatitja dhe aplikimi për programe të reja.....	45
8.1 Programi për Zhvillimin e Integruar të Zonave me Potencial Turistik	45
8.2 Projekti Porta bregdetare e Alpeve.....	45
8.3 Programi i investimeve për zhvillim të integruar rajonal	46
9. AKTIVITETI INSTITUCIONAL.....	47
9.1 Menaxhimi Financiar	47
9.2 Marrëdhëniet me Grupet e Interesit.....	56
9.3 Monitorimi dhe Vlerësimi	63
9.4 Auditimi i brendshëm.....	63
9.5 Burimet Njerëzore	65
9.6 Misione të donatorëve.....	68
10. AKTIVITETE TE TJERA	69
10.1 Agjencia Ekonomike Mbështetëse	69
10. ANEKSE	72
Aneks 1. Lista e objekteve që financohen në kuadër të Projektit Infrastruktura Vendore Rajonale 2019-2021 (Dhjetor 2019)	73
Aneks 2. Lista e segmenteve rrugore që financohen në kuadër të Projektit për Rehabilitimin e Segmenteve Rrugore Prioritare 2017-2019 (Dhjetor 2019).....	74
Aneks 3. Lista e objekteve të financuara nga Qeveria Shqiptare në kuadër të Projektit të Investimeve Prioritare me impakt të lartë në zhvillimin dhe promovimin e turizmit 2018 - 2019 (Dhjetor 2019).....	76
Aneks 4. Lista e objekteve të financuara nga Qeveria Shqiptare në kuadër të Projektit Pakti për Universitetin (Dhjetor 2019)	78
Aneks 5. Lista e objekteve të financuara nga Qeveria Shqiptare 2015-2016 (Dhjetor 2019)	78
Aneks 6. Informacion mbi nënprojektet e programit “Punët në Komunitet IV”, financuar nga CEB, Qeveria Shqiptare dhe NJQV-të përfituese (Dhjetor 2020)	79
Aneks 7. Informacion mbi projektin e Rrugës së Lumit të Vlorës Faza I, financuar nga Fondi Kuvajtian (Dhjetor 2019).....	80
Aneks 8. Informacion mbi Projektin për Zhvillimin e Integruar dhe Turizmin, financuar nga Banka Botërore (Dhjetor 2019).....	81
Aneks 9. Informacion mbi skemat e ujësjellësave të përgjedhur për përgatitjen e projekteve teknike në kuadër të programit “FUZR III”, financuar nga KfW, IPA 2013 dhe Qeveria Shqiptare (Dhjetor 2019).....	82
Aneks 10. Informacion mbi nënprojektet e programit “Rrugët Lidhëse Rajonale”, financuar nga BB, BERZH, Qeveria Shqiptare dhe NJQV-të përfituese (Dhjetor 2019)	83
Aneks 11. Realizimi i zërave të buxhetit për vitin 2019 (sipas Donatorëve - Lekë).....	84
Shpenzimet sipas Donatorëve dhe Kategorive për vitin 2019 (në Lekë)	87
Aneks 12. Objekte të financuara në kuadër të projektit “Punët në Komunitet IV”, të përfunduara gjatë periudhës 2016 - Dhjetor 2019	88
Aneks 13. Objekte të financuara në kuadër të projektit “Rehabilitimi i Segmenteve Rrugore Prioritare”, të përfunduara gjatë periudhës 2017 - Dhjetor 2019	91
Aneks 14. Objekte të financuara nga QSH në kuadër të Projektit të Investimeve Prioritare me impakt të lartë në zhvillimin dhe promovimin e turizmit 2018 - 2019, të përfunduara deri në Dhjetor 2019.....	98
Aneks 15. Objekte të financuara në kuadër të Projektit për Zhvillimin e Integruar Urban dhe Turizmin, të përfunduara deri në Dhjetor 2019	101
Aneks 16. Objekte të financuara në kuadër të Projektit për Rikonstruksionin e Rrugës së Lumit të Vlorës, të përfunduara deri në Dhjetor 2019	102
Aneks 17. Projekte në zbatim Dhjetor 2019.....	103

PËRMBLEDHJE

Viti 2019, shënon një sërë zhvillimesh të reja për Fondin Shqiptar të Zhvillimit si në aspektin organizativ, konceptual e menaxherial ashtu edhe në portofolin financiar.

Që nga muaji Janar 2019, FSHZH menaxhohet nga një trupë e re menaxheriale nën drejtimin e Z. Dritan Agolli, i cili me vendim të Këshillit Drejtues u emërua Drejtor Ekzekutiv i FSHZH. Këto ndryshime pritet të sjellin një stad të ri në aktivitetin 25 vjeçar të FSHZH duke e orientuar drejt zhvillimeve dhe perspektivave të reja të vendit.

FSHZH vijon të mbështesë Qeverinë Shqiptare për të përmbushur objektivat e saj për zhvillimin e integruar e harmonik të vendit duke përdorur të gjithë ekspertizën që ka në fushën e planifikimit dhe zbatimit të programeve rajonale në infrastrukturë, urbanizim, turizëm, bashkëpunim ndërkufitar, etj.

Gjatë vitit 2019, FSHZH nisi dhe vijoi procesin e integritit të investimeve në formatin e ndërhyrjeve rajonale, duke përmbyllur një masterplan të investimeve të ndarë sipas rajoneve, bazuar në potencialin zhvillimor të tyre. Ky proces orienton ndërhyrjet drejt zhvillimit si një funksion primar i institucionit.

Buxheti i rishikuar i FSHZH për vitin 2019 arrin në vlerën 14,633 milionë Lekë ose rreth 115 milionë Euro.

Buxheti i realizuar për vitin 2019 është në masën 90 %. Realizimi i buxhetit në këtë nivel është diktuar nga shkaqe objektive të lidhura kryesisht me maturimin e projekteve të reja si Infrastruktura Vendore Rajonale dhe 100 Fshatrat.

Tre janë drejtimet në të cilat FSHZH është angazhuar gjatë vitit 2019:

- Aplikimi i një qasjeje të re territoriale në konceptimin dhe zbatimin e projekteve;
- Konsolidimi i marrëdhënieve me Qeverinë Shqiptare dhe palët e tjera financuese, duke u fokusuar në plotësimin e pritshmërive të larta ndaj Fondit Shqiptar të Zhvillimit;
- Forcimi i imazhit publik të FSHZH si një institucion që udhëhiqet nga vlera themelore si profesionalizmi, përgjegjshmëria, integriteti, transparenca dhe që punon me përkushtim e seriozitet për të transformuar politikat e zhvillimit të Qeverisë në rezultate konkrete.

Gjatë vitit 2019 FSHZH ka menaxhuar 8 programe investimesh ose rreth 140 objekte të infrastrukturës dhe është duke iniciuar disa programe të reja.

Gjatë punës së tij për zbatimin e projekteve gjatë këtij viti, FSHZH ka pasur mbështetjen e plotë të Qeverisë Shqiptare dhe institucioneve financiare ndërkombëtare. Përmes financimeve të Qeverisë Shqiptare, Bankës Botërore, KfW, Bankës së Këshillit të Europës për Zhvillim, Fondit Kuvajtian, Fondi Saudit, etj, po mundësohen investime të rëndësishme në të gjithë vendin dhe me impakt të drejtpërdrejtë në jetën e banorëve.

Koordinimi shumë i mirë dhe bashkëpunimi konstant dhe transparent me partnerët në nivel qendror dhe lokal, konsiderohet një nga çelësat e suksesit të institucionit në performancën e këtij viti.

Në këtë raport paraqiten drejtimet kryesore të punës së FSHZH gjatë vitit 2019:

- Menaxhimi financiar;
- Ecuria e projekteve në zbatim;
- Përgatitja e projekteve të reja për financim;

Projekte aktuale

Programi investimeve të Qeverisë Shqiptare zë pjesën më të madhe të buxhetit të FSHZH për vitin 2019 me rreth 65 Milionë Euro.

Investimet e kryera nga Qeveria Shqiptare janë ndarë në disa projekte investimesh si Projekti për Rehabilitimin e Segmenteve Rrugore Prioritare, Projekti i Investimeve Prioritare me impakt të lartë në zhvillimin dhe promovimin e turizmit, Fondi i Zhvillimit të Rajoneve - Infrastruktura Vendore Rajonale dhe 100 Fshatrat, Pakti me Universitetin, etj.

Gjatë vitit 2019, investimet e kryera nga Qeveria Shqiptare në kuadër të **Projektit për Rehabilitimin e Segmenteve Rrugore Prioritare, dhe Projektit të Investimeve Prioritare me impakt të lartë në zhvillimin dhe promovimin e turizmit**, zënë peshën më të madhe të investimeve të kryera nga FSHZH. Ecuria e investimeve fizike ka qenë e kënaqshme dhe në fund të kësaj periudhe, rezulton se punimet civile kanë përfunduar në pjesën më të madhe të objekteve.

Rreth **19 milionë Euro** u akoduan nga Qeveria Shqiptare në kuadër të Programit **Infrastruktura Vendore Rajonale dhe Programit 100 Fshatrat**, në buxhetin e këtij viti.

Ndërkohë rreth 40 milionë Euro janë akorduar këtë vit nga Qeveria Shqiptare për **Rehabilitimin e Segmenteve Rrugore Prioritare, Investimeve Prioritare me impakt të lartë në zhvillimin dhe promovimin turizmit dhe ndërhyrje të tjera si Pakti me Universitetin, etj.**

Projekti për Rehabilitimin e Segmenteve Rrugore Prioritare ka nisur në fillim të vitit 2017 dhe parashikon ndërtimin e 180 kilometrave rrugë për një periudhë trevjeçare. Këto investime mundësojnë lidhjen me rrugë të standardeve europiane të dy ose më shumë rajoneve me njëri-tjetrin, duke përmirësuar lëvizjen në qendrat urbane përmes unazave të qyteteve dhe rrugëve hyrëse. Ecuria është kënaqshme dhe realizimi fizik i punimeve ka arritur në rreth 99 përqind. Punimet civile kanë përfunduar në 22 segmente rrugore dhe pjesa tjetër e rrugëve parashikohet të përfundojnë në vijim gjatë vitit 2020.

Projekti i Investimeve Prioritare me impakt të lartë në zhvillimin dhe promovimin e turizmit, filloi zbatimin gjatë vitit 2018. Financimi i tij erdhi si rezultat i ecurisë pozitive dhe performancës së lartë në menaxhim e objekteve të financuara nga Qeveria Shqiptare. Aktualisht punimet kanë përfunduar në 11 kontrata punimesh civile. Ndërkohë vijon puna në objektet e tjera, si Sheshi i Shirokës, Rehabilitimi i Lumit Gjanica dhe rikonceptimin e qendrës së qytetit të Fierit, etj.

Punë intensive është zhvilluar edhe për zbatimin e programit **për Zhvillimin e Alpeve Shqiptare dhe Zonës Bregdetare të vendit**, i cili mbështetet financiarisht nga CEB dhe Qeveria Shqiptare. Në kuadër të zbatimit të këtij projekti gjatë vitit 2019, ka vijuar puna për përgatitjen e procedurave të tenderimit, kontraktimit dhe

zbatimit të punimeve civile për 16 kontrata punimesh civile në Vlorë, Himarë, Gjirokastrë, Ulëz, Pukë, Valbonë, Tamarë, Vermosh.¹

Aktualisht kanë përfunduar punimet civile për 17 kontrata. Ndërkohë vijon puna në 3 objekte të tjera infrastrukturore.

Rruga e Lumit të Vlorës

Punimet për Lot I, kanë përfunduar dhe objekti është në garanci. Për Lot II, ka nisur në terren zbatimin e punimeve civile. Për Lotin e III-të është shpallur fituesi për punimet civile dhe kontrata parashikohet të lidhet sapo të mundësohet financimi gjatë këtij viti.

Financimi i Lotit IV të Projektit të Lumit të Vlorës, për momentin nuk është efektiv, dukë qënë se qëllimi që ka pasur ky segment, pra lidhja e dy rrugëve Levan - Tepelene - Gjirokastrë me Rrugën Vlorë - Sarandë, përmbushet nga projekte të tjera financuar nga Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD). Fondet e parashikuara për financimin e Lotit IV të Projektit të Rrugës së Lumit të Vlorës, do të përdoren për Projektin “Rikualifikimi i zonës bregdetare Uji i Ftohtë Vlorë -Orikum”, që përfaqëson një vazhdim në drejtim të Orikumit të Projektit “Lungo Mare” dhe që është konceptuar të shtrihet në 4 faza.

Projekti për Zhvillim të Integruar Urban dhe Turistik u bë zyrtarisht efektiv në fund të prillit 2017 dhe do të ketë një kohëzgjatje 5-vjeçare deri në Korrik të vitit 2022. Ai financohet nga Banka Botërore në vlerën 63.8 milionë Euro (me TVSH), dhe shtrihet në qendrat urbane të Sarandës, Gjirokastrës, Beratit, Përmetit si dhe përgjatë korridorit turistik që kalon në këtë rajon.

Aktualisht kanë përfunduar punimet për 4 objekte: Ndriçimin e rrugës hyrëse në Përmet, Rehabilitimin e rrugës këmbësore për në Kalanë e Beratit dhe pikës panoramike jugore të Kalasë së Beratit "Tabja", "Rehabilitimi i shkallareve të Shëtitores Naim Frashëri, Sarandë" dhe "Rehabilitimi i rrugëve me kalldrëm në Qafën e Pazarit". Njëkohësisht është kryer dorëzimi i pajisjeve teknologjike për Stacionin e Transferimit të Mbetjeve në Himarë. Ndërkohë vijon puna për zbatimin e objekteve të tjera dhe përgatitjen e projekteve teknike dhe dokumentacionit për tenderimin e punimeve civile.

Programi i Rrugëve Lidhëse Rajonale, parashikon ndërhyrje në rrjetin rrugor rajonal në zona me potencial bujqësor dhe turistik në të gjithë vendin. Ai bashkëfinancohet nga Banka Botërore dhe BERZH me vlerë të pritshme financimi rreth 100 milionë USD. Projekti është bërë efektiv gjatë vitit 2018 dhe do të ketë kohëzgjatje 5 vjeçare. Puna në terren ka nisur në 2 segmentet e para: Qafë Thore - Theth dhe Pogradec - Tushemisht Lot I. Ndërkohë është nënshkruar kontrata dhe janë gati për fillimin e punimeve segmentet rrugore Lekdush - Bënçë - Tepelenë Lot II dhe Gusmar - Kuç.

Projekti “Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale III”, parashikon ndërhyrje në shkallë të gjerë në të gjithë vendin. 18 nga skemat e miratuara kanë përfunduar fazën e projektimit gjatë vitit 2018, dhe janë në proces zbatimi.

Puna në terren për ndërtimin e ujësjellësave organizohet në Lot-e dhe ka filluar në Shkurt 2019 me Lotet I, II dhe në Maj 2019 për Lot IV. Lot III ka nisur zbatimin në Shtator 2019.

¹ Aneks 6. Informacion mbi nënprojektet e programit “Punët në Komunitet IV”, financuar nga CEB, Qeveria Shqiptare dhe NJQV-të përfituese (Dhjetor 2020)

FSHZH gjatë vitit 2019 ka vijuar zbatimin e **10 projekteve të financuara nga Programet CBC/Bashkëpunimit Ndërkufitar**. Projektet në total kanë një vlerë rreth 1.5 Milion Euro.

Programe të reja

Programi Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale IV, i cili parashikon ndërhyrje të plota në të gjithë sistemin e furnizimit me ujë dhe atë të ujërave të zeza, ndërtimin e një impianti për trajtimin e ujërave të zeza në Bashkinë Himarë dhe qytetin e Orikumit. Ai financohet nga KfW, WBIF, Qeveria Shqiptare, me vlerë financimi 45.15 milionë Euro. Projekti është bërë efektiv gjatë të vitit 2019 dhe do të ketë kohëzgjatje 5 vjeçare.

Programi për Zhvillimin e Integruar të Zonave me Potencial Turistik, parashikon investime strategjike rajonale në zonat me potencial turistik në Bashkinë e Shkodrës, Korçës, Fier, Berat. Projekti do të financohet nga BERZH dhe IPA me vlerë të pritshme financimi 100 milionë Euro. Ky projekt është në fazë programimi dhe parashikohet të ketë kohëzgjatje 4 vjeçare.

Projekti Porta e Alpeve

Projekti në vlerën 2.5 milion Euro, fokusohet në bashkitë Shkodër, Malësi e Madhe dhe Lezhë dhe specifikisht në zonën liqenore të Liqenit të Shkodrës, në fashën lumore të Bunës si dhe në bregdetin Adriatik të Velipojës dhe Shëngjinit. Projekti përfshin zonat urbane por gjithashtu edhe zonat natyrore dhe mjedisore të këtyre bashkive. Projekti "Gate of Alps" ka dy komponentë kryesorë: atë të studimit të integruar urban dhe turistik të zonës si dhe përgatitjen e projekteve teknike specifike për zonën.


"Programi i Investimeve për Zhvillim të Integruar Rajonal", i cili parashikon ndërhyrje infrastrukturore të integruara në funksion të nxitjes së zhvillimit ekonomik të zonave me potencial turistik. Programi bashkëfinancohet nga Qeveria Gjermane, dhe parashikohet që në fazën e parë të financohet përmes një kredie të butë të KfW deri në 50 milionë euro dhe bashkëfinancim nga Qeveria Shqiptare për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikqyrjen e projektit në vlerë deri në 1 milion euro.

Gjatë këtij viti, ka vijuar informimi publik përmes mediave vizive dhe atyre të shkruara, nëpërmjet së cilave është siguruar dhe njohja e gjerë e publikut me rezultatet e punës së FSHZH-së, si dhe aktivitetet në vijim.

Vlen për t'u theksuar se ka vijuar bashkëpunimi intensiv dhe i suksesshëm me ministritë e linjës dhe agjensitë shtetërore.

Paraqitja e projekteve sipas donatorëve dhe statusit të tyre Dhjetor 2019

Programi	Donatori	Totali	Projekte në fazën e përgatitjes së dokumentacionit	Në tenderim / vlerësim	Në kontraktim	Në zbatim	Projekte të përfunduara Në Garanci	Mbyllur / Dorëzuar
Qeveria Shqiptare 2014 - 2015 (FZHR)	QSH	1				1		
Qeveria Shqiptare IVR	QSH	25		2		23		
Qeveria Shqiptare investime 2016	QSH	2					2	
Rehabilitimi i segmenteve rrugore prioritare Qeveria Shqiptare 2017-2019	QSH	24				2	22	
Projekti i Investimeve Prioritare me impakt të lartë në zhvillimin dhe promovimin turizmit Qeveria Shqiptare 2018-2019	QSH	25	2		2	9	12	
Projekti "Rikonstruksioni i Godinave të Studentëve në Qytetet Shkodër, Elbasan, Korçë, Vlorë dhe Gjirokastër"	QSH	1					1	
Punët në Komunitet IV	CEB	20				3	13	4
Rehabilitimi i rrugës së Lumit të Vlorës	FK & FS	4	1		1	1	1	
Projekti për Zhvillimin e Integruar dhe Turizmin	BB	16	2		3	6	5	
Projekti i Rrugëve Lidhëse Rajonale	BB	5		1		4		
Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale III	KfW, IPA 2013, GoA	17				17		
TOTALI		140	5	3	6	66	56	4



1. Programi i investimeve të Qeverisë Shqiptare

Programi investimeve të Qeverisë Shqiptare zë pjesën më të madhe të buxhetit të FSHZH për vitin 2019 me rreth 65 Milionë Euro.

Programi ka për objektiv përmirësimin e kushteve të jetesës të banorëve në të gjithë vendin, rritjen e aksesit në shërbimet bazë, promovimin e turizmit dhe nxitjen e sektorit bujqësor, përmes financimit të projekteve të mëdha me ndikim rajonal. Investimet janë në perputhje të plotë me vizionin e Qeverisë Shqiptare për transformimin urban të qendrave të qyteteve dhe fshatrave, infrastrukturës rrugore dhe furnizimit me ujë, etj.

Ai përfshin projekte zhvillimore të fokusuara kryesisht në:

- Infrastrukturë rrugore dhe urbane;
- Furnizim me ujë të pijshëm dhe kanalizime;
- Mjedis;
- Projekte studimore, hapësinore, të trashëgimisë kulturore, etj;
- Hartim i projekteve teknike të gatshme për financim;

Investimet e kryera nga Qeveria Shqiptare janë ndarë në disa projekte investimesh si Projekti për Rehabilitimin e Segmenteve Rrugore Prioritare, Projekti i Investimeve Prioritare me impakt të lartë në zhvillimin dhe promovimin e turizmit, Fondi i Zhvillimit të Rajoneve - Infrastruktura Vendore Rajonale dhe 100 Fshatrat, Pakti me Universitetin, etj.

1.1 Infrastruktura Vendore Rajonale - Programi Operacional për Zhvillimin Rajonal

Zhvillimi rajonal është një nga prioritetet e Qeverisë Shqiptare për arritjen e objektivave strategjike të lidhura me rritjen e konkurrencës midis rajoneve përmes sigurimit të një zhvillimi të qëndrueshëm social-ekonomik të komuniteteve dhe krijimit të një ekonomie konkurruese dhe dinamike.

FSHZH, nisur nga qëllimi i veprimtarisë së tij, është fokusuar në vënien në zbatim të politikës së integruar të investimeve për zhvillimin e rajoneve dhe të potencialeve të tyre. Fondi për Zhvillim Rajonal, si një instrument financiar, financon projekte me ndikim lokal dhe rajonal.

Gjatë vitit 2019, FSHZH ka vijuar ndjekjen e financimit dhe zbatimit të objekteve të financuara nga IVR 2014-2018 dhe të trajtojë edhe detyrimet e prapambetura të grantit "Infrastruktura Vendore dhe Rajonale" për periudhën e financimit 2011-2013, Njëkohësisht janë administruar dhe vlerësuar projekt-propozimet për investime të reja për periudhën 2019-2021.

Në PBA 2019-2021, për komponentin Infrastruktura Vendore dhe Rajonale në total janë parashikuar 13 miliardë Lekë dhe nga ky fond 2.7 mld Lekë do të përdoren për likuidimin e objekteve në proces të periudhës 2014-2018 dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura financuar nga FZHR gjatë viteve 2011-2013.

1.1.1 Infrastruktura Vendore Rajonale 2011 - 2013

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, gjatë vitit 2019 vendosi në dispozicion të FSHZH listën me detyrimet e prapambetura mbi projektet e financuara nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve deri në vitin 2014.

Lista përmban 84 objekte, me vlerë rreth 1.43 miliardë Lekë.

Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura për projektet me burim financimi komponentin "Infrastruktura Vendore dhe Rajonale 2011-2013" të Fondit për Zhvillim e Rajoneve, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, bazuar në listën e objekteve të Ministrisë së Financave, u ka dërguar shkresë zyrtare të gjitha NJQV-ve për të sjellë pranë FSHZH-së të gjithë dokumentacionin tekniko-financiar në lidhje me objektet e kësaj periudhe:

- Kopje të kontratës së punimeve për objektin;
- Për objektet në proces: kopje të situacionit progresiv të punimeve, kopje të faturave tatimore, kopje të urdhër shpenzimeve të konfirmuar nga Dega e Thesarit;
- Për objektet e përfunduara: kopje të situacionit përfundimtar, kopje të faturave tatimore, kopje të urdhër shpenzimeve konfirmuar nga Dega e Thesarit, raportin e supervizorit për përfundimin e punimeve, akt kolaudimi, akt dorëzimi të përkohshëm dhe/ose përfundimtar të punimeve;
- Tabelën tekniko-financiare mbi përqindjen e realizimit të objektit dhe nevojës për fonde;

Mbështetur në informacionin e mbledhur, dhe verifikimit në terren që u është bërë objekteve nga stafi i FSHZH, gjatë vitit 2019, janë përgatitur dhe miratuar 4 rialokime të fondeve në vlerë totale 0.73 mld lekë.

Gjatë vitit 2019, është mbyllur procesi i financimit për 39 objekte. Procesi i shlyerjes së fondeve për objektet e tjera me detyrime të prapambetura do të jetë prioriteti kryesor i programit gjatë dy viteve të ardhshme.

1.1.2 Infrastruktura Vendore Rajonale 2014 - 2018

Gjatë muajve të parë të vitit 2019, FSHZH verifikoi statusin e investimeve në proces me burim financimi grantin "Infrastruktura Vendore dhe Rajonale 2014-2018" nga ish-Fondi i Zhvillimit të Rajoneve. Për këtë periudhë financimi, nga 49 objekte të verifikuar, 2 objekte kanë mbyllur procedurat e financimit në fund të vitit 2018 dhe 47 objekte ishin akoma në proces. FSHZH iu drejtua të gjitha institucioneve përfituese për të sjellë zyrtarisht informacion të detajuar për objektet në proces të kësaj periudhe.

Bazuar në informacionin e raportuar nga NJQV-të për ecurinë fizike dhe financiare të këtyre investimeve si edhe në verifikimin që është bërë nga stafi i FSHZH, gjatë vitit 2019 janë bërë 6 rialokime të fondeve me vlerë totale të rialokimeve 1.02 mld lekë.

Si rezultat i vështirësive që disa NJQV kanë patur për finalizimin e projekteve gjatë vitit 2019 dhe duke marrë në konsideratë afatet kohore të limituara të përdorimit të buxhetit, në mirëkuptim me NJQV-të është rënë dakort që të bëhet pakësim fondesh.

Me Aktin Normativ të Këshillit të Ministrave nr. 11 datë 24.12.2019 është bërë pakësimi i fondeve në vlerë 194,721,864 lekë. Deri me 31.12.2019, për këtë fashë investimi janë likuiduar 816,398,151 lekë dhe është mbyllur financimi për 29 objekte. Shlyerja e fondeve për objektet e tjera do të trajtohet me prioritet në buxhetin e vitit 2020 dhe 2021.

1.1.3 Infrastruktura Vendore Rajonale 2019 - 2021

Programi: "Infrastruktura Vendore dhe Rajonale 2019-2021" është bazuar në Programin Operacional për Zhvillimin Rajonal (POZHR). Ky është dokumenti kombëtar që orienton planifikimin e zhvillimit rajonal dhe të investimeve përkatëse në infrastrukturën vendore dhe rajonale. Ai është ndërtuar duke u mbështetur në katër drejtimet kryesore të zhvillimit rajonal:

- ndërhyrjeve urbane dhe mjedisore;
- ndërhyrjeve në funksion të zhvillimit ekonomik;
- investime në informacion dhe dije;
- ndërhyrjeve në infrastrukturën e shërbimeve publike.

POZHR paraqet drejtimet kryesore ku do të orientohen masat për financim nga fondi për Infrastruktura Vendore dhe Rajonale 2019 - 2021.

Programi IVR 2019-2021 është mbështetur gjerësisht në një politikë të integruar investimesh, duke marrë në konsideratë një analizë gjithëpërfshirëse të projekt-programeve që janë në proces dhe atyre që parashikohen të fillojnë së shpejti në të katër rajonet e vendit. Ai synon inkurajimin e rajoneve për të gjeneruar zhvillim duke vënë në përdorim burimet e tyre dhe duke konkuruar midis tyre.

FSHZH ka miratuar rregullat dhe kriteret e aplikimit për thirrjen e parë për aplikime 2019 dhe ka administruar kërkesat për financim në kuadër të kësaj thirrje në të cilën u ftuan të gjitha NJQV-të që të dërgojnë aplikime në përputhje me orientimet e qeverisë për zhvillimin e qendrueshëm rajonal dhe objektivat e thirrjes.

Objektivi i përgjithshëm i thirrjes realizohet përmes financimit të ndërhyrjeve për përmirësim të infrastrukturës dhe shërbimeve, rivitalizim urban dhe mjedisor dhe zhvillim ekonomik.

Vlerësimi dhe më pas kategorizimi i ndërhyrjeve zhvilluese sipas projekteve zhvillimore me qëllim përgatitjen e listës së projekteve të grupuara në lote sipas tipologjisë, territorit, etj është bazuar në:

- objektivat prioritare të thirrjes;
- prioritetet e shprehura në kërkesat e NJQV-ve;
- nevojat e identifikuara nga FSHZH gjatë ciklit të programimit operacional të Zhvillimit Rajonal;
- eksperiencën e krijuar në vite në lidhje me sfidat territoriale;
- programet dhe projektet e zbatuara, në zbatim dhe të planifikuara;
- qasjen e integruar të investimeve për të siguruar zhvillim rajonal të qëndrueshëm;

Me vendimet nr. 176 datë 16.05.2019 dhe nr. 184 datë 25.07.2019 të Këshillit Drejtues të Fondit Shqiptar të Zhvillimit janë miratuar ndërhyrjet zhvillimore në kuadër të Programit IVR 2019-2021 që arrijnë vlerën totale të 10.3 mld Lekë.

Janë përgatitur dhe firmosur marrëveshjet e investimit me NJVV-të përkatëse për 24 objekte. Në vijim të procesit të prokurimit dhe vlerësimit, janë buxhetizuar 13 projekte zhvillimore në vlerë totale 1,69 mld lekë.

Nga Programi Infrastruktura Vendore dhe Rajonale 2019-2021, gjatë vitit 2019 janë financuar 9 projekte zhvillimore për punime civile në vlerë totale 1,38 mld lekë.

- Ndërhyrje emergjente në funksion të investimeve me rëndësi kombëtare;
- Përmirësimi i aksesit në sitet turistike dhe lehtësimi i trafikut në zonat urbane në rajonet veriore;

- Përmirësimi i infrastrukturës rrugore në zonat turistike të rajonit qendror dhe lehtësimi i trafikut në zonat urbane të tij;
- Rivitalizimi urban i zonave me potencial të lartë turistik në Rajonin 3 dhe 4;
- Rivitalizimi urban dhe përmirësimi aksesit në zonat me aktivitetet bujqësor në rajonin 3;
- Përmirësimi i infrastrukturës rrugore në funksion të zhvillimit të turizmit dhe agroturizmit në Rajonin 4;
- Përmirësimi i aksesit në zonat me aktivitet të lartë bujqësor të Myzeqesë;
- Përmirësimi i shtresave rrugore;
- Përmirësimi i sigurisë rrugore dhe ndriçimit;
- Shërbime projektimi dhe oponente;
- Shërbime mbikqyrje dhe kolaudimi;
- Studime fizibiliteti, plane biznesi, zhvillimore, menaxhimi dhe veprimi, masterplane, ngritje kapacitetesh;

Deri në fund të vitit 2019, ka nisur zbatimi i punimeve civile në 12 nënprojekte të projekteve zhvillimore.

Duke marrë në konsideratë ecurinë e lidhjes së kontratave dhe fillimit të punimeve, me qëllim përdorimin me efikasitet të fondeve duke respektuar tavanet buxhetore, janë bërë pakësimet e fondeve të cilat janë përdorur për të financuar detyrimet e objekteve në proces nga IVR 2014-2018 dhe detyrimet e prapambetura nga IVR 2011-2013, si edhe për të përmbushur detyrimin e pakësimit të Aktit Normativ të Këshillit të Ministrave nr. 11 datë 24.12.2019. Fondet e rialokuara për vitin 2019 janë disbursuar në masën 99.2%.

***Aneks 1.** Lista e objekteve që financohen në kuadër të Projektit Infrastruktura Vendore Rajonale 2019-2021 (Dhjetor 2019)*

1.2 Programi 100 Fshatrat

Programi kombëtar “100+ Fshatrat” është programi i integruar i zhvillimit të 100+ fshatrave, duke i dhënë mundësi fshatit shqiptar të ketë një trend pozitiv zhvillimi ekonomik, të diversifikuar dhe të qëndrueshëm duke koordinuar ndërhyrjet zhvillimore në hapësirën rurale të 100+ fshatrave në Republikën e Shqipërisë.

Ky program do të ndihmojë në ruajtjen dhe përmirësimin e strukturës shoqërore dhe ekonomike, në veçanti në zonat më të largëta rurale të cilat ballafaqohen me depopullim. Nxitja e investimeve në një ekonomi më të gjerë rurale dhe në komunitetet rurale janë jetësore për të rritur cilësinë e jetës në zonat rurale, nëpërmjet qasjes së përmirësuar në shërbimet dhe infrastrukturën bazë dhe në një mjedis më të mirë.

Kthimi i zonave rurale në atraksione tërheqëse gjithashtu kërkon nxitjen e rritjes së qëndrueshme dhe krijimin e mundësive të reja të punësimit, veçanërisht për të rinjtë dhe gratë, si dhe lehtësimin e qasjes në teknologjitë e reja të informacionit dhe komunikimit.

Diversifikimi në fermë drejt aktiviteteve jobujqësore, asistencë për aktivitetet jashtë fermave dhe forcimi i lidhjeve mes bujqësisë dhe sektorëve të tjerë të ekonomisë rurale luajnë një rol të rëndësishëm në këtë.

Fondi Shqiptar i zhvillimit është ngarkuar nga Qeveria Shqiptare për formëzimin e këtij programi si dhe zbatimin e fazës pilot që synon të krijojë modele të zhvillimit të fshatit bazuar mbi burimet natyrore dhe njerëzore si dhe qëndrueshmërinë afatgjatë të zhvillimit.

Gjatë këtij viti është analizuar rezultati i studimeve të përgatitura nga Akademia 100 fshatrat, duke identifikuar projektet, idetë me potencial si dhe janë analizuar pikëprerjet me ndërhyrjet e tjera që po zbatohen nga FSHZH apo institucione të tjera në zonë. Procesi i programimit dhe identifikimit të ndërhyrjeve potenciale do të vazhdojë edhe muajt në vijim, për të përfunduar në modelet zhvillimore dhe ndërhyrjet konkrete në territor.

1.3 Projekti i Rehabilitimit të Segmenteve Rrugore Prioritare

Projekti i Rehabilitimit të Segmenteve Rrugore Prioritare, ka nisur gjatë vitit 2016 dhe parashikohet të përfundojë gjatë vitit 2020. Gjatë vitit 2016, FSHZH në vijim të diskutimeve me Qeverinë Shqiptare ndërmori procesin e identifikimit dhe vlerësimit të segmenteve rrugore prioritare me impakt të lartë në zhvillimin ekonomik me objektiv përmirësimin e infrastrukturës rrugore.

Me qëllim identifikimin e segmenteve rrugore prioritare me impakt të lartë në zhvillimin ekonomik të vendit dhe detajimin e një liste investimesh prioritare për periudhën 2017 - 2019, u analizuan kërkesat që kanë ardhur pranë FSHZH-së dhe FZHR-së nga bashkitë, qarqet, përfaqësuesit e mandatuar të komuniteteve, databaza për rrugët që ka ngritur FSHZH në kuadër të Programit të “Rrugëve Dytësore dhe Lokale”, financuar nga donatorë të ndryshëm (IDA, CEB, OPEC, IDB, KfW, BERZH, BEI, IPA 2009/10/11) si dhe verifikimet në terren nga inxhinierët e FSHZH-së në segmentet rrugore prioritare dhe plotësimi i skedave individuale.

Pas hartimit të listës paraprake të investimeve, procesi vijoi me përcaktimin e segmenteve prioritare, bazuar në numrin e përfituesve, shkallën e degradimit të rrugës, rëndësinë e qarkullimit të mjeteve në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal, akse rrugore të gatshme dhe pa probleme pronësie, kosto paraprake investimi, lidhja me një rrugë tjetër në gjendje të mirë.

Kjo listë përmban 20 segmente rrugore me vlerë të përafërt rreth 9.5 miliardë lekë, si:

- Cërrik - Belsh - Kuçovë - Ura Vajgurore;
- Harku i Bërdicës - Kryqëzimi Baks;
- Unaza Pogradec - Qafë Pllaçë;
- Unaza e Peshkopisë;
- Fushë Arrëz - Rreps (Rruga e Kombit);
- Fushë Krujë - Thumanë (aksi i vjetër);
- Shëtitorja në Golem (Mak Albania);
- Hyrja e Bajram Currit;
- Hyrjet e Rogozhinës, etj.

Pas miratimit në Këshillin Drejtues dhe Ministrinë e Financave, u krye një punë intensive për plotësimin dhe standartizimin e projekteve teknike dhe shpalljen e procedurave të prokurimit.

Për vetë specifikën dhe rëndësinë e tyre akset, Cërrik-Belsh-Kuçovë-Ura Vajgurore dhe segmenti Harku i Bërdicës - Baks, janë ndarë me nga tre lote.

Ecuria e punimeve ka qënë e kënaqshme dhe realizimi fizik i punimeve në terren deri në fund të vitit 2019 është në masën 99%.

Punimet kanë përfunduar për 22 kontrata të cilat janë në periudhën e garancisë:

- Segmenti rrugor Grekan - Dragot, pjesë e aksit Cërrik - Belsh - Kuçovë - Ura Vajgurore;
- Segmenti rrugor Cërrik - Belsh - Grekan, pjesë e aksit Cërrik - Belsh - Kuçovë - Ura Vajgurore;
- Rikonstruksioni i rrugës së Velipojës: Seg Harku i Bërdicës - Baks Loti II;

- Rikonstruksioni i rrugës së Velipojës: Seg Harku i Berdicës - Baks Loti III;
- Ndërtimi Unaza e re Peshkopi;
- Rruga Fushë Arrëz - Repts;
- Rikonstruksioni i rrugës Fushë Krujë - Thumanë;
- Rikonstruksioni i 3 rrugëve hyrëse të qytetit të Rogozhinës;
- Rruga Gradishtë - Spolatë;
- Rruga Mërtish - Tre Urat;
- Rikonstruksioni i rrugës hyrëse të qytetit Bajram Curri;
- Unaza e Vaut të Dejës;
- Rruga Taulantët në Universitetin Bujqësor të Tiranës;
- Rruga Gërmenj - Okshtun - Zambishtë;
- Rikonstruksioni i rrugës Ura e Çopanit - Zhabiak - Ura e Çorumit;
- Rikonstruksioni i rrugës Lalëz - Bizë - Draç;
- Rikonstruksioni i rrugëve 2,3,4 dhe paralele në Golem;
- Ndërtimi Shetitores Mak Albania-Pusi Nr.1 dhe rikonstruksioni i Kanalit KK1(pjesa fundore);
- Rikonstruksioni i rrugës Kastriot - Arras;
- Sistemim, asfaltim rruga Qafë Plloçë - Pogradec dhe Unaza Pogradec;
- Rikonstruksioni i rrugës Korçë - Voskop - Polenë - Korçë;
- Rikonstruksioni i rrugës Borje - Kufi;

Vijon puna në 2 segmente të tjera rrugore:

- Segmenti Dragot - Kozarë - Kuçovë - Ura Vajguore, pjesë e aksit Cërrik - Belsh - Kuçovë - Ura Vajguore;
- Rikonstruksioni i rrugës së Velipojës: Segmenti Harku i Berdicës - Baks Loti I;

Në këto segmente parashikohet që punimet të përfundojnë gjatë tremujorit të parë të vitit 2020.

Aneks 2. Lista e segmenteve rrugore që financohen në kuadër të Projektit për Rehabilitimin e Segmenteve Rrugore Prioritare 2017-2019 (Dhjetor 2019)

1.4 Projekti i Investimeve Prioritare me impakt të lartë në zhvillimin dhe promovimin e turizmit, 2018 - 2019

Si rezultat i ecurisë pozitive dhe performancës së lartë në menaxhimin me sukses të objekteve të financuara në vitin 2017, Fondi Shqiptar i Zhvillimit vazhdoi procesin e identifikimit dhe seleksionit të projekteve të tjera me impakt të lartë në zhvillimin dhe promovimin e turizmit. Për këtë projekt Qeveria Shqiptare ka akorduar një financim prej rreth 7.2 miliardë Lekë.

Aktualisht kanë përfunduar punimet për:

- Asfaltimin e rrugës Kryqëzimi Shëngjin - qyteti Shëngjin - Porti Ushtarak;
- Tepelenë - Bençë - Lekdush punime shtesë;
- Rikonstruksionin e rrugës Agim - Babunjë, Bashkia Divjakë;
- Rikonstruksionin e rrugës së Beratit (Segmenti Ish Fabrika Plasmasit - Karbunarë);
- Rrugën Qendër Gosë - Hekurudha - Gosë e Madhe, Bashkia Rogozhinë;
- Rikonstruksionin e Rrugës Ramize Gjebra Faza II, (Lidhja e rrugës së Pyllit të Sodës me rrugën Transballkanike dhe Autostradën);
- Bulevardi i Vlorës, faza II;
- Rikonstruksioni/rikualifikimi urban pranë qendrës së qytetit Vlorë, Zona B drejtim i rrugës Justin Godart;
- Rikonstruksioni i rrugëve të brendshme dhe rikualifikimi i hapësirave publike tek zona e plazhit të Shkëmbi i Kavajës;
- Rivitalizim urban, Bulevardi Maliq - Drithas;

- Ndërtimi i stacionit të pompimit, Depos 50m³ dhe rrjetit elektrik TU dhe TM për furnizimin e depos 2,000 m³ të Lugut të Dardhës, Sarandë;

Ndërkohë vijon puna për objektet:

- Rikonstruksioni i sheshit të Shirokës;
- Rehabilitimi i Lumit Gjanica dhe rikonceptimi i qendrës së qytetit të Fierit;
- Ndërtimi i Pedonales dhe Korsisë së Bëçkuletave te Liqeni Belshit, Faza III;
- Ndërtimi i sheshit të Roskovecit;
- Rikonstruksioni i Unazës Bujqësore të Myzeqesë: Segmentet Rrethrotullim Imësht - Ngurrëz, Fier i Ri - Kashtbardh, Qerret - Kadiaj - Savër;
- Ndërtim i Urës Zezë dhe mbrojtje nga përmytjet qyteti Fushë-Krujë;
- Rikonstruksioni i rrugës Balldre - Bend;
- Rikonstruksioni i Shëtitorës Taulantia, Durrës;
- Ndërtim i Depos dhe rrjetit Shpërndarës të ujësjellësit të Grabianit;

Gati për fillim punimesh, në pritje të kryerjes së shpronësimeve:

- Rikualifikim i Parkut Industrial Kuçovë;

Ka përfunduar hartimi i projekteve teknike për 2 kontrata:

- Projektim i Zonës së Plazhit Durrës;
- Projektim i rikualifikimit urban pranë Qendrës së qytetit Vlorë "Zona A drejtimi i Kullës së Sahatit;

Kontrata për Rikonstruksionin e rrugës aksi Nacional Luftinjë (Faza I - Rruga e Izvorit), Njësia Administrative Luftinjë, nuk do të financohet në kuadër të zbatimit të këtij projekti, por parashikohet të financohet nga programi Infrastruktura Vendore Rajonale, financuar nga Qeveria Shqiptare.

Aneks 3. Lista e objekteve të financuara nga Qeveria Shqiptare në kuadër të Projektit të Investimeve Prioritare me impakt të lartë në zhvillimin dhe promovimin e turizmit 2018 - 2019 (Dhjetor 2019)

1.5 Projekti “Pakti për Universitetin”

Në zbatim të vendimit nr.372, datë 29.05.2019, për “Financimin e Projektit “Rikonstruksioni i Godinave të Studenteve në Qytetet Shkodër, Korçë, Vlorë”, Fondi Shqiptar i Zhvillimit u përcaktua si Autoriteti Kontraktues, dhe përfitues do të jenë Ndërmarrjet e Trajtimit të Studenteve. Fondi Shqiptar i Zhvillimit, kontrollon projektet teknike, përgatiti dokumentacionin dhe shpalli procedurat e prokurimit për: Rikonstruksionin e godinave të konvikteve të studentëve në qytetet Shkodër (Godina nr.2), Vlorë (Konvikti i vajzave), Korçë (Godina nr.1)”. Punimet në këto godina kanë përfunduar në fund të muajit Dhjetor 2019.

Aneks 4. Lista e objekteve të financuara nga Qeveria Shqiptare në kuadër të Projektit Pakti për Universitetin (Dhjetor 2019)

Prokurimi

Procedurat e prokurimit për financimet nga Qeveria Shqiptare janë kryer në përputhje me Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar dhe akteve ligjore e nënligjore që rregullojnë veprimtaritë përkatëse.

2. Programi Punët në Komunitet IV “Zhvillimi i Alpeve Shqiptare dhe Zonës Bregdetare”

Objektivi i projektit “Punët në Komunitet IV - Zhvillimi i Alpeve Shqiptare dhe Zonës Bregdetare”, është nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm social-ekonomik në komunitetet me potencial të lartë turistik, nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës së integruar publike duke respektuar mjedisin dhe ruajtur trashëgiminë kulturore dhe historike.

Komponentët e projektit janë:

- investime në infrastrukturë dhe shërbimet lokale publike (rikualifikim urban e rrugë, ujësjellës-kanalizime, menaxhim i mbetjeve urbane, etj);
- asistencë teknike & ngritje kapacitetesh (studime fizibiliteti, përgatitje strategjish lokale, hartim projektesh, trajnime).

Projekti me vlerë 36.7 milionë Euro bashkëfinancohet nga Banka për Zhvillim e Këshillit të Europës (CEB), Qeveria Shqiptare dhe NJQV-të përfituese, WBIF.

Burimet e financimit përfshijnë 28.7 milionë euro kredi nga CEB, 1 milion Euro grant nga CEB Social Dividend Account (SDA), një kontribut 6 milionë Euro nga Qeveria e Shqipërisë dhe NJQV përfituese, si dhe një 1 milion Euro grant nga WBIF.

Marrëveshja e financimit midis Qeverisë Shqiptare dhe CEB për këtë projekt është firmosur në datë 21 Maj 2015 dhe është ratifikuar nga Parlamenti në datë 2 Korrik 2015. Projekti ka filluar nga puna në gjashtëmuorin e dytë të vitit 2015 dhe duhet të përfundonte në shtator 2019. Duke marrë në konsideratë problematikat sociale të hasura gjatë zbatimit të projektit në zonën bregdetare të Jugut, data e përfundimit të projektit është shtyrë me 1 vit deri në shtator 2020.

Përsa i përket komponentit të investimeve në infrastrukturë, kanë përfunduar punimet civile për:

- Rikonstruksionin e rrugës së Ulzës;
- Restaurimin e fasadave dhe rikualifikimin e qendrës Gjirokastër;
- Ndërtimin e qendrës së turizmit Valbonë;
- Rikualifikimin urban të Tamarës (faza II) dhe rikonstruksionin e rrugës së Vermoshit;
- Rikualifikimin urban dhe mjedisor të qendrës dhe Liqenit të Pukës, Fazat I & II;
- Rikualifikimi urban në Bashkinë Himarë, Fazat I & II;
- Rigjenerimin urban të zonave bregdetare në fshatrat Jalë dhe Dhërmi;
- Rikualifikimin urban në fshatin Dhërmi;
- Rikualifikimin urban në fshatin Vuno;
- Rikonstruksionin e rrugës së Kaninës;
- Rikualifikimin urban në Bashkinë Vlorë, fazat I & II;
- Rikonstruksionin e rrugës Port - Pylli i Sodës;
- Rikonstruksionin e Bulevardit ‘Ismail Qemali’;
- Rikonstruksioni i sistemit të kullimit të ujërave të shiut në zonën e lagjeve Hajro Çakëri, 4 Heronjtë, 28 Nëntori, Vlorë;

Vijon puna për zbatimin e punimeve civile në terren për:

- Rikualifikimi urban dhe ndërtimi i qendrës turizmit në Vermosh;
- Ndërtimi i qendrës së urgjencës Palasë, rehabilitimi i përroit dhe zonës së parkimit në fshatin Dhërmi;
- Rehabilitimi i fasadave përgjatë Bulevardit të Vlorës;

Për të gjitha objektet që janë në fazë zbatimi kanë përfunduar procedurat e tenderimit dhe janë lidhur kontratat për supervizionin e punimeve. FSHZH është angazhuar maksimalisht që punimet të përfundojnë brenda afateve të kontratave respektive. Sezoni turistik 2019, i gjeti këto zona me infrastrukturë të transformuar.

Përsa i përket komponentit të asistencës teknike dhe ngritjes së kapaciteteve, po punohet për realizimin e disa studimeve dhe organizimin e trajnimeve për Njësitë e Qeverisjes Vendore, në territorin e zbatimit të projektit.

Prokurimi

Gjatë vitit 2019 është proceduar me përmbylljen e 14 procedurave prokurimi në total, 5 nga të cilat janë objekte punë civile të lidhura me investime. Procedurat e prokurimit janë kryer në mbështetje të rregullores respektive që Banka për Zhvillim e Këshillit të Europës (CEB) ka në fuqi.

Aneks 6. Informacion mbi nënprojektet e programit "Punët në Komunitet IV", financuar nga CEB, Qeveria Shqiptare dhe NJQV-të përfituese (Dhjetor 2020);

3. Rikonstruksioni i rrugës së Lumit të Vlorës

Projekti parashikon ti japë zgjidhje të qëndrueshme infrastrukturës publike në zonën e Bregdetit të Jugut, specifikiisht në zonën e Lumit të Vlorës, duke kontribuar në përmirësimin e kushteve të jetesës për vendasit dhe ridimensionim e sektorit të turizmit si një nga shtyllat kryesore të ekonomisë lokale dhe rajonale.

Infrastruktura publike aktualisht nuk favorizon zhvillimin e ekonomisë dhe nuk ofron shërbime optimale për popullsinë vendase dhe turistët që frekuentojnë këtë zonë.

Projekti ka si qëllim rikonstruksionin e rrugës së Lumit të Vlorës, e cila përveç lidhjes së kësaj zone me bregdetin jonian dhe rivierën shqiptare, përmes lotit të IV-të, do të mundësojë lidhjen e dy rrugëve nacionale (SH4-SH8).

Rruga e Lumit të Vlorës ka një gjatësi prej rreth 90.4 km.

Financues të projektit janë Fondin Kuvajtian me 40 milionë USD, Fondi Saudit për rreth 30 milionë USD dhe Qeveria Shqiptare, që pas rialokimit të fondit rezervë nga marrëveshja me Fondin Kuvajtian bashkë-financon me rreth 11.17 milionë USD, për zbatimin e projektit (punimet civile dhe konsulenca) dhe me një vlerë të TVSH prej 16.23 milionë USD. Projekti ka filluar në vitin 2017 dhe parashikohet të përfundojë në vitin 2022.

Gjatë vitit 2016, u evidentuan të gjitha hapat e duhura për hartimin e grafikut të realizimit të projektit dhe përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm. Fillimisht u punua me përgatitjen e termave të referencës për Supervizionin e Punimeve.

Kontrata për Lotin I, By Pass Vlorë - Peshkëpi - Gjorm, me gjatësi 23.2 km është lidhur më 24 shkurt 2017. Punimet civile kanë filluar në mars 2017 dhe kanë përfunduar në 29 qershor 2019. Objekti është në garanci punimesh.

Kontrata e punimeve për Lotin II, Gjorm - Brataj - Ura e Laskos është lidhur me 17 prill 2019 dhe punimet kanë filluar në 13 Maj 2019. Ka përfunduar mobilizimi dhe ngritja e kantierit dhe puna vijon normalisht.

Për Lotin e III-të; Ura e Laskos - Kuç dhe Ura e Laskos - është shpallur fituesi për kontratën e punimeve civile. Ndërkohë që parashikohet të lidhet sapo të mundësohet financimi gjatë këtij viti.

Është përzgjedhur mbikëqyrësi i punimeve për financimin e Fondit Kuvajtian. Supervizori është prezent në terren për mbikëqyrjen e punimeve të kryera dhe rishikimin e projekteve teknike për Lot-et I, II dhe III.

Fondi Saudit për Zhvillim financon me 30 milionë USD pjesën e dytë të rrugës së Lumit të Vlorës, e cila lidh fshatin Peshkëpi me Selenicën dhe bashkohet me kryqëzimin e autostradës Levan - Tepelenë, duke plotësuar kështu të gjithë financimin e nevojshëm për ndërtimin e rrugës.

Pas firmosjes së marrëveshjes së këtij investimi në Maj 2017, është lidhur kontrata me supervizionin për Lot IV. Kontrata e supervizionit të punimeve parashikon rishikimin e projektit dhe preventivin, duke bërë përmirësimet e nevojshme në përshtatje me kushtet në terren. Rishikimi i projektit teknik ka përfunduar dhe është dorëzuar pranë FSHZH.

Financimi i Lotit IV të Projektit të Lumit të Vlorës, për momentin nuk është efektiv, dukë qënë se qëllimi që ka pasur ky segment, pra lidhja e dy rrugëve Levan - Tepelene - Gjirokastër me Rrugën Vlorë - Sarandë, përmbushet nga projekte të tjera financuar nga Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), projekte të cilat janë në një fazë më të avancuar. Fondet e parashikuara për financimin e Lotit IV të Projektit të Rrugës së Lumit të Vlorës, do të përdoren për Projektin “Rikualifikimi i zonës bregdetare Uji i Ftohtë Vlorë -Orikum”, që përfaqëson një vazhdim në drejtim të Orikumit të Projektit “Lungo Mare” dhe që është konceptuar të shtrihet në 4 faza.

Aneks 7. Informacion mbi projektin e Rrugës së Lumit të Vlorës Faza I, financuar nga Fondi Kuvajtian (Dhjetor 2019);

4. Projekti për Zhvillimin e Integruar Urban dhe Turizmin (PZHIUT)

Prej fillimit të vitit 2016, FSHZH në bashkëpunim me Ministrinë e Zhvillimit Urban, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, ka zhvilluar një aktivitet intensiv konsultimi, organizimi dhe planifikimi për përgatitjen e Projektit për Zhvillimin e Integruar Urban dhe Turizmin, i cili financon nga Banka Botërore në vlerën 63.8 milionë Euro (me TVSH).

Projekti u bë zyrtarisht efektiv në fund të prillit 2017 dhe ka një kohëzgjatje 5 vjeçare deri në Korrik 2022. Ai shtrihet në qendrat urbane të Sarandës, Gjirokastrës, Beratit, Përmetit dhe përgjatë korridorit turistik që kalon në këtë rajon. Nga ky projekt parashikohet të përfitojnë 84 mijë banorë dhe rreth 300 mijë turistë.

Objektivi i projektit është përmirësimi i infrastrukturës urbane, nxitja e turizmit dhe forcimi i kapaciteteve institucionale për të mbështetur turizmin dhe zhvillimin e ekonomisë lokale në zonat e përzgjedhura në jug të Shqipërisë.

Puna për zbatimin e projektit është e organizuar sipas tre komponentëve kryesorë.

Komponenti 1. Projektimi urban dhe përmirësimi i infrastrukturës (44.3 milionë Euro) i cili financon hartimin e projekteve për zbatimin e projektimit urban dhe investime për përmirësimet e infrastrukturës bashkiake në katër qendrat urbane: Saranda, Gjirokastra, Berati dhe Përmeti.

Investimet në këto bashki të përzgjedhura përfshijnë rehabilitimin e hapësirave publike (psh, parqe, sheshe, pedonale), rrjet rrugor, nyje inter-modale dhe infrastrukturë shoqëruese (p.sh, trotualet, kryqëzimet rrugore, ndriçimet rrugore, korsitë e biçikletave, stacionet e autobusëve); restaurimin e ndërtesave të përzgjedhura të trashëgimisë dhe përmirësimin e fasadave të ndërtesave të zgjedhura dhe përmirësimin e zonave turistike (p.sh. rrugët hyrëse, qendrat e vizitorëve, vendparkimet, sinjalistikë turistike). Ky komponent do të financojë gjithashtu përgatitjen e projekteve urbane, studimeve të fizibilitetit, projekteve inxhinierike dhe supervizimin e projekteve ndërtimore. Infrastruktura nëntokësore do të përfshihet si pjesë e përmirësimit të rrjetit rrugor, kur të jetë e nevojshme.

Komponenti 2. Përmirësimi i siteve turistike (8.4 milionë Euro), financon investime që kanë për qëllim përmirësimin e siteve turistike të përzgjidhura përgjatë korridorit turistik në Shqipërinë e Jugut.

Investimet përfshijnë restaurimin e objekteve të trashëgimisë dhe aseteve kulturore, përmirësimin e infrastrukturës mbështetëse. Ky komponent do të financojë gjithashtu përgatitjen e studimeve të fizibilitetit, planet e menaxhimit të siteve, projektet inxhinierike dhe supervizimin e projekteve ndërtimore.

Komponenti 3. Tregu i turizmit dhe zhvillimi i produkteve (7.7 milionë Euro), financon aktivitetet për përmirësimin e menaxhimit bashkiak dhe ofrimin e shërbimeve, si dhe zhvillimin e zinxhirit të vlerës. Ky komponent është i ndarë në dy komponentë plotësues:

- a) Mbështetja në ofrimin e shërbimeve bashkiake. Ky nënkomponent financon:
 - (i) aktivitetet që synojnë përmirësimin e ofrimit të shërbimeve dhe menaxhimin bashkiak në bashkitë në zonën e projektit. Aktivitetet përfshijnë asistencë teknike dhe mjete për menaxhimin e përmirësuar bashkiak (për shëmbull, sistemet e menaxhimit të aseteve dhe GIS).
 - (ii) asistencën teknike që synon përmirësimin e ofrimit të shërbimeve (për shëmbull: studimet e menaxhimit të trafikut) dhe rritjen e funksionimit të aseteve të rehabilituara në kuadër të projektit dhe pajisjeve të zgjedhura (p.sh. grumbullimin e mbetjeve të ngurta).
- b) Zhvillimi i produkteve turistike dhe zinxhirit të vlerës. Ky nënkomponent financon:
 - (i) kërkimin e tregut për të udhëhequr aktivitetet e zhvillimit të produktit;
 - (ii) aktivitetet që mbështesin krijimin e partneriteteve për menaxhimin e destinacionit në nivel bashkiak dhe rajonal;
 - (iii) zhvillimin e së paku 20 produkteve të reja turistike në zonën e projektit dhe,
 - (iv) krijimin e një sistemi të statistikave kombëtare të turizmit;

Gjatë kësaj periudhe FSHZH ka punuar intensivisht me ekipin e Bankës Botërore Njësitë e Qeverisjes Vendore dhe MZHU me qëllim realizimin e objektivave të zbatimit të projektit.

Përsa i përket komponentit të parë vlen të theksohet se kanë përfunduar punimet për:

- Ndriçimin e rrugës hyrëse në Përmet;
- Rehabilitimin e rrugës këmbësore për në Kalanë e Beratit dhe pikës panoramike jugore të Kalasë së Beratit "Tabja";
- Rehabilitimin e shkallareve në qendrën e qytetit të Sarandës;
- Rehabilitimin e infrastrukturës dhe restaurimin e kalldrëmeve, në pazarin e Gjirokastrës;

Ndërkohë ka përfunduar procesi i vlerësimit të tenderit të punimeve civile dhe është nënshkruar kontrata me fituesin për:

- Rigjenerimin urban të shëtitores ekzistuese “Naim Frashëri” në Sarandë;

Paralelisht me nisjen e punimeve, po punohet për shikimin e disa elementeve të projektit me qëllim përmirësimin e tij.

Përsa i përket kontratës

- “Rikonstrukcioni i rrugës automobilistike “Muzak Topia” për në Kalanë e Beratit”, më datë 20/12/2019 ka dalë Leja infrastrukturës nga Bashkia Berat (me kufizime pronësie), dhe punimet kanë nisur në 30/12/2019, në 500m të parë të kontratës në zonën ku nuk ka shpronësime. Me daljen e VKM-së për shpronësimet të cilat do të zbatohen sipas procedurës së Bankës Botërore, punimet do të vijojnë në të gjithë gjatësinë e objektit.

FSHZH po vijon punën për përgatitjen e projekteve teknike dhe dokumentacionit të tenderimit për një numër projektesh të tjera si:

- “Identifikimi, projektimi i masave të prioritizimit për të adresuar shqetësime urgjente për sigurinë dhe parandalojnë humbjen e strukturave të Kalasë së Gjirokastrës”;
- Ndriçimi i qendrës historike të qytetit të Gjirokastrës;
- Përmirësimi i integruar urban i infrastrukturës në qytetin e Gjirokastrës;
- Restaurimi dhe përmirësimi i sistemit të muzeve në Gjirokastrë;
- Përmirësimi i integruar urban i infrastrukturës për qytetin e Sarandës;
- Përmirësimi i integruar urban i infrastrukturës për qytetet e Beratit dhe Përmetit;
- Hartimi i projekteve të zbatimit dhe supervizioni i ndërtimit të infrastrukturës së pikave panoramike përgjate korridorit turistik në jug të Shqipërisë;
- Planet e Menaxhimit të sitit, interpretimin dhe eksperiencën turistike për sitet turistike Zvërnec - Nartë & Ujrat Termale të Bënjës;

Gjithashtu janë dorëzuar pajisjet teknologjike pranë Stacionit të Transferimit të Mbetjeve në Himarë. Në kuadër të investimeve për rehabilitimin e këtyre nënprojekteve janë zhvilluar konsultime me publikun dhe institucione të ndryshme në nivel qendror dhe lokal.

Studime dhe konsulenca të zhvilluara në kuadër të zbatimit të projektit:

- Konsulenca mbi “Krijimin dhe zhvillimin e sistemit të muzeve në qytetin e Gjirokastrës”, ka si qëllim projektimin dhe supervizionin e një sistemi miqësor (që do të thotë i lehtë për akses, interpretim tërheqës i lidhur me historinë e Gjirokastrës dhe rajonit) për turistët, ku ndërlidhen muze dhe atraksione të ndryshme të Gjirokastrës. Kontrata u nënshkrua më 24 Dhjetor, 2019 dhe bërë efektive më 7 Janar 2020. Konsulenti ka filluar procesin e hartimit të projekt zbatimeve të cilat pritet të dorëzohen në Mars 2020.
- Konsulenca mbi “Përmirësimin e integruar urban të infrastrukturës për qytetet e Beratit dhe Përmetit”, ka për qëllim përmirësimin urban të qyteteve duke rigjeneruar dhe rivitalizuar zonat kyçe brenda qendrave urbane. Studimi synon gjithashtu të ruajë dhe të shfrytëzojë trashëgiminë kulturore dhe të përmirësojë aksesin në zonat historike. Kontrata u nënshkrua më 31 Maj 2018 dhe u bë efektive në 4 Qershor 2018. Konsulenca vijon punën për shërbimet e konsulencës dhe ka kaluar në procesin e hartimit të Projekt Zbatimit të Përmetit dhe ndërkohë vijohet me “Konceptet e projekteve paraprake, udhëzime dhe kostot paraprake për projekt investimet e përzgjedhura” për Beratin.

- Konsulenca “Përmirësimi i integruar urban i infrastrukturës urbane për qytetin e Gjirokastrës”, ka për qëllim gjetjen e mundësive për ta kthyer zonën e pazarit në funksion të këmbësoreve duke e bërë atë më tërheqëse dhe të arritshme për turistët, krijimin e hapësirave të parkimit jashtë zonës së mbrojtur, ndërlidhjen efikase mes transportit publik, transportit të motorizuar dhe transportit të pa-motorizuar. Studimi synon gjithashtu përmirësimin e lidhjes brenda qendrës historike, përmirësimin urban të qytetit, me fokus ringjalljen e infrastrukturës në zonat historike, rigjallërimin e hapësirave publike, përmirësimin e rrugëve, rinovimin e fasadave dhe restaurimin e ndërtesave të trashëgimisë të përzgjedhura për ripërdorim adaptiv. Kontrata është nënshkruar më 20 Shtator 2018 dhe është bërë efektive në 4 tetor 2018. Aktualisht, kjo kontratë është ndërprerë dhe është duke u punuar për rishikimin e Termave e Referencës për ri-aktivizimin e kësaj konsulence dhe përmirësimit të objektivave të këtij aktiviteti.
- “Përmirësimi i integruar urban i infrastrukturës për qytetin e Sarandës”, ka për qëllim përmirësimin e mobilitetit në zonën qendrore të qytetit, përmirësimin e rrugëve duke promovuar kalimin nga transporti privat drejt transportit publik, krijimin e hapësirave për ecje dhe biçikleta në zona të ndryshme të qytetit, lidhjen me zonat përreth (psh Ksamili në jug). Studimi synon njëkohësisht përmirësimin dhe ruajtjen e hapësirave publike dhe integrimin e zonave të gjelbërta dhe rekreative brenda zonës së studimit. Kontrata është firmosur në datën 16 nëntor 2018 dhe u bë efektive në datën 1 dhjetor 2018. Konsulenti ka dorëzuar produktin e fazës së tretë, Zhvillimi i Vizionit dhe Koncepteve për përmirësimin urban të integruar i cili është duke u vlerësuar nga të gjitha palët. Kontrata e projektimit parashikohet të përfundojë në mars 2021.
- “Identifikimi, projektimi i masave të prioritizimit për të adresuar shqetësime urgjente për sigurinë dhe parandalojnë humbjen e strukturave të kalasë së Gjirokastrës”: Kjo konsulencë ka për qëllim:
 - Zhvillimin e planit të konservimit të azhornuar për Kalanë e Gjirokastrës;
 - Kryejën e studimeve, analizave dhe investigimeve fizike para zhvillimit të ndërhyrjeve të propozuara;
 - Përgatitjen e modeleve paraprake të koncepteve për opsione të ndërhyrjes dhe monitorimit për ruajtje afatshkurtër, të mesëm dhe të gjatë në vend;
 - Prioritizimin e opsioneve të propozuara, duke marrë parasysh ndikimin në vlerën e trashëgimisë, rreziqet, kostot dhe kontributin e palëve të interesuara;
 - Sigurimin e modeleve të detajuara për masat e pranuar të ndërhyrjes me përparësi të lartë dhe zbatimin e monitoruar;
 - Ngritjen e kapaciteteve për profesionistët lokalë të trashëgimisë kulturore, inxhinierët, arkitektët, bashkinë, etj. në mënyrë që siti të mirë monitorohet dhe menaxhohet në afat gjatë.

Të gjitha aktivitetet e mësipërme që do të zhvillohen në kuadër të kësaj konsulence, synojnë stabilizimin dhe qëndrueshmërinë e strukturës së kalasë së gjirokastrës. Proçedura e prokurimit ka përfunduar dhe janë përzgjedhur “Proskena Conservation and Cultural Heritage” dhe “Cultural Heritage without Borders”. Kontrata e projektimit është nënshkruar më 27.12.2019. Konsulenti pritet të fillojë shërbimet sapo kontrata të bëhet efektive.

Lidhur me komponentin e dytë,

Aktualisht po punohet në 3 site turistike:

- Korridori turistik;
- Nartë - Zvërnec;
- Ujrat Termale të Bënjës;

Është punuar gjithashtu dhe për identifikimin e siteve turistike shtesë të cilat mund të përfshihen nën këtë komponent, duke bërë një identifikim dhe listim të siteve turistike potencialë. Është rënë dakort me partnerët për të përfshirë në listë Kalanë e Gjirokastrës dhe po vijon puna për përzgjedhjen e sitit të pestë.

“Planet e Menaxhimit të sitit, interpretimi dhe eksperiencia turistike për sitet turistike Nartë - Zvërnec & Ujërat Termale të Bënjës”. Qëllimi i kësaj konsulence është identifikimi dhe përmirësimi i elementëve kryesorë të eksperiencës turistike në sitet Nartë - Zvërnec dhe Ujërat Termale të Bënjës, të tilla si interpretimi i siteve, aksesit, siguria e vizitorëve, përgatitja e planeve të menaxhimit dhe të mirëmbajtjes për të dy sitet, si dhe dizenjimi dhe supervizimi i punimeve të identifikuar.

Kontrata me Joint Venture “Abkons” sh.p.k. dhe “Metropolis” sh.p.k u firmos më 24 tetor 2018.

Me aktivizimin e kontratës, konsulenti filloi punën për përgatitjen e produktit të parë.

Për shkak të mos reflektimit të plotë dhe në kohë të komenteve nga konsulencia për detyrat e përcaktuara në Terma Reference, të vonesave për aprovimin e dokumentave nga ana e Bankës Botërore dhe palët e interesit, është kërkuar disa herë e shtyrja afateve të kontratës, kërkesa të cilat janë miratuar.

Ecuria e kësaj kontrate ka pasur gjithashtu probleme me mungesën e informacionit për statusin e pronës në zonat ku parashikohen ndërhyrjet. Banka Botërore ka kërkuar disa herë informacion të plotë mbi pronësinë si dhe përgatitjen e raporteve shtesë për çështjet e pronësië, raporte të paparashikuara në Terma Reference, një proces i cili ka marrë kohë dhe përsëri nuk është zgjidhur plotësisht. Banka Botërore ka kërkuar të mos ndërhyhet në një pjese të zonës ku janë shfaqur pretendime mbi pronësinë. Pas takimeve me palët e interesit dhe reflektimit të komenteve është miratuar projekti paraprak dhe aktualisht është dorëzuar nga konsulenti projekti i zbatimit.

Përsa i përket “Planit të Menaxhimit të sitit, interpretimit dhe eksperiencës turistike për Porto Palermon”, FSHZH po sheh mundësinë për ta hequr këtë investim nga programi i Bankës Botërore, për shkak të investimeve të tjera që parashikohet të bëhen në këtë zonë.

Me qëllim grupimin e siteve turistike ku do të ndërhyhet, janë zhvilluar dhe vizita për vlerësimin në terren të mundësive të aksesit për në Parkun Arkeologjik të Orikut, për të cilin aksesit nga vizitorët/turistët nuk është i garantuar gjatë gjithë vitit. Janë evidentuar 3 opsione për akses, por më i mundshmi dhe më pak i kushtueshmi ekonomikisht mbetet shtyrja e portës së Forcave të Armatosura pas vendndodhjes së parkut. Për këtë arsye FSHZH ka punuar për arritjen e një marrëveshjeje të përhershme ndërmjet Institutit të Monumenteve të Kulturës dhe Ministrisë së Mbrojtjes për shtyrjen e pikës së kontrollit duke garantuar një akses të përhershëm të vizitorëve/turistive në këtë sit turistik. Mosarritja e kësaj marrëveshjeje ka çuar në një vendimmarrje të përbashkët ndërmjet BB dhe FSHZH për të mos përfshirë parkun arkeologjik të Orikut në listën e siteve turistike ku do të investojë projekti.

Në datën 30 Mars 2018 është lidhur kontrata midis “Anaplasi Concultancy Engineers” SA dhe FSHZH për konsulencën e “Hartimit të projekteve të zbatimit dhe supervizionin e ndërtimit të infrastrukturës së pikave panoramike përgjate korridorit

turistik në jug të Shqipërisë”. Konsulenti ka përgatitur fazën e dytë të projektit e cila ka të bëjë me identifikimin e pikave panoramike/vendqëndrimet duke marrë në konsideratë propozimet e Bashkive (pjesë e këtij korridori), por edhe shumë palëve të tjera të interesuara si agjenci apo operatorë të ndryshëm turistikë. Konsulenti ka dorëzuar produktin e parë dhe të dytë dhe është duke përgatitur produktin e tretë.

Pas prishjes së kontratës midis “Anaplasi Conculancy Engineers” SA dhe FSHZH për konsulencën e “Hartimit të projekteve të zbatimit dhe supervizionin e ndërtimit të infrastrukturës së pikave panoramike përgjate korridorit turistik në jug të Shqipërisë”, FSHZH është duke ripunuar Termat e Referencës për ta rihapur përsëri si konsulencë.

Në komponentin e tretë, ka përfunduar studimi për “Përgatitjen e kërkimit të tregut dhe zhvillimin e strategjisë së produktit dhe tregut turistik për Jugun e Shqipërisë si dhe 4 bashkitë e përzgjedhura”. Produktet e përgatitura nga kjo konsulencë, “Kërkimi i tregut dhe analiza e zinxhirit të vlerës” si dhe “Strategjia 2 vjeçare e marketingut dhe zhvillimit të produktit si dhe plani i veprimit të menaxhimit të destinacionit” kanë hedhur bazat për konsulencat e ardhshme të cilat do të kenë si fokus zbatimin e strategjisë marketing, zhvillimin e produkteve turistike në 4 bashkitë përfituese të projektit si dhe ngritjen e organizatave të menaxhimit të destinacionit të parashikuara në PZHIUT.

Ka vijuar puna me përgatitjen e termave të referencës përsa i përket konsulencës “Zhvillimi i tregut për Jugun e Shqipërisë”, dhe në Janar 2020, pritet hapja e tenderit. Kjo konsulencë do shtrihet në të gjithë hapësirën gjeografike ku zbatohet projekti dhe synon krijimin e një infrastrukture bazë të marketingut. Ndër detyrat kryesore që parashikohen për secilën nga këto bashkitë, janë:

- krijimi i markave të turizmit;
- zhvillimi i websajteve, pasurimi dhe përditësimi i tyre;
- krijimi dhe menaxhimi i profileve në mediat sociale;
- pasurimi i një fondi me foto & video me cilësi të lartë;
- dizenjimi dhe printimi i broshurave & hartës turistike;
- asistencë teknike në fushën e marketingut turistik & promovimi i produkteve turistike të reja dhe atyre ekzistuese;
- Monitorimi i rezultateve sipas indikatorëve të përcaktuar;

Shtrirja kohore do jetë prej 24 muajsh dhe do jetë në koordinim të përhershëm me konsulencat e tjera që do jenë në zbatim brenda komponentit 3.b, siç janë ato që do mbështesin produktet turistike si dhe menaxhimin e destinacionit.

Në kuadër të financimit të PZHIUT është programuar një paketë shtesë investimesh në një vlerë prej 30 milion Euro. Ky nuk është një program i ri investimesh, por një tëresi ndërhyrjesh të cilat i bashkëngjiten programit ekzistues të PZHIUT me të njëjtat objektiva dhe principe. Deri në këtë moment është menduar që investimet do të adresohen në zona me potencial të lartë turistik siç është zona bregdetare e Ksamilit dhe ajo e Orikumit. Për të dyja këto zona është përgatitur koncepti i ndërhyrjes nga FSHZH dhe po punohet për përcaktimin e zonave të tjera ku mund të ndërhyhet përmes këtij portofoli financimi. Koncepti është dërguar zyrtarisht pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për komente.

Aneks 8. Informacion mbi Projektin për Zhvillimin e Integruar dhe Turizmin, financuar nga Banka Botërore (Dhjetor 2019)

5. Programi i Rrugëve Lidhëse Rajonale.

Programi parashikon ndërhyrje në rrjetin rrugor rajonal në zona me potencial bujqësor dhe turistik në të gjithë vendin. Ai do të financohet nga Banka Botërore dhe BERZH me vlerë financimi 100 milionë USD.

Në fazën e parë, u finalizua një listë financimi për vitin e parë të programit, për rreth 60 km rrugë që kanë një ndikim të rëndësishëm në turizëm, për të cilat me dakordësinë e Bankës Botërore dhe fondet e buxhetit të shtetit u krye procesi i prokurimit dhe kontraktimit të projektimit. Variantet finale të projekt zbatimit për segmentet rrugore Qafë Thore - Theth, Pogradec - Tushemisht, Fier - Seman, Bençë - Lekdush dhe Gusmar - Kuç, janë dorëzuar.

Në proces zbatimi janë segmentet rrugore:

- Qafë Thore - Theth;
- Pogradec - Tushemisht Lot I;

Janë lidhur kontratat dhe pritjet fillimi i punimeve për:

- Lekdush - Bënçë - Tepelenë Lot II;
- Gusmar - Kuç;

Në proces prokurimi:

- Fier - Seman Lot I;

Parashikohet që financimit të këtyre segmenteve rrugore t'u shtohen edhe segmente të tjera prioritare. Përfshirja e segmenteve të reja rrugore, parashikohet të formalizohet në muajt e ardhshëm.

Më poshtë jepen disa detaje mbi 5 segmentet e para të cilat do të financohen:

- Fier - Seman, Lot I, 7.6 km, një segment kryesor turistik i bashkisë Fier që lidh me bregdetin por edhe një numër të rëndësishëm komunitetesh gjatë saj.
- Qafë Thore - Theth 16.18 km. Segmenti përfundon lidhjen e fshatit dhe parkut kombëtar të Thethit, një rrugë shumë e dëmtuar dhe e rrezikshme në një zonë gjithnjë e më të frekuentuar në veçanti nga turistët e huaj;
- Pogradec - Tushemisht Lot I, 3.4 km. Është rruga kryesore që lidh Pogradecin me Tushemishtin dhe me pikën kufitare të Maqedonisë. Investimi në këtë rrugë që është në linjën e brendshme të liqenit krijon mundësinë e rikonceptimit si hapësirë e madhe publike e vijës së bregut të liqenit nga Pogradeci në Drilon;
- Bënçë - Lekdush - Tepelenë Lot II; Rruga shtrihet në pjesën jug-perëndimore të Shqipërisë, në zonën e Kurveleshit. Ajo lidh njëra pas tjetrës fshatrat nga Bënçë me Lekdush. Rruga e re parashikon ndërtimin e të gjitha strukturave të reja, zgjerimin e trupit të rrugës deri në 6.5 m, ndërtimin e shtresave rrugore përfshirë asfaltimin, instalimin e sinjalistikës vertikale dhe horizontale. Rruga e re do të rrisë sigurinë dhe shpejtësinë e udhëtimit dhe do të ulë kostot transportit;
- Gusmar - Kuç; Rruga lidh Tepelenën, Gjirokastrën dhe Përmetin me rrugën e Lumit të Vlorës dhe bregun e detit, duke krijuar një lidhje mes turizmit bregdetar me turizmin natyror, kulturor dhe historik. Nga Nivica me bukuritë e saj natyrore tek Kalaja e Tepelenës dhe gjithë zonën historike të Gjirokastrës, rruga Gusmar - Kuç do të jetë një shtysë e fuqishme për shfrytëzimin e potencialeve turistike dhe zhvillimit ekonomik të vendit.

Aneks 10. Informacion mbi nënprojektet e programit "Rrugët Lidhëse Rajonale", financuar nga BB, BERZH, Qeveria Shqiptare dhe NJQV-të përfituese (Dhjetor 2019)

6. Programi i Furnizimit me Ujë të Zonave Rurale

Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale (FUZR) është një program i bashkëfinancuar nga Qeveria Shqiptare, Banka Gjermane për Zhvillim - KfW (Bashkëpunimi Gjerman - Asistenca Financiare), dhe Bashkimi European. I ndarë në disa projekte të veçanta ky program përbën një nga iniciativat më serioze të 10 viteve të fundit për të përmirësuar furnizimin me ujë të pijshëm të zonave rurale. Ky program ka arritur deri më sot një financim total prej 102.58 milionë Euro. Përmes këtyre financimeve përfitojnë më shumë se 215,000 banorë dhe turistë që frekuentojnë këto zona, duke mundur kështu furnizim me ujë të pijshëm dhe higjienikisht të pastër.

Aktualisht është duke u zbatuar projekti “Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale III”, i cili synon të mbulojë me shërbim të furnizimit me ujë më shumë se 75,000 banorë.

Projekti “Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale IV”, ka nisur fazën përgatitore të tij gjatë vitit 2018, me studimin e fizibilitetit i cili ka përfunduar dhe është miratuar nga KfW. Marrëveshja mes Qeverisë Shqiptare dhe KfW është nënshkruar në Qershor 2019, dhe është ratifikuar në Kuvendin e Shqipërisë. Ndërkohë kanë përfunduar procedurat e tenderimit nga KfW, për komponentin e projektimit supervizionit të projektit dhe ka nisur puna për hartimin e projektit.

Projekti parashikon ndërhyrje të plota në të gjithë sistemin e furnizimit me ujë dhe atë të ujërave të zeza, ndërtimin e një impianti për trajtimin e ujërave të zeza në Bashkinë Himarë dhe vendosjen në funksionim të impiantit të trajtimit në qytetin e Orikumit. Ai do të financohet nga KfW, WBIF, Qeveria Shqiptare, me vlerë të përafshme financimi 45.15 milionë Euro. Projekti parashikohet të bëhet efektiv gjatë vitit 2019 dhe do të ketë kohëzgjatje 5 vjeçare.

Programi	Kohë zgjatja	Financimi Euro (milion)	Qarqet ku implementohet	Popullsia që shërbehet me ujë (banorë)	Nr. i fshatrave
FUZR I & II	2008-2016	11.66	Kukës, Dibër, Shkodër	40,000	53
SIF IV	2010-2017	5.8	Kukës, Dibër, Shkodër	20,000	26
FUZR III	2015-2021	39.97	Të gjitha Qarqet e Shqipërisë	75,000	88
FUZR IV ²	2019-2023	45.15	Vlorë (Bashkia Himarë)	80,000 banorë turistë	10

6.1 “Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale III”

Projekti “Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale III”, parashikon ndërhyrje në shkallë të gjërë në të gjithë vendin. Financues të këtij programi janë KfW me 25.5 milionë Euro dhe Bashkimi European përmes IPA 2013, me 9.8 milionë Euro si dhe Qeveria Shqiptare me 4 milionë Euro.

Në këtë kuadër me financim nga WBIF në shumën 670,000 Euro, gjatë periudhës Nëntor 2015 - Maj 2016, u hartuan fizibilitetet teknike dhe sociale.

Në fund të këtij procesi u administruan 252 aplikime nga 59 bashki. Bashkitë Elbasan dhe Konispol nuk kanë aplikuar në proces. Përgatitja e fizibiliteteve teknike, sociale

² Vlera e përafshme e financimit të FUZR IV është rreth 45.15 milionë Euro

dhe mjedisore ka përfunduar për 30 skema, nga të cilat 19 prej tyre kanë rezultuar fizibël. KfW ka dhënë miratimin për 18 skemat e para dhe ndërkohë disa skema të tjera rezervë parashikohet të financohen nga ky projekt.

Pritet miratimi i skemave të tjera shtesë, për të cilat janë duke u përgatitur fizibilitetet teknike. 18 nga skemat e miratuara kanë përfunduar fazën e projektimit gjatë vitit 2018, dhe janë tenderuar.

Në Qershor 2017 është lidhur kontrata me kompaninë fituese për përgatitjen e projekteve si dhe supervizionin e punimeve civile.

Periudha e parashikuar për hartimin e projekteve ka qenë 14 muaj.

Gjatë vitit 2018, janë përgatitur 18 projekte teknike të LOT I, II, III dhe IV. Projektet janë kontrolluar dhe komentuar nga FSHZH dhe kanë marrë miratimin e KfW-së. Projektet me vlerë mbi 100 milionë Lekë, kanë kaluar edhe procedurën e oponencës teknike nga Instituti i Ndërtimit.

Puna në terren për ndërtimin e ujësjellësave organizohet në Lot-e. Disbursimet kanë filluar pas firmosjes së kontratës së projektimit me konsulencën.

Për Lot I, tenderi i punimeve civile është shpallur në 12 Maj 2018. Në 16 Korrik është bërë hapja e ofertave teknike dhe në datë 29 Korrik është dërguar raporti i vlerësimit KfW-së, e cila dha miratimin në 21 Shtator 2018. Për këtë Lot, zbatimin e punimeve ka nisur në Shkurt 2019 dhe progresi është në masën 54 përqind.

Për Lot II, tenderi i punimeve civile është shpallur 10 Gusht 2018. Në 24 Shtator është bërë hapja e ofertave teknike dhe në fund të vitit 2018 ka përfunduar procesi i vlerësimit. Kontrata e zbatimit është nënshkruar në Janar 2019 dhe punimet kanë nisur në Shkurt 2019 dhe progresi është në masën 75 përqind.

Për Lot III, projektet teknike kanë përfunduar për të gjitha projektet në 15 Tetor 2018. Shpallja e tenderit është bërë gjatë tremujorit të parë 2019 dhe data e hapjes së tenderit është 8 prill 2019. Kontrata e punimeve është nënshkruar në Gusht 2019. Data e fillimit të punimeve është 04.09.2019. Aktualisht kontraktori është mobilizuar dhe ka ngritur zyrat dhe kantieret në secilën skemë, ka kryer matjet topografike në terren dhe po ka marrë miratimin e materialeve. Progresi është në masën 7 përqind.

Për Lotin IV, projektet teknike kanë përfunduar dhe janë miratuar nga KfW. Tenderi i punimeve për këtë Lot u shpall në 22 nëntor dhe dorëzimi i ofertave është bërë në 7 janar 2019. Kontrata për zbatimin e punimeve civile është nënshkruar në 18 Prill 2019 dhe progresi është në masën 30 përqind.

Aneks 9. Informacion mbi skemat e ujësjellësave të përzgjedhur për përgatitjen e projekteve teknike në kuadër të programit "FUZR III", financuar nga KfW, IPA 2013 dhe Qeveria Shqiptare (Dhjetor 2019);

6.2“Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale IV”,

FUZR IV parashikon ndërhyrje të integruar në Bashkinë Himarë dhe vlerë financimi rreth 45.15 milionë Euro. Ky projekt përfshin zonën e qytetit të Himarës, fshatrat Kuç, Buronjë (afër Kuç), Pilur, Kudhës, Vuno, Jal, Livadhi, Himara Fshat, Qeparo.

Njëkohësisht projekti parashikon një studim për gjendjen e sistemit të kanalizimeve, ndërhyrje për sistemin e furnizimit me ujë në Orikum, zgjatim të sistemit të kanalizimeve në NjA Orikum dhe riparime dhe masa plotësuese për vënien në funksionim të impiantit ekzistues në Orikum. Studimi i Fizibilitetit për Orikumin, është miratuar nga KfW në datë 22 Maj 2019. Në datë 3 Qershor 2019, është nënshkruar Marrëveshja e Investimit ku përfshihen ndërhyrjet në Bashkinë Himarë dhe NjA Orikum (Bashkia Vlorë) për masat e sipërpërmenduar.

Nga ky projekt parashikohet të përfitojnë mbi 80,000 përfitues të drejtpërdrejtë dhe turistë që frekuentojnë zonën.

Objektivi i këtij projekti është të përmirësojë dhe sigurojë akses të qëndrueshëm në furnizimin me ujë të pijshëm për popullsinë rezidente dhe turistët, me kosto dhe tarifa sociale të pranueshme. Ai do të sigurojë krijimin e kushteve higjieno sanitare të përshtatshme përmes sistemit të kanalizimeve, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura dhe përmirësimin e kapaciteteve menaxhuese.

Projekti do të kontribuojë në përmirësimin e kushteve të jetesës dhe do të promovojë zhvillimin e turizmit në rajon.

Në Maj 2018 është nënshkruar Marrëveshja e financimit të grantit 750 mijë euro, i siguruar nga Qeveria Federale Gjermane nëpërmjet KfW. Financimi u përdor për përgatitjen e studimit të fizibilitetit për Himarën.

Puna për studimin e fizibilitetit të projektit nisi në Shkurt 2018. Studimi është dorëzuar dhe miratuar nga KfW në Nëntor 2018.

Për të kompletuar këtë studim, KfW ka akorduar nga fondet e veta speciale edhe Investigimin e Burimit të Lëpushës për verifikimin e prurjeve, si dhe ka kontraktuar një kompani konsulente për përgatitjen e Fizibilitetit Teknik për pjesën e Orikumit ku përfshihen kanalizimet, vlerësimi për vënien në funksionim të Impiantit dhe masa për pajisjen me matësa uji për qytetin e Orikumit. Studimi final i Fizibilitetit për Orikumin është miratuar nga KfW në Maj 2019. Referuar gjetjeve nga raportet dhe kostot respektive, është draftuar edhe marrëveshja e financimit.

Gjatë vitit 2019, ka patur korrespondenca me KfW në lidhje me draft marrëveshjet dhe negociatat mes Qeverisë Shqiptare dhe KfW-së për marrëveshjen e kredisë për financimin e projektit teknik, punimeve civile, masave shoqëruese etj. Draft marrëveshjet janë përgatitur nga KfW dhe komentuar nga FSHZH si dhe u janë nisur ministrive të linjës për komente të mëtejshme. Marrëveshja e financimit u nënshkrua në Maj 2019 është ratifikuar në Kuvendin e Shqipërisë në Korrik 2019. Marrëveshja është bërë efektive në datë 14.08.2019.

Gjatë kësaj periudhe u realizua dhe procedura e prokurimit për përzgjedhjen e konsulentit. Më datë 27.11.2019 është nënshkruar kontrata me konsulentin për shërbimet e projektimit dhe të supervizionit për këto shërbime. Po punohet për përgatitjen e Projektit të Lotit I, që është Linja kryesore nga burimet e Lëpushës deri në Himarë. Parashikohet që projekti të dorëzohet në Qershor 2020 për të vijuar me pas me procedurën e prokurimit për punimet civile për këtë Lot.

Prokurimi

Për Programin FUZR III, procesi i prokurimit ka filluar me Shërbimet e Konsulencës për përgatitjen e Fizibiliteteve Teknike. Në vijim janë tenderuar shërbimet e konsulencës për Projektim Supervizionin. Prokurimi është kryer sipas Termave të KfW Guidelines Gusht 2016 për “Përzgjedhjen e Konsulentit në Bashkëpunimin Financiar me Vendet Partnere”. Proçedura e prokurimit është bërë me Tender Agent, të përcaktuar nga KfW. Është aplikuar procedura me dy faza, parakualifikim nga ku janë shortlistuar kompanitë që përmbushin kriteret bazë, dhe post-kualifikim ku bëhet një vlerësim më i detajuar i ofertës teknike dhe financiare. Për çdo fazë, merret miratimi nga KfW.

Prokurimi i punimeve civile kryhet sipas Termave të KfW Guidelines Gusht 2016 për “Prokurimin e të mirave, punimeve dhe shërbimet shoqëruese për Bashkëpunimin Financiar me Vendet Partnere”. Kjo proçedure prokurimi është kryer nga FSHZH. përmes proçedures me dy faza, parakualifikim nga ku janë shortlistuar kompanitë që përmbushin kriteret bazë dhe është vlerësuar edhe pjesa teknike, dhe post-kualifikim ku bëhet një vlerësim vetëm i ofertës financiare. Për çdo fazë, merret miratimi nga KfW.

Për programin FUZR IV është caktuar Tender Agent nga KfW për përgatitjen e Termave të Referencës për përzgjedhjen e Kompanisë konsulente për shërbimet e Projektim Supervizionit. Në këtë proçedurë prokurimi janë aplikuar termat më të fundit të KfW të miratuara në Janar 2019 “Termt për Prokurimin e shërbimeve të Konsulences, Punimeve, Impianteve, të mirave dhe shërbime jo-konsulencë në Bashkëpunimin Financiar me Vendet Partnere”. Është zhvilluar procedura e tenderit të konsulencës për përzgjedhjen e projektuesit dhe supervizorit të punimeve për FUZR IV. Aktualisht është në fazë të miratimit nga KfW. Në datë 27 Nëntor 2019 u nënshkrua kontrata për këto shërbime.

Procedurat mjedisore

Në kuadër të zbatimit të procedurave për mbrojtjen e mjedisit të programit “Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale”, janë kryer këto aktivitete:

- Janë miratuar të gjitha lejet e nevojshme për vijimin e punës në të katër Lot-et, përfshi dhe ato mjedisore.
- Janë përfunduar VNM nga konsulenca CES dhe kanë kryer aplikimet për leje në bashkëpunim me bashkitë përfituese.

7. Programet e financuara nga IPA, Bashkimi Evropian

Fondi Shqiptar i Zhvillimit është përzgjedhur si partner në 11 projekte IPA (Instrumenti i ndihmës së para-aderimit). 5 nga projektet financohen nga programi Interreg Adrion, 2 nga programi Itali-Shqipëri-Mal i Zi, 1 nga programi Interreg MED, 1 nga programi Maqedoni-Shqipëri, 1 nga programi Greqi-Shqipëri dhe një nga Programi Shqipëri-Kosovë. Zbatimi i këtyre projekteve ka për qëllim nxitjen e bashkëpunimit dhe solidaritetit midis shteteve partnere në këto programe, përfitimin nga zhvillimet e ndërsjellta në burimet e pasura natyrore, kulturore dhe njerëzore si dhe kontribut në rritjen e kohezionit ekonomik, social dhe territorial në rajon.

Programi Adrion investon në sistemet rajonale të inovacionit, trashëgiminë kulturore dhe natyrore, ndryshimet në mjedis, transportin e qëndrueshëm dhe lëvizshmërinë, të kombinuara me ngritjen e kapaciteteve.

Programi Interreg MED ka objektiv kryesor promovimin e rritjes së qëndrueshme në zonën e Mesdheut duke nxitur konceptet dhe praktikatat e reja dhe përdorimin e arsyeshëm të burimeve. Programi mbështet integrimin social përmes një qasjeje të integruar dhe të bashkëpunimit të bazuar në territor. Investimet në kuadër të këtij programi fokusohen në fusha si mbrojtja e burimeve natyrore dhe kulturore dhe fuqizimi i inovacioneve.

Programi i Bashkëpunimit Ndërkufitar Maqedoni-Shqipëri (2014-2020), mbështet bashkëpunimin ndërkufitar me qëllim promovimin e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë, nxitjen e integritimit evropian, dhe të promovimit të zhvillimit socio-ekonomik.

Programi përqëndrohet në 3 prioritetet tematike, që derivojnë nga analiza nevojë-mundësi:

- Inkurajimi i turizmit dhe trashëgimisë kulturore;
- Rritja e konkurrueshmërisë, biznesit, tregtisë dhe investimeve;
- Mbrojtja e mjedisit, promovimi i përshtatjes dhe zbutjes së ndryshimeve klimatike, rrishtu parandalimi dhe menaxhimi;

Programi i Bashkëpunimit ndërkufitar Greqi - Shqipëri (2014-2020) ka si objektiv të përgjithshëm "rritjen e standardit të jetesës së popullsisë duke promovuar zhvillimin e qëndrueshëm lokal, në zonën ndërkufitare". Programi përqëndrohet në prioritetet që karakterizohen nga efekte të rëndësishme ndërkufitare ose paraqesin një potencial të lartë për arritjen e vlerës së shtuar nëpërmjet bashkëpunimit.

Ky program mbështetet në dy akse prioritare si më poshtë:

- Promovimi i mjedisit dhe infrastrukturë e qëndrueshme transporti dhe infrastrukturë publike;
- Nxitja e ekonomisë lokale;

Programi i Bashkëpunimit ndërkufitar Shqipëri - Kosovë (2014-2020), nxit bashkëpunimin midis Shqipërisë dhe Kosovës në zonat që kanë lidhje të drejtpërdrejta në kufi ose në afërsi të tyre. Programi synon të trajtojë sfidat e përbashkëta të identifikuara në rajonet kufitare dhe të shfrytëzojë potencialet ekonomike në zonat kufitare, duke rritur procesin e bashkëpunimit. Projekti në të cilin FSHZH është përzgjedhur inkurajon turizmin dhe promovon trashëgiminë natyrore dhe kulturore.

Programi i Bashkëpunimit ndërkufitar Itali - Shqipëri - Mal i Zi (2014-2020), është një program i bashkëfinancuar nga Bashkimi Europian nëpërmjet instrumentit të para-aderimit dhe ka një buxhet total prej 92 Milion Euro. Ky program menaxhohet nga rajoni i Puljas dhe ka si objektive të promovojë rritjen ekonomike dhe të intensifikojë bashkëpunimin në pjesën e poshtme të zonës së Adriatikut, duke zbatuar aksione të përbashkëta midis institucioneve kombëtare dhe rajonale dhe aktorëve jo-fitimprurës, duke mbështetur zhvillimin gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm. Ky program është i bazuar në 4 akse prioritare:

- Konkurrueshmëria e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme;
- Turizmi dhe Kultura;
- Mjedisi dhe Energjia;
- Transporti i Qëndrueshëm;

Projektet e menaxhuara nga FSHZH, në total kanë një vlerë prej më shumë se 1.5 Milion Euro dhe kanë filluar zbatimin në fillim të vitit 2018.

Në zbatim të VKM Nr. 438, datë 18.07.2018, funksionet institucionale të Agjencive për Zhvillim Rajonal, i kaluan Fondit Shqiptar të Zhvillimit. Në këtë kuadër dhe në bazë të Udhëzimit me nr Prot. 1074, dt 30.07.2018, në lidhje me projektet me financim të huaj, u vijua zbatimi i aktiviteteve të projekteve si dhe përmbushja e detyrimeve që rrjedhin nga këto bashkëpunime.

Agjencitë e Zhvillimit Rajonal menaxhojnë në total 4 projekte: dy projekte të cilat financohen nga programi i Bashkëpunimit Ndërkufitar Interreg IPA CBC Itali-Shqipëri-Mal i Zi 2014 - 2020, një nga programi i Bashkëpunimit Ndërkufitar Interreg IPA CBC Greqi-Shqipëri 2014 - 2020 dhe një projekt në kuadër të programit të Bashkëpunimit Ndërkufitar Maqedoni - Shqipëri 2014 - 2020. Projektet në total kanë një vlerë prej 569,063 Euro dhe kanë filluar zbatimin në fillim të vitit 2018.

FSHZH është siguruar të adresojë ndryshimet e duhura të dokumentacionit kontraktual dhe bankar, duke plotësuar kërkesat e programeve specifike.

FSHZH është angazhuar në bashkëpunim me organizatat dhe agjencitë partnere në detajimin e objektivave të projekteve, analizën e gjendjes aktuale për secilën nga tematikat dhe fushat e ndërhyrjes, hartimin e metodologjisë së ndërhyrjeve, planifikimin e aktiviteteve, identifikimin e aktorëve të interesuar dhe planifikimin e përfshirjes së tyre në zbatimin e projektit.

Projekti “Impreco”:

Strategjitë e përbashkëta dhe praktikat më të mira për të përmirësuar mbrojtjen rajonale të ekosistemit dhe shërbimeve ndaj tij

Buxheti i projektit	1,142,165 Euro
Buxheti i projektit për Shqipërinë	112,015 Euro
Kohëzgjatja:	24 muaj (Mars 2018 - Shkurt 2020)
Financues:	Bashkimi Europian, Programi ADRION
Shtetet pjesëmarrëse:	Itali, Slloveni, Kroaci, Greqi, Shqipëri
Objektivi i projektit:	Rritja e mbrojtjes së shërbimeve të ekosistemit dhe trajtimi i cënueshmërisë së tyre mjedisore. Projekti adreson këto sfida që mbështesin zonat e mbrojtura të 7 rajoneve të ADRION-it përmes rritjes së tyre ndërshtetëror dhe zhvillimit të sistemeve të menaxhimit me bazë komunitare.

Projekti fokusohet në rritjen e njohurive dhe shërbimeve të ekosistemit, përmirësimin dhe menaxhimin të shërbimeve të ekosistemit si dhe ndërtimit të një metodologjie dhe strategjie ndërshtetërore për ruajtjen e ekosistemit. Po kështu synohet rritja e kapaciteteve në nivel ndërshtetëror për sa i përket adresimit të vulnerabilitetit mjedisor, fragmentimit dhe ruajtjes së shërbimeve të ekosistemit në zonën Adriatiko-Joniane.

Gjatë kësaj periudhe projekti ka organizuar katër takime organizative me partnerët ndërkombëtarë ku u përzgjedhën zonat pilot, që do të shërbejnë për hartëzimin dhe identifikimin e problematikave në biodiversitet dhe ekosistem. Liqeni i Shkodrës është zona pilot e përzgjedhur për territorin shqiptar.

Vlen për t'u përmendur ngritja e Task Forcës së Përbashkët, e cila është një strukturë që do të përfshijë të gjithë aktorët e interesit duke bërë të mundur zhvillimin e qëndrueshëm të zonave të mbrojtura, forcimin e partneritetit me aktorët e brendshëm dhe të jashtëm dhe promovimin e vlerave të zonave të mbrojtura. Janë organizuar dy mbledhje të kësaj Task Force të Përbashkët me qëllim prezantimin e protokollit të monitorimit të specieve, hartën e ndjeshmërisë, si dhe praktikave të mirëmenaxhimit të eko-sistemit të Liqenit të Shkodrës.

Është hartuar dhe ka nisur plani i aksionit pilot ku është dakordësuar për hartëzimin e rrjetit të prodhuesve të artizanatit në Liqenin e Shkodrës dhe rritjen e kapacitetit të fermerëve mbi bujqësinë organike dhe përfitimet e saj për shërbimet e ekosistemit dhe për ekosistemin e Liqenit të Shkodrës në tërësi. Si pjesë e këtij aksioni pilot, në Dhjetor, 2019 ka përfunduar trajnimi i fermerëve të zonës, i cili është pasuar me një vizitë studimore në zonën e Liqenit të Shkodrës për njohjen e praktikave të mira në bujqësinë organike.

Projekti Impreco, me kontributin e të gjithë partnerëve, ka përgatitur dhe shpërndarë tek aktorët e interesit Newsletter-in e radhës mbi arritjet e projektit.

Projekti “Blue BOOST”:

Rritja e potencialit të inovacionit të sektorëve tradicionale dhe atyre emergjentë të ekonomisë blu me tendencë rritje të shpejtë (Blue Groëth) në zonën Adriatiko-Joniane

Buxheti i projektit:	1,338,941 Euro
Buxheti i projektit për FSHZH:	181,456 Euro
Kohëzgjatja:	22 muaj (Janar 2018 - Tetor 2019)
Financues:	Bashkimi Europian, Programi ADRION
Shtetet pjesëmarrëse:	Italia, Greqia, Kroacia, Shqipëria
Objektivi i projektit:	Rritja e potencialit të inovacionit të sektorëve tradicionale dhe atyre emergjentë të ekonomisë blu me tendencë rritje të shpejtë (Blue Groëth) në zonën Adriatiko-Joniane.

Grupimet detare brenda zonës ADRION, karakterizohen nga një heterogjenitet aktivitetesh, një boshllëk në ndërvëprimin në katër helikat respektive (qeveri, industri, trajnim dhe shoqëri) dhe një ambient me mungesë ndërvëprimi sidomos në sektorin ndërsektorial.

BLUE BOOST ka si qëllim çlirimin dhe fuqizimin e potencialeve të njohurive dhe transferimit të teknologjive, bashkëpunimin ndërkombëtar dhe ndërsektorial të aktorëve kyç në sektorët e ekonomisë blu duke fuqizuar marrëdhëniet dhe

ndërveprimin brenda dhe ndërmjet grupimeve të ngjashme, bazuar në një sistem shkëmbimi njohurish të hapur dhe të mbështetur në komunitet.

Qëllimi është të analizohen ndërthurje të mundshme ndërmjet sektorëve, ide dhe kompetenca të reja, aleanca dhe rrjete të reja midis individëve ose komuniteteve, ndërmarrjeve, organizatave dhe institucioneve të ekonomisë detare.

Janë organizuar aktivitete si Laboratorët Blu - workshope të bazuara në analizën dhe evidentimin e problematikave të sektorëve të Ekonomisë Blu në të cilat fokusohet projekti dhe Workshopet e Skenarëve për gjetjen e zgjidhjeve për bizneset.

Aktivitetet u zhvilluan në Sarandë (laboratori blu), në Vlorë (laboratori blu dhe workshop skenarësh), në Shëngjin (laborator blu dhe workshop skenarësh) si dhe në Durrës (workshop skenarësh). Aktivitete të peshkimit, akuakulturës, akomodimit, kompani të organizimit të udhëtimeve turistike brenda vendit, kompani të shërbimeve portuale dhe pastrimit të ujrave etj, ishin pjesë të këtyre takimeve.

Gjatë këtyre aktiviteteve ku morën pjesë 50 SME u evidentuan rreth 20 nevoja prioritare me të cilat ndeshen aktivitetet e peshkimit, akuakulturës dhe turizmit detar dhe bregdetar si dhe u përpunuan skenarë të mundshëm zgjidhje nëpërmjet aplikimit të metodave të reja inovative.

Në datat 24-25 Maj 2019, u organizua "Hackathon", një aktivitet dyditor, ku studentë të Universitetit Bujqësor (profili Akuakulturë dhe Peshkim), studentë të Universitetit "A.Xhuvani" - Durrës (profili Turizëm) dhe studentë të UET (profili menaxhim dhe IT) u bashkuan për t'i dhënë zgjidhje nëpërmjet aplikimit të inovacioneve, disa prej çështjeve të evidentuara si problematika të SME-ve gjatë organizimit të Laboratorëve Blu dhe Workshopeve të Skenarëve.

Në vazhdimësi të aktiviteteve të projektit, në datën 10 Prill 2019, në koordinim me të gjithë partnerët e projektit, është hapur thirrja për "Knowledge Providers" si parapritë e aplikimit të Skemave Voucher. Thirrja për aplikime në fushën e inovacioneve në sektorët e ekonomisë blu ku projekti është i fokusuar, u hap në muajin Maj. Për ta bërë sa më të njohur këtë skemë dhe mundësinë që ofrohej për të gjitha SME-të e interesuara, janë organizuar ditë të hapura në Lezhë dhe Durrës ku pjesëmarrësit janë njohur me Skemat Voucher, mënyrat e aplikimit dhe informacione të tjera të nevojshme. Po kështu janë organizuar lajmërimet në televizionet lokale në Sarandë, Vlorë dhe Lezhë, sipas kërkesave dhe përcaktimeve të projektit ku i bëhej thirrje SME-ve të fushës të përfitonin nga kjo skemë për aplikimin e inovacioneve dhe përmirësimin e aktiviteteve të tyre.

Pjesë e aktiviteteve të projektit ka qenë edhe organizimi i pjesëmarrjes së SME-ve dhe përfaqësuesve të ofruesve të njohurive ("Knowledge Providers") në "Brokerage Event" dhe vizitat studimore të organizuara në Selanik, Trieste dhe Zadar.

Gjatë muajit Korrik u implementua faza përfundimtare e vlerësimit të aplikimeve të cilat do të përfitonin mbështetje me anë të skemës voucher për inovacionet në sektoret e përzgjedhur të ekonomisë blu. Është ndjekur dhe realizuar i gjithë procesi deri në firmosjen e kontratave dhe fillimin e punës.

Në vazhdimësi, të këtij procesi është organizuar një takim koordinues me ekspertët e projektit të cilët duhet të jenë mbështetje për monitorim të implementimit të investimeve të reja të cilat janë kontraktuar në skemën voucher. Është hartuar plani i monitorimit i cili do të kryhet në muajt në vazhdim, në mënyrë që të sigurohemi për ecurinë e zbatimit të projekteve të cilat kanë përfituar voucher.

Gjithashtu gjatë muajit Gusht 2019 u hap thirrja për pjesëmarrje të grupeve të interesit për dy vizita në Trieste dhe Zadar lidhur me zhvillimin e Ekonomisë Blu në këto qytete. Gjatë muajit shtator u kryen këto vizita me grupet e interesit, të cilët u përzgjedhën pas aplikimit dhe dëshirës që shprehën për të qënë pjesë e turit.

Duke qenë se FSHZH është partneri lider për realizimin e aktiviteteve të paketës së aktiviteteve ka vazhduar puna me ofrimin e orientimeve dhe metodologjisë për të gjithë partnerët pjesëmarrës. Pas muajit Tetor, FSHZH si partner përgjegjes ka filluar me mbledhjen e informacioneve nga të gjithë partnerët mbi realizimin e aktiviteteve të përfshira në paketën e aktiviteteve WPT1 dhe përgatitjen e raportit final i cili është dhe një output i proejktit që kërkohet të realizohet nga FSHZH.

Në muajin Tetor 2019 është realizuar me sukses përfaqesimi në Panairin e Inovacionit, Makerfaire - Romë, i njërës nga projektet inovative të cilat mbështeten nga skemat voucher. Bashkë me Mandarina Communication, "Knowledge provider" u mundësua prezantimi, me kohëzgjatje gjysëm dite, në stendën e marrë për këtë qëllim nga partnerët e projektit.

Në muajin Nëntor 2019 u organizua mbledhja e rradhës e partnerëve të projektit në Tiranë dhe udhëtimi studimor i SME-ve, ekspertëve dhe partnerëve të projektit nga vendet pjesëmarrëse në SME-të e sektorit të akuakulturës dhe peshkimit. Aktivitetet e realizuara për realizimin me sukses të këtyre dy aktiviteteve përfshinin midis të tjerave:

- organizimin e takimit të Komitetit Drejtues të partnerëve të projektit përfshi këtu përgatitjen e prezantimit, përgatitjen e axhendës dhe dakordësimin me të gjithë partnerët, organizimin e takimit, mbarëvajtjen e tij dhe koordinimin për akomodimin e të gjithë pjesëmarrësve.
- organizimin e vizitës studimore dyditore përfshi komunikimin dhe koordinimin me drejtuesit dhe planifikimi i orarit të vizitave, me 4 ndërrmarjet e peshkimit dhe akuakulturës në Shëngjin, Vaun e Dejës, Orikum si dhe vizitën në Laboratorin e Akuakulturës dhe Peshkimit në Durrës.

Plotësimi i raportimit financiar, dhe komunikimi me zyrën e kontrollit të nivelit të parë në Ministrinë e Financave, është tashmë një angazhim periodik i stafit të projektit. Ky angazhim përfshin hedhjen në sistem dhe plotësimin në hard copy të të gjithë dokumentave të përfshira në raportim.

Projekti "InnoXenia":

Inovacioni në Turizëm në rajonin e gjerë Adriatik - Jon

Buxheti i projektit:	1,055,190 Euro
Buxheti i projektit për FSHZH:	90,000 Euro
Kohëzgjatja:	21 muaj (Janar 2018 - Shtator 2019)
Financues:	Bashkimi Europian, Programi ADRION
Shtetet pjesëmarrëse:	Bosnjë-Hercegovina, Greqia, Italia, Kroacia, Shqipëria, Sllovenia
Objektivi i Projektit:	Përmirësimi i kapacitetit të inovacionit në sektorin e turizmit, duke u mbështetur në produkte, procese dhe shërbime të reja, që mund të plotësojnë ofertat turistike kulturore dhe natyrore të rajonit.

Projekti synon të përmirësojë kapacitetet inovative të sektorit të turizmit në zonën e Adriatikut dhe Jonit, duke u fokusuar kryesisht tek produktet, proceset dhe shërbimet inovative, që mund të mbështesin dhe t'i japin vlerë të shtuar pasurive natyrore dhe kulturore.

Për realizimin e aktiviteteve dhe produkteve të parashikuara në projekt, gjatë vitit 2019, në kuadër të projektit, Fondi Shqiptar i Zhvillimit ka organizuar në Tiranë, Konferencën Ndërkombëtare IPA - "Inovacioni në zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit", me pjesëmarrjen e partnerëve të projektit, përfaqësuesve nga sektori publik, privat, të shoqërisë civile, dhe universiteteve. Gjatë kësaj Konference, pjesëmarrësit patën mundësi të njihen me projektin, si dhe të diskutojnë, ndajnë eksperiencat e tyre dhe mbi rolin e inovacionit në zhvillimin e turizmit, u prezantuan raste suksesi, si dhe u konsiderua mundësia për t'u angazhuar përgjatë gjithë fazës së implementimit të projektit, si pjesë e rrjetit të aktorëve të turizmit.

Si pjesë e fushatës së ndërgjegjësimit në kuadër të projektit InnoXenia, janë organizuar në Tiranë dhe në Bashkinë Përmet, tre Workshope, në formën e Kafëve të Punës, ku pjesëmarrës nga të katër helikat e aktorëve të projektit u njohën me aktivitetet e projektit, si dhe u angazhuan të bëhen pjesë aktive gjatë implementimit të tij, duke nënshkruar Marrëveshjen Ndërkombëtare të krijimit të Rrjetit të Aktorëve të Turizmit në kuadër të projektit InnoXenia. Gjatë këtyre aktiviteteve u identifikuan edhe praktika të mira në zonë, si dhe u mbledhën të dhëna lokale nëpërmjet mjeteve të parashikuara nga projekti, për popullimin e Observatorit të Inovacionit në Turizëm dhe Sistemin Mbështetës të Vendimmarrjes për Inovacionin në Turizëm. Këto produkte do t'u vijnë në ndihmë organizatave menaxhuese të destinacioneve dhe sektorit publik për të përmirësuar strategjinë lokale të turizmit nëpërmjet futjes së inovacionit, si dhe duke identifikuar nevojat prioritare për investime në zonë. Gjithashtu, ato do të sjellin përfitime edhe për sektorin privat, duke mundësuar identifikimin e impaktit të ndërhyrjeve inovative në shërbimet apo produktet që ato ofrojnë, si dhe duke lehtësuar procesin e identifikimit të burimeve të financimit. Gjithashtu, në këtë kuadër, projekti u prezantua edhe ndërkombëtarisht, gjatë eventit të përvitshëm ADRION të organizuar në Budva.

Gjatë tremujorit të tretë, u realizua Takimi i tretë i Partnerëve dhe Mbledhja e tretë e Komitetit Drejtues të Projektit ku u përcaktuan edhe hapat drejt finalizimit të implementimit të aktiviteteve.

Në këtë kuadër, në muajin gusht u organizua në Përmet, Konferenca Rajonale dhe Trajnimi për të gjithë grupet e interesit të projektit mbi përdorimin e Platformës Elektronike të Inovacionit në Turizëm. Fondi Shqiptar i Zhvillimit, si partneri shqiptar në këtë projekt, realizoi në bashkëpunim me ekspertët Fushatën e Informimit rreth projektit, e cila arriti një numër të madh të grupeve të targetuara të interesit nëpërmjet pjesëmarrjes dhe prezantimit të projektit InnoXenia në eventin Za Fest. Po ashtu, në Tiranë u zhvillua edhe fushata për rritjen e kapaciteteve e cila u finalizua me Eventin për Rritjen e Kapaciteteve në datë 29 gusht.

Aktivitetet u finalizuan me Konferencën Kapitalizuese të Projektit, të organizuar në Rimini. Në këtë Konferencë u ritheksua edhe njëherë se produktet e realizuara nga InnoXenia do t'u vijnë në ndihmë organizatave menaxhuese të destinacioneve dhe sektorit publik për të përmirësuar strategjinë lokale të turizmit nëpërmjet futjes së inovacionit, si dhe për të identifikuar nevojat prioritare për investime në zonë. Gjithashtu, ato do të sjellin përfitime edhe për sektorin privat, duke mundësuar identifikimin e impaktit të ndërhyrjeve inovative në shërbimet apo produktet që ato ofrojnë, si dhe duke lehtësuar procesin e identifikimit të burimeve të financimit.

Aktualisht, është duke u zhvilluar një proces ndryshimi administrativ lidhur me shtyrjen e periudhës së implementimit të projektit deri në përfundim të vitit 2020, për të shtrirë më gjerë fushën e veprimit të projektit dhe përsosur produktet përtej specifikimeve fillestare.

Projekti “ADRION 5 SENSES”: **Krijimi i emrit tregtar ADRION në fushën e turizmit: nxitja dhe kënaqja e të 5 shqisave të turistëve**

Buxheti i projektit:	1,437,076 Euro
Buxheti i projektit për FSHZH:	120,529 Euro
Kohëzgjatja:	24 muaj (Janar 2018 - Dhjetor 2019)
Financues:	Bashkimi Europian, Programi ADRION
Shtetet pjesëmarrëse:	Bosnjë-Hercegovina, Greqia, Italia, Kroacia, Mali i Zi, Serbia, Shqipëria, Sllovenia
Objektivi i Projektit:	Krijimi dhe promovimi i një modeli të qëndrueshëm turizmi, që ofron shërbime dhe produkte turistike inovative e të cilësisë së lartë dhe krijon përvoja gjithëpërfshirëse që kënaqin të 5 shqisat e turistëve.

Projekti synon hartimin e një strategjie të përbashkët dhe planin e veprimit për menaxhimin e destinacioneve të zonës Adrion, krijimin dhe promovimin e brand-it “Adrion” me aktivitetet shoqëruese përkatëse si Harta e Ndjeshmërive, Platforma Eëb Shumëgjuhëshe, Qendrat e Ekspozimit, etj. Po kështu projekti synon vlerësimin dhe promovimin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore të destinacioneve Adrion nëpërmjet marketimit të eksperiencave turistike 5 shqisore.

Gjatë vitit 2019, FSHZH i suportuar edhe nga konsulenca e jashtme, ka finalizuar paketën e Kërkimit të tregut, hartimin e Strategjisë së Turizmit dhe Planit të Veprimit për rajonin e Alpeve Shqiptare. Në këtë kuadër, është organizuar gjatë muajit mars, në Razëm, Malësi e Madhe, edhe Konferenca Rajonale për Konsultimin e Draft Strategjisë. Diskutimet me grupet e interesit dhe komentet e tyre janë reflektuar në variantin final. Strategjia e Përbashkët u aprovua nga gjithë grupet e interesit në projekt dhe nga Komiteti i Ekspertëve të këtij projekti.

Në vijim, janë realizuar aktivitetet e parashikuara në paketën e punës për krijimin e brandit ADRION 5 SENSES në turizëm, me të cilin do të identifikohen të gjithë destinacionet që mundësojnë një eksperiencë gjithëpërfshirëse për turistët, si dhe identifikimi i nevojave për trajnim në rajonin e Alpeve Shqiptare. Më konkretisht është realizuar një takim konsultues me përfaqësues të grupeve të interesit të zonës për identifikimin e nevojave të tyre për trajnim dhe mbi bazën e rezultateve është përgatitur nga konsulenca e jashtme kurrikula për marketimin digital të operatorëve në rajonin e Alpeve Shqiptare. Gjithashtu për promovimin e zonës u realizua edhe një Vizitë Studimore me pjesëmarrjen e përfaqësuesëve nga sektori privat dhe ai publik nga zona të ndryshme të Shqipërisë.

Gjatë kësaj periudhe është përzgjedhur dhe ka nisur punën edhe konsulenca e jashtme për paketën e punës Demonstrimi dhe po punohet për realizimin e produkteve për Hartën Shqisore dhe Platformën Elektronike. Këto produkte do të mundësojnë promovimin në nivel ndërkombëtar të destinacioneve shqiptare që do të mbajnë emrin ADRION.

Projekti 4helix+ :**Fuqizimi i grupeve të interesit të zonave detare përmes një platforme të hapur elektronike për ndarjen e njohurive dhe qasjen në favor të komunitetit për zhvillimin e ekonomisë blu**

Buxheti i projektit:	2,193,983 Euro
Buxheti i projektit për FSHZH:	169,705 Euro
Kohëzgjatja:	30 muaj (Shkurt 2018 - Korrik 2020)
Financues:	Bashkimi Europian, Programi Interreg MED (2014 - 2010)
Shtetet pjesëmarrëse:	Italia, Spanja, Franca, Portugalia, Greqia, Kroacia dhe Shqipëria.
Objektivi i Projektit:	Të stimulojë, trajtojë dhe financojë novacionin krijues në sektorin e Ekonomisë Blu në zonën e Mesdheut.

Projekti ka për qëllim të përmirësojë novacionin ndërsektorial dhe transkufitar të ekonomisë detare (Blue Growth), e cila meriton të mbështetet më së miri si një nxitës ekonomik dhe një gjenerator i mundshëm i zhvillimit dhe i vendeve të punës. Deri tani janë zhvilluar dy takime me pjesëmarrjen e të gjithë partnerëve ku u diskutuan çështjet teknike dhe menaxhimit financiar të projektit. Është bërë një hartëzim dhe analizë e situatës aktuale të ekonomisë blu në rajonet e përzgjedhura të projektit ku janë përzgjedhur sektorët më aktivë.

Janë bërë 8 aktivitete të përbashkëta me SME dhe ekspertë të të gjithë partnerëve në vendet e partnerëve të projektit dhe Tiranë gjithashtu. Të gjithë SME dhe ekspertët kanë promovuar CV e tyre në një platformë të përbashkët online ku kanë krijuar partneritete me njëri tjetrin mbi përfitimin sa më shumë të produkteve inovative që do përmirësojnë efikasitetin e bizneseve të tyre. 7 (shtatë) SME të partnerizuara me KP kanë aplikuar për Voucher Inovacioni, nga të cilët 6 (gjashtë) janë përzgjedhur për të implementuar projektin e tyre. Është monitoruar ecuria e këtyre projekteve me asistencën e konsulentit të jashtëm dhe është raportuar në mbledhjet e Komitetit Drejtues të projektit për Vlerësimin e Jashtëm të Aksionit Pilot, për të cilën FSHZH është partner përgjegjës.

Janë kryer takime me përfaqësues të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit për të koordinuar informacionin mbi nismat në fushën e ekonomisë blu.

Është hartuar Plani i Portabilitetit të Rezultateve të projektit, që do të facilitojë fushatën e transferimit të këtyre rezultateve, i cili do të kryhet nëpërmjet një miksi të balancuar midis eventeve dhe platformës elektronike.

Projekti “ViP Dinarica”:**“Zgjatimi i ViP DinaricA në zonën ndërkufitare Shqipëri Kosovë”**

Buxheti i projektit:	444,684 Euro
Buxheti i projektit për FSHZH:	220,000 Euro
Kohëzgjatja:	24 muaj (Mars 2018 - Mars 2020)
Financues:	Bashkimi Europian, Programi CBC Shqipëri-Kosovë (2014 - 2020)
Shtetet pjesëmarrëse:	Shqipëria dhe Kosova.

Objektivi i Projektit: Të fuqizojë zhvillimin ekonomik ndërkufitar nëpërmjet modeleve unike të turizmit të qëndrueshëm të bazuar në vlerat natyrore, tradicionale dhe kulturore duke vënë në dukje karakteristikat e përbashkëta të zonës

Seksioni Via Dinarica, është një vazhdim i koncepteve të mëparshme të Via Dinarica dhe Majave të Ballkanit që ndërlidhin Bosnjë-Hercegovinën, Malin e Zi, Kosovën dhe Shqipërinë me më shumë se 1,000 km shtigje të pandërprera në distanca të gjata. Rrugët e reja Via Dinarica që lidhin shtigjet e ecjes dhe çiklizmit me Shqipërinë dhe Kosovën, përshkojnë parqet kombëtare Bjeshkët e Namuna, Komunat e Gjakovës, Deçanit, Junikut, Pejës dhe Shqipërisë, Bashkitë e Qarkut të Kukësit. Projekti synon zhvillimin më tej të vlerave turistike të komunitetit rural malor të zonave ndërkufitare të Shqipërisë dhe Kosovës, dhe u jep mundësi vizitorëve që të njihen me traditat e jetesës gjatë udhëtimit që përshkron shtegu Via Dinarica, duke eksploruar natyrën, historinë dhe kulturën e rajonit.

Është punuar me përmirësimin dhe përditësimin e planit të aktiviteteve dhe janë rishikuar afatet bazuar edhe në kushtet atmosferike si dhe janë përgatitur të gjithë materialet raportuese (për periudhën njëvjeçare të aktiviteteve të projektit). Është konkluduar me përzgjedhjen e një konsulence e cila do të përmirësojë gjurmën e evidentuar, do të përgatisë programin e FAM Tour dhe do të mbështesë organizimin e takimeve B2B gjatë zhvillimit të panairit.

Delegacioni i BE, ka zhvilluar një mision monitorimi dhe vizitë në terren në gjurmën e evidentuar. Gjatë këtij misioni monitorimi u diskutua edhe për ecurinë e mëtejshme të aktiviteteve të projektit sidomos ndërtimin e ballkoneve panoramike dhe përfundimin e vendosjes së tabelave dhe markimit të shtigjeve.

Në periudhën korrik - shtator, ka vazhduar puna nga konsulenca e përzgjedhur për përmirësimin e gjurmës së evidentuar të Via Dinarica. Janë shtuar rreth 30 km gjurmë të reja për ecjen në natyrë. Ky informacion është plotësuar me detaje në lidhje me nevojën dhe pozicionin gjeografik për vendosjen e tabelave informuese. Po kështu raporti i paraqitur prej tyre përmban edhe atraksionet që ka përgjatë gjurmës së identifikuar.

Në muajin shtator është realizuar takimi koordinues me delegacionin e BE-së ku janë sqaruar hapat e mëtejshme dhe nevoja për rishikim të datave të realizimit të aktiviteteve të mbetura dhe si pasojë edhe rishikim të afateve të përfundimit të projektit. Në kuadër të këtij aktiviteti është realizuar hartimi i axhendës së vizitës dhe dakordësimi me partnerin lead dhe përfaqësuesit e Delegacionit të BE si dhe çështje të tjera që lidhen me përfaqësimin me sukses dhe raportimin e ecurisë së projektit.

Është përfunduar markimi i shtigjeve. Për realizimin e kësaj është proceduar fillimisht me sigurimin e konsulencës së nevojshme për markimin e shtigjeve (përfshi hartimin e termave të referencës dhe ndjekjen e realizimit të tenderimit deri në lidhjen e kontratës). Më tej është proceduar me ndjekjen e realizimit të punës dhe përgatitjen e raportit përfundimtar.

Ndërkohë, është punuar në drejtim të evidentimit dhe përcaktimit të vendeve ku do të ndërtohen ballkonet panoramike. Pritet që gjatë muajit janar të jetë konkluduar me vendet ku do të ngrihen këto ballkone panoramike dhe të procedohet me tenderimin e design të tyre, për ti hapur rrugë më tej tenderit të ndërtimit.

Projekti:	FILA - Fertilization and Innovation Labs in Agro-food
Buxheti i projektit:	1,044,547 EUR
Buxheti për AZHR3:	176,798 EUR
Kohëzgjatja:	24 muaj (01.04.2018 - 31.03.2020)
Financues:	Interreg IPA CBC Itali - Shqipëri - Mali i Zi, (2014 - 2020)
Shtetet pjesëmarrëse:	Itali, Shqipëri, Mali i Zi
Objektivi i Projektit:	Forcimi i bashkëpunimit ndërkufitar dhe konkurrencës së SME-ve.

Objektivi i përgjithshëm i projektit është krijimi në rang ndërkufitar i laboratorëve FILA që janë “mjedise inovacioni” ku do të favorizohet bashkëpunimi midis aktorëve të sistemit të inovacionit (biznese të vogla të mesme, organizata që mbështesin bizneset, qendra kërkimore, investitorë) për të përmirësuar aksesin në proceset kërkimore dhe në rezultatet e sipërmarrjeve, pra për të stimuluar kërkimin e zgjidhjeve inovative dhe investime të mëtejshme në inovacion si dhe për të mbështetur strat-up-e. Ndryshimi i pritshëm është rritja e nivelit të inovacionit të SME-ve nëpërmjet mbështetjes që ofrojnë laboratorët FILA ndaj 50 OG-ve (grupeve operacionale) për inovacionin, sipas qasjes Europiane për Partneritet në Inovacion.

Gjatë vitit 2019 është finalizuar zbatimi i Paketës së Parë të aktiviteteve të projektit, si dhe një sërë aktiviteteve të Paketës së Menaxhimit. Në muajin korrik kanë iniciuar dhe aktivitetet e Paketës së Dytë të aktiviteteve.

Paketa e parë e zbatimit duke adresuar pikat e dobëta si: qasja nga poshtë-lart, kapaciteti i dobët menaxhues, përfaqësi e ulët e komponentit territorial, lidhje jo të forta ndërkombëtare dhe orientim i ulët i tregut, filloi me procesin e hartëzimit të praktikave ekzistuese më të mira të laboratorëve të inovacionit në nivel ndërkombëtar dhe lokal të grupeve operuese (OG) dhe vijoi me bashkë-krijimin e modelit inovativ FILA. Ky laborator përfshiu aktorët kryesorë të zinxhirit të inovacionit në agro-ushqim. Kjo paketë përfshin 5 nënaktivitete. Në këtë kuadër u realizuan me sukses gjatë periudhës Janar - Qershor 2019, 4 prej nënaktiviteteve:

- Mbledhja e të dhënave dhe hartimi i databazës së OG-ve në Shqipëri;
- Organizimi i 3 takimeve të “Laboratorëve të Gjallë” me aktorët e fushës së agro-ushqimit dhe inovacionit si: insitucione shtetërore rajonale, qendra kërkimore, fermerë, universitete, organizata lokale etj, për të identifikuar problematikat kyçe në këtë sektor; si dhe përgatitja e analizës sintezë të tre takimeve;
- Draft propozimi i modelit FILA, në bazë të sintezës së tre takimeve me aktorët e inovacionit;
- Pjesëmarrje në takimin ndërkufitar me të gjithë partnerët e projektit ku u dakortësua dhe finalizua modeli final i laboratorit FILA;

Paketa e dytë e zbatimit në vazhdimësi të konkretizimit të modelit FILA parashikon funksionimin/zbatimin e laboratorëve FILA në Rajonin e Puglias, Itali, Malin e Zi, Shqipëri dhe investime tematike. Modeli FILA fillon me lançimin dhe promovimin e 3 laboratorëve FILA, 1 për çdo shtet. Struktura e Laboratorit FILA në zyrat Rajonale Korçë të ADF, do të pajiset me një strukturë ex-novo. Investimet tematike përfshijnë pajisjet e nevojshme që FILA të ofrojë shërbime për sipërmarrësit dhe aktorët e inovacionit si dhe për të siguruar bashkëpunimin ndërkufitar midis laboratorëve. Kjo paketë përfshin 6 nënaktivitete. Nga këto deri në periudhën Shtator 2019 janë realizuar si më poshtë:

- Përfundimi i punës përgatitore për projektin teknik të punimeve dhe pajisjeve të laboratorit FILA, në bashkëpunim me stafin e Zyrës Rajonale Korçë dhe stafin teknik nga Zyrrat qendrore.
- Aktiviteti ndërkufitar i ngritjes së kapacitetit të manaxherëve të Laboratorit FILA, nga LP CIHEAM për katër menaxherë të Lab FILA për cdo shtet. Tre përfaqësues të PP3 (FSHZH) dhe një përfaqësues i PP4 (AIDA) morën pjesë në trajnimin 5 ditor në Bari, Itali, i zhvilluar në ambientet e CIHEAM Bari.

Në kuadër të Paketës së Menaxhimit janë realizuar aktivitete dhe proceset si më poshtë:

- Takim koordinues me të gjithë partnerët e projektit për periudhën 2 në Nikshic, Mal i Zi;
- Takim i ndërmjetëm i Komitetit Drejtues, në Nikshic, Mali i Zi, dhe rishikim i ndërmjetëm i suksesist të projektit nga JS (Sekretariati i Përbashkët);
- Deklarimi i shpenzimeve për periudhën raportuese 2;
- Finalizim i procesit të raportit progresiv të Periudhës 3 të zbatimit të projektit
- Finalizimi i kërkesës dhe ndryshimeve “Major change” për projektin në koordinim me Partnerët Lider.

Përgjatë periudhës Tetor-Dhjetor 2019, në kuadër të projektit “FILA” janë kryer një sërë aktivitete që lidhen gjithashtu me produktet kyç që projekti synon të realizojë deri në përfundimin e tij.

E para, është realizuar procedura e prokurimit dhe e kontraktimit të operatorëve ekonomikë përgjegjës për rikonstruksionin e një pjese të zyrave tona pranë njësisë rajonale Korçë dhe përshtatja për akomodimin e një laboratorit të inovacionit agro-shqimor. Procesi i rikonstruksionit ka përfunduar në muajin Dhjetor 2019.

Një punë tjetër e kryer në drejtim të funksionimit të laboratorit është edhe hartimi i listës së dhe ndjekja e procedurës së prokurimit të pajisjeve të këtij laboratorit të cilat janë të ndara në 3 kategori:

1. Pajisje zyrash (Tavolina karrige etj)
2. Pajisje elektronike (PC, laptops, dron etj)
3. Pajisje bujqësore (kite testerash etj)

Kjo procedure është ende në proces dhe pritet të përfundojë në fillim të muajit Shkurt 2020.

Një aktivitet tjetër i dobishëm i kryer përgjatë kësaj periudhe ishte takimi i partnerëve në Korçë në datën 24 Tetor ku përveç rishikimit të planit të aktiviteteve u dakortësua midis të gjithë partnerëve shtyrje me 6 muaj i projektit deri në muajin Tetor 2020.

Gjatë periudhës Tetor-Dhjetor 2019, ka qënë edhe terheqja e partnerit Regione Puglia nga projekti duke cuar si rrjedhim në procedura për tu ndjekur si dhe për të ndarë buxhetin tek partnerët e tjerë sipas fushës së veprimtarisë.

Projekti:	Standardet dhe Çertifikimi i produkteve bujqësore, Ngritja e Kapaciteteve në përthithjen e Fondeve dhe Strategjitë e Marketingut në Mbështetje të Rritjes Ekonomike dhe Tregtisë të Agrobizneseve
Buxheti Total i projektit:	310,000 EUR
Buxheti për AZHR2:	80,923 EUR
Kohëzgjatja:	24 muaj (30.11.2017- 30.11.2019)
Financues:	Programi i bashkëpunimit ndërkufitar Maqedoni-Shqiperi (IPA2) 2014-2015
Shtetet pjesëmarrëse:	Shqipëri, Maqedoni
Objektivi i Projektit:	Rritja e konkurrencës, biznesit, tregtisë dhe investimeve

Objektivi kryesor i projektit është të çertifikojë prodhuesit dhe përpunuesit në nën-sektorë si përpunimi i mishit, qumështit dhe nën-produkteve të tij, Frutave & Perimeve dhe Bimëve Medicinale me katër tipe çertifikatash të sigurisë ushqimore të njohura në nivel ndërkombëtar. Projekti do të synojë nxitjen e tregtisë në tregjet e Bashkimit Europian dhe rritjen e produktivitetit të sipërmarrjeve bujqësore përmes zhvillimit të kapaciteteve të brendshme (prodhuese, menaxhuese, marketing etj). Gjatë kësaj periudhe ka vijuar puna për zbatimin e projektit, monitorimi i projektit dhe i stafit të kontraktuar për ta menaxhuar atë, çertifikimi i disa bizneseve që operojnë në fushën e bujqësisë, ngritja e faqeve në disa rrjete sociale dhe përditësimi me materialet promovuese mbi aktivitetet e projektit.

Ka përfunduar puna e trupave çertifikuese, konsuletës për përgatitjen e planeve të biznesit dhe është duke përfunduar puna e konsulentit të mediave sociale për agrobizneset si dhe subjektit për inspektimin dhe çertifikimin për sistemet e menaxhimit të cilësisë (Global G.A.P dhe Organic).

Përgjatë tremujorit të katërt të vitit janë kryer disa aktivitete në drejtim të përfundimit me sukses të projektit si:

- Hartimi i termave të referencës, kontraktimi dhe organizimi i panairit të agrobizneseve dhe të takimit B2B në qytetin e Peshkopisë në datën 26 Nëntor.
- Përfundimi i certifikimeve Global GAP dhe ORGANIC nga trupa certifikuese e kontraktuar.
- Përfundimi i fushatës së marketingut në rrjete sociale nga konsulenti i projektit
- Mbyllja e të gjitha pagesave të mbetura për në fund të projektit

Projekti:	Co.Co.Tour. Ruajtja, rritja dhe promovimi i trashëgimisë natyrore dhe kulturore të komuniteteve bregdetare nëpërmjet nxitjes së modelit të eko-muzeut me qëllim menaxhimit të zgjuar dhe të qëndrueshëm të turizmit.
Buxheti Total i projektit:	1,079,523 EUR
Buxheti për AZHR4:	183,948 EUR
Kohëzgjatja:	24 muaj (03.04.2018-02.04.2020)
Financues:	Programi i bashkëpunimit ndërkufitar IPA CBC "Itali-Shqipëri-Mal i Zi"
Shtetet pjesëmarrëse:	Shqipëri, Mal i Zi, Itali
Objektivi i Projektit:	Menaxhimi i zgjuar i trashëgimisë natyrore dhe kulturore për shfrytëzimin e turizmit të

qëndrueshëm ndërkufitar dhe atraktivitetit territorial.

Ky projekt ka si objektiv të garantojë një përfshirje “të zgjuar” dhe një rritje të qëndrueshme të komuniteteve bregdetare në zonat e targetuara nëpërmjet zhvillimit të një modeli ndërkufitar eko-muzeumi dhe të një strategjie të përbashkët të fokusuar në konceptin “turizmi në komunitet”.

FSHZH është në pozicionin e partnerit kryesor dhe ka për detyrë koordinimin e partnerëve, aktivitetëve si dhe menaxhimin financiar të gjithë projektit.

Në periudhën Janar - Mars është punuar nga stafi teknik dhe menaxhues në bashkëpunim me Bashkinë Himarë për realizimin e Analizës Territoriale të Bashkisë Himarë. Është realizuar takim me Koordinatorin e Projektit dhe me Kryetarin e Bashkisë për t'u njohur nga afër me problematikat e projektit dhe arsyet e vonesës së rikonstruksionit të objektit i cili do të shërbejë si ekomuze në kuadër të projektit Co.Co.Tour.

Gjatë tremujorit të parë të 2019 është organizuar në Tiranë takimi i dytë i konsorciumit, me të gjithë partnerët e projektit dhe partnerin e asociuar AKZM. Gjatë takimit përveç arritjes së një kohezioni më të madh të grupit të partnerëve u synua edhe identifikimi i problematikave të hasura të cilat ndikuan në shtyrjen e shumë aktivitetëve dhe parashikimi i aktivitetëve të ardhshme për të arritur objektivat e synuara në kohën e duhur.

Përsa i përket tremujorit të dytë të 2019-ës, stafi i projektit ka punuar për paketën e menaxhimit duke përpiluar dokumente si: Plan menaxhimi, Planin e monitorimit dhe vlerësimit, Planin e aktivitetëve për gjashtëmujorin e parë për FSHZH, Planin e përgjithshëm të aktivitetëve për të gjithë projektin.

Në muajin Prill u zhvillua në Itali takimi ndërkufitar Itali-Shqipëri-Mali i Zi. Takimi ishte i një rëndësie të veçantë pasi ishte prezent edhe Stafi i Sekretariatit të Projekteve IPA, rajoni Puglia. Stafi i sekretariatit u njoh më nga afër me problematikat e projektit, gjithashtu informoi partnerët për parafinancimin dhe kërkoi informacion për arsyet e vonesave për secilin nga partnerët.

Në muajin Prill është përgatitur Raport Progresi i Përbashkët në sistemin eMS i cili i është dorëzuar Sekretariatit (JS) dhe zyrës së projekteve në FSHZH. Gjatë muajve Maj-Qershor është punuar për përpilimin e termave të referencës dhe prokurimit të Koordinatorit të Komunikimit të projektit.

Gjatë gjashtëmujorit të parë është punuar për mbarëvajtjen e projektit, identifikimin e problematikave dhe zgjidhjet e mundshme të tyre, është mbajtur një komunikim i vazhdueshëm me Partnerët e projektit, janë përcaktuar takimet e radhës të cilat do të organizohen në Mal të Zi, takimi i 3-të i konsortiumit dhe takimi i parë i komitetit drejtues.

Gjatë muajit Korrik janë asistuar partnerët e Malit të Zi për të zhvilluar takimin e tretë të konsorciumit të partnerëve dhe takimin e parë të komitetit drejtues. Për këto dy evente stafi i projektit ka punuar për përgatitjen e materialeve për prezantim dhe për mbarëvajtjen e takimeve.

Në lidhje me procesin e raportimit është punuar për përgatitjen e dokumentacionit për mbylljen e gjashtëmujorit të parë dhe raportimit në sistemin eMS. Gjithashtu, janë asistuar partnerët e projektit në të gjitha vështirësitë e hasura apo materiale të kërkuara.

Kemi punuar intesivisht me Koordinatorin e Komunikimit për vizibilitetin e projektit në web dhe rrjete sociale.

Gjatë muajit Gusht stafi ka qënë pjesë e takimit të parë të Komitetit Drejtues, organizuar në Mal të Zi.

Gjate muajit Shtator është punuar për hartimin e planit të prokurimit për periudhën 4. Janë hartuar dhe përpiluar termat e referencës dhe specifikimeve teknike rreth prokurimit të disa shërbimeve në kuadër të projektit.

Në sistemin elektronik eMS është punuar për ngarkim dokumentacioni dhe mbylljen e raportimit të periudhës 3. Në këtë periudhë janë përpiluar dhe janë mbledhur dokumentacione nga partneret për dorëzimin e materialeve të kërkuara pranë JS/MA mbi ecurinë e projektit.

Në bashkëpunim me bashkinë Himarë është punuar për identifikimin e “pikave të interesit” për projektin, takim me biznese të komunitetit të zonës dhe plotësimin e formularëve të aksesibilitetit. Pas përzgjedhjes së projektit Co.Co.Tour si pjesë e eksperimentimit të programit Panoramed është punuar për prezantimin e projektit në vija të përgjithshme dhe është realizuar një video-takim me stafin e programit dhe pjesëmarrës të tjerë.

Përgjatë tremujorit të katërt të vitit është punuar për kalimin e parafinancimit të projektit nga ana e Autoritetit Menaxhues të programit të bashkëpunimit dhe me kërkesë të këtij të fundit, FSHZH është audituar nga Agjencia e Auditimit të Fondeve të BE për të përcaktuar nëse për këtë projekt, duke qënë partneri lider nëse kemi ngritur sisteme kontrolli, monitorimit dhe të menaxhimit të projektit.

Përgjatë muajit Dhjetor u zhvillua në Podgoricë takimi i rishikimit afat-mesëm të projektit (mid-term review meeting) me pjesëmarrjen e të gjithë partnerëve, të sekretariatit të përbashkët të programit si dhe autoriteteve përkatëse nga Shqipëria (Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme) si dhe nga Mal i Zi (zyra për BE në Malin e Zi.), për të monitoruar progresin e aktiviteteve të projektit bazuar me formularin e aplikimit. Në këtë takim u lanë disa detyra që duhen përbushur deri në përfundim të gjashtëmujorit të parë të 2020 për të evituar rrezikun e zbritjes së buxhetit të alokuar të projektit (de-committment).

Projekti:	Complete
Buxheti Total i projektit:	631,435 EUR
Buxheti për AZHR4:	153,913 EUR
Kohëzgjatja:	24 muaj (26.03.2018-26.03.2020)
Financues:	Programi i bashkëpunimit ndërkufitar IPA CBC “Greqi-Shqipëri 2014-2020”
Shtetet pjesëmarrëse:	Shqipëri, Greqi
Objektivi i Projektit:	Mbështetje në rritjen e ekonomisë lokale

Projekti ka si objektivi të mbështesë sipërmarrjen dhe të rrisë konkurrueshmërinë e SME-ve të përfshira në sektorin blegtoral përmes inovacioneve të aplikuara në kujdesin shëndetësor të kafshëve dhe në sipërmarrjen e fermave të gjësë së gjallë. Në të njëjtën linjë si projektet e tjera të bashkëpunimit ndërkufitar të cilat janë të mbartura nga ish agjencitë e zhvillimit rajonal, është finalizuar procedura e ndryshimit të partnerit me firmosjen e marrëveshjes së rifreskuar të partneritetit dhe hapjen e userit të ri në sistemin MIS për të kryer raportimet.

Stafi rajonal është angazhuar me vizita të shpeshta në terren për të identifikuar profilin ekonomik dhe social të fermave të angazhuara në mbarështimin e kafshëve, një aktivitet kyç që do të shërbejë më pas ekspertëve të angazhuar për hartëzimin e sëmundshmërisë së kafshëve në këtë rajon. Janë vendosur marrëdhëniet e bashkëpunimit të vazhdueshëm me Fakultetin e Veterinarisë pranë Universitetit

Bujqësor të Tiranës (partneri nr 3) në lidhje me implementimin e aktiviteteve të projektit në zonën e lejuar në Shqipëri. Është konkluduar për numrin e saktë dhe shpërndarjen gjeografike të fermave të përzgjedhura brenda zonës së lejuar të Qarkut Gjirokastrë - Bashkitë Kelcyre, Përmet, Gjirokastrë, Dropull dhe Libohovë. Në vijim pritet që numri i fermave të zgjerohet në një masë të vogël edhe në Qarkun Vlorë - në zonat kufitare të Bashkisë Konispol.

Konsulenti i menaxhimit të projekteve është përzgjedhur nga fusha e veterinarisë në mënyrë që hartimi i termave të referencës të jetë sa më profesional dhe jo vetëm, por edhe implementimi i projektit të ketë një garanci më tepër në plotësimin e standardeve të cilësisë së kërkuar të kësaj fushe shkencore.

Është hartuar dhe është bërë dorëzimi elektronik i progres raportit narrativ dhe financiar për periudhën nr. 2 pranë partnerit kryesor të projektit, si edhe është dorëzuar për vlerësim dosja e shpenzimeve të projektit për periudhën nr. 1 në platformën elektronike MIS dhe pranë Zyrës së Kontrollit të Nivelit të Parë pranë Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme.

Në bashkëpunim më konsulentin e menaxhimit të projektit kemi punuar për hartimin e termave të referencës për prokurimin e ekspertëve të jashtëm të fushës studimore përsa i përket këtij projekti.

Është bërë përpjekje e vazhdueshme për realizimin e takimit të radhës të partnerëve të projektit në qytetin e Korçës, por për arsye të pengesave të ndryshme ky takim nuk është bërë e mundur të realizohet.

Në kushtet e vonesës së takimit është kërkuar vazhdimisht bashkëpunimi në distancë me lead partnerin dhe partnerët e tjerë për vijimin e aktiviteteve të projektit.

Në muajin Dhjetor është aprovuar kërkesa për shtyrjen e projektit me 6 muaj deri në fund të muajit Shtator 2020.

Projekti “Smart Heritage”:

Menaxhim i qëndrueshëm dhe promovimi i trashigimisë së përbashkët kulturore.

Buxheti i projektit:	1,379,210 Euro
Buxheti i projektit për FSHZH:	179,660 Euro
Kohëzgjatja:	24 muaj (Janar 2019 - Dhjetor 2020)
Financues:	Bashkimi Europian, Programi ADRION
Shtetet pjesëmarrëse:	Bosnjë-Hercegovina, Greqia, Italia, Kroacia, Shqipëria,
Objektivi i Projektit:	Promovimi i valorizimit të qëndrueshëm dhe ruajtja e trashigimisë kulturore dhe natyrore si asete rritjeje në zonën e Adriatiko-Jonianit.

Objektivi i përgjithshëm i projektit “Smart Heritage” është promovimi, valorizimi dhe mbrojtja e trashëgimisë kulturore në rajonin e Adriatikut dhe Jonit, në veçanti duke promovuar atraksionet turistike dhe duke ulur sezonalitetin turistik në rajonin e projektit.

Ky projekt ka filluar zyrtarisht në Janar 2019, pas ndryshimit të partnerit kryesor dhe shtyrjes për gati 1 vit të zbatimit të projektit. Në fund të muajit Shkurt u vijua me fimosjen e marrëveshjes së re të partneritetit si dhe ndjekjen e procedurave të nevojshme të hapjes së userit në sistemin eMS si dhe me identifikimin dhe emërimin e stafit që do të menaxhojë projektin.

Përgjatë periudhës raportuese stafi i projektit ka qënë i angazhuar me përgatitjen e planit të punës, identifikimin e institucionit të trashëgimisë kulturore që do të jetë përfitues i projektit si dhe me përgatitjen e termave të referencës dhe ndjekjen e procesit të prokurimit për 2 konsulencia, atë të auditit të jashtëm të projektit dhe të trajnimit për palët e interesuara dhe aktorët e turizmit e trashëgimisë kulturore.

Gjithashtu në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës është përzgjedhur instituti përfitues i projektit dhe ku do të zbatohen aktivitetet kyçe, Muzeu Arkeologjik i Durrësit. Është përzgjedhur konsulenti i cili do të kryejë trajnimet e grupeve të interesit në këtë muze lidhur me kulturën dhe turizmin. Në lidhje me proceset raportuese është dorëzuar dhe çertifikuar raporti i periudhës nr 1 të projektit që mbulon periudhën nga muaji Janar-Qershor 2019.

Përgjatë tremujorit të katërt të 2019, janë kryer aktivitetet e mëposhtme kyçe:

1. Finalizimi i marrëveshjes së mirëkuptimit midis Ministrisë së Kulturës dhe FSHZH.
2. Finalizimi i trajnimit 12 ditor për palët e interesit të trashëgimisë kulturore
3. Në proces përfundimi prokurimi i konsulencës për zbatimin e fushatës së ndërgjegjësimit për muzeun arkeologjik të Durrësit.
4. Finalizuar raporti i parë i auditit të jashtëm të projektit

Projekti:	Almonit-MTC “Shqipëri, Mal i Zi, Itali, Lidhja e transportit multimodal”
Buxheti Total i projektit:	7,000,000 EUR
Buxheti për FSHZH:	2,940,000 EUR
Kohëzgjatja:	37 muaj dhe 16 Ditë (15.05.2019-30.06.2022)
Financues:	Programi i bashkëpunimit ndërkufitar IPA CBC “Itali-Shqipëri-Mal i Zi”
Shtetet pjesëmarrëse:	Shqipëri, Mal i Zi, Itali
Objektivi i Projektit:	Rritja e koordinimit midis palëve të interesit për promovimin e lidhjeve të qëndrueshme në zonën e bashkëpunimit.

Zona e projektit është e fragmentuar në dy anët e detit Adriatiko-Jon midis Italisë, Shqipërisë dhe Malit të Zi dhe në dy anë të Liqenit të Shkodrës / Liqeni i Shkodrës dhe Lumi Buna midis Shqipërisë dhe Malit të Zi.

Zona ka një akses të dobët dhe karakterizohet nga sistemet e transportit me ndërveprim të ulët, duke ndikuar negativisht në lidhjet ndër-rajonale.

Qëllimi i projektit është të krijojë një partneritet aktiv afatgjatë midis palëve të interesuara përkatëse, nëpërmjet lidhjeve multimodale në ujërat e brendshëm dhe ato detare.

Projekti ka 2 produkte finale:

1. Krijimin e një lidhjeje multimodale në ujërat e brendshme të liqenit të Shkodrës midis Malit të Zi dhe Shqipërisë
2. Krijimin e 4 itinerarëve të rinj në Adriatik midis: portit të Barit (It), Tivarit (MNE), portit të Shëngjinit dhe atij të Molizes (It).

Përgjatë periudhës raportuese është kryer një analizë e aktiviteteve të projektit duke përcaktuar stafin që duhet alokuar sipas periudhave. Është mbajtur kontakt i vazhdueshëm me sekretariatit e përbashkët teknik të programit për të finalizuar elementët formalë si firmosja e kontratës së grantit (Subsidy Contract), marrëveshjes së partneritetit si dhe aktivizimi i userit në sistemin e raportimit Ems.

Organizuar nga autoriteti i programit të bashkëpunimit ndërkufitar më 1 Tetor 2019, u zhvillua në Podgoricë një takim pune lidhur me procedurat e raportimit si dhe rregullat e pranueshmërisë së shpenzimeve të kryera në kuadër të projektit si dhe mbi rregullat e komunikimit.

Në datat 21-22 Nëntor, u zhvillua në Tiranë, takimi fillestar hapës i projektit me pjesëmarrjen e të gjithë partnerëve, përfaqësues të ministrive, përfaqësues të autoritetit menaxhues, përfaqësues nga pushteti vendor etj.

Dita e parë u konceptua si një takim publik me pjesëmarrjen e mediave ku u prezantuan partnerët si dhe një prezantim i përgjithshëm i projektit, objektivat, rezultatet etj.

Në ditën e dytë u organizua një takim i mbyllur i partnerëve të projektit ku u prezantua në detaje të gjitha elementët e menaxhimit të projektit, raportimi, certifikimi i shpenzimeve si dhe u dakortësua plani i përditësuar i aktiviteteve.

8. Përgatitja dhe aplikimi për programe të reja

Një nga shtyllat e aktivitetit të FSHZH është programimi bazuar në analizën reale të nevojave, potencialeve që gjenerojnë impakt në zhvillim, duke vijuar më tej me gjetjen e burimeve të financimit, aplikimin pranë donatorëve, sigurimin e fondeve për financim dhe gjithë përgatitjet e nevojshme për të siguruar kalimin nga programimi në fazën e zbatimit të projekteve. FSHZH ka vijuar procesin e programimit dhe hartimit të projekteve si më poshtë:

8.1 Programi për Zhvillimin e Integruar të Zonave me Potencial Turistik

Programi parashikon investime strategjike rajonale në zonat me potencial turistik në Bashkitë e Shkodrës, Korçës, Fierit, Beratit. Programi do të financohet nga BERZH dhe IPA me vlerë të pritshme financimi 105 milionë Euro. Ky program është në fazë programimi dhe parashikohet të ketë kohëzgjatje 4 vjeçare.

Është konkluduar marrëveshja e delegimit mes BERZH e Komisionit European si dhe Qeverinë Shqiptare për të mundësuar fillimin e zbatimit të programit nga FSHZH. Gjatë kësaj periudhe është përgatitur lista prioritare e investimeve.

Në kuadër të këtij programi, FSHZH aplikoi dhe fitoi një grant të WBIF përmes BERZH që mundëson vazhdimin e studimit të Bregut Perëndimor të Liqenit të Shkodrës, pra vazhdimin e projektit të rivitalizimit të Shirokës, për ta vijuar këtë nismë deri në kufi, përfshirë dhe Zogaj, me synim hapjen e kufirit në këtë zonë dhe bashkëpunimit me Malin e Zi. Vlera e grantit është 400 mijë Euro dhe është në proces zbatimi gjatë periudhës 2018 - 2019.

8.2 Projekti Porta bregdetare e Alpeve

Projekti në vlerën 2.5 milion Euro, fokusohet në bashkitë Shkodër, Malësi e Madhe dhe Lezhë dhe specifikisht në zonën liqenore të Liqenit të Shkodrës, në fashën lumore të Bunës si dhe në bregdetin Adriatik të Velipojës dhe Shëngjinit.

Pritet nënshkrimi i marrëveshjes ndërmjet Bankës Europiane të Investimeve (BEI) dhe Ministrisë së Financave. Aktualisht është hartuar Marrëveshja e Bashkëpunimit midis FSHZH dhe BEI. Projekti përfshin zonat urbane por gjithashtu edhe zonat natyrale dhe mjedisore të këtyre bashkive.

Projekti ka dy komponentë kryesorë:

- Studimin e integruar urban dhe turistik të zonës;
- Përgatitjen e projekteve teknike specifike për zonën;

Lidhur me këtë projekt janë finalizuar termat e referencës për hartimin e studimit të kësaj zone si dhe është përgatitur dosja e prokurimit për komponentin e parë. Studimi do të kryhet përmes konsulencës e cila do të manaxhohet nga BEI në bashkëpunim të ngushtë me FSHZH. Studimi pritet të fillojë së shpejti dhe financohet nga BEI, në vlerën 220,000 Euro.

8.3 Programi i investimeve për zhvillim të integruar rajonal

Programi parashikon ndërhyrje infrastrukturore të integruara në funksion të nxitjes së zhvillimit ekonomik të zonave me potencial turistik, si rrugë, sheshe e shëtitore, hapësira rekreacioni dhe sportive. Programi bashkëfinancohet nga Qeveria Gjermane, ku parashikohet që faza e I-rë të financohet përmes një kredie të butë nga KfW në vlerë të përgjithshme deri në 50 milionë Euro (pjesa e parë 20 milion Euro) dhe bashkëfinancim nga Qeveria Shqiptare për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikqyrjen e projektit në vlerë të përgjithshme deri në 1 milion euro. Programi ka filluar fazën e konceptimit dhe programimit në vitin 2018. Po vijohet me hartimin e Termave të Referencës dhe parashikohet që faza e parë të perfundojë në në gjashtëmujorin e parë të vitit 2020.

Programi përfshin dy rajone kryesore:

Rajoni Korçë

Bashkia Pogradec

Përsa i përket Bashkisë Pogradec si zonë ndërhyrjeje është përcaktuar zona e vijës liqenore në qytetin e Pogradecit deri në fshatin Tushemisht. Projekti është ende në fazë konceptuale dhe maturimi i tij nuk ka nisur ende. Pjesë e programit është edhe fshati Lin. Për këtë ndërhyrje është përgatitur fisha konceptuale dhe investimet parashikohet të përfshijnë ndërhyrje infrastrukturore, kulturore dhe mjedisore të zonës liqenore dhe urbane të fshatit Lin.

Bashkia Pustec

Programi përfshin ndërhyrje në zonën e Zaroshkës dhe Pustecit. Për të dyja zonat është përgatitur koncepti dhe është dërguar pranë KfW. Ndërhyrjet në zonat urbane dhe liqenore të Zaroshkës dhe Pustecit përfshijnë të njejtat tipologji ndërhyrjeje si në rastin e fshatit Lin.

Rajoni Vlorë

Në rajonin e Vlorës përfshihen zonat bregdetare Qeparo - Borsh - Lukovë - Piqeras. Ndërhyrjet do të prekin disa aspekte të territorit të këtyre zonave:

- përmirësimin e infrastrukturës publike;
- përmirësimin e infrastrukturës turistike etj;

Për të dy rajonet janë përgatitur Termat e References për aktivizimin e një konsulencie e cila do të zhvillojë koncepte specifike për zonat e projektit si dhe do të përgatisë programin e investimeve prioritare që do të financohen në një fazë të dytë. Konsulenca do të menaxhohet nga KfW në bashkëpunim të ngushtë me FSHZH.

9. AKTIVITETI INSTITUCIONAL

9.1 Menaxhimi Financiar

Analiza financiare për vitin 2019, bazuar në sistemin raportues të pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve, jep informacion kryesisht mbi funksionet kryesore financiare: planifikimin, kontabilitetin, menaxhimin financiar të investimeve dhe atë operativ-administrativ.

Gjatë vitit 2019, janë bërë përpjekje për ruajtjen dhe garantimin e ekuilibrave financiarë të institucionit në mënyrë që i gjithë aktiviteti ekonomik-financiar të jetë i organizuar brenda limiteve të miratuara të financimit. Gjithashtu vëmendje i është kushtuar administrimit dhe menaxhimit të fondeve me përgjegjshmëri dhe transparencë, si dhe monitorimit dhe mbikqyrjes së detajuar të fondeve sipas komponentëve përkatës: investime në infrastrukturë, administrim i brendshëm, asistencë teknike, etj.



Në zbatim të Ligjit nr. 99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019” limiti buxhetor për Fondin Shqiptar të Zhvillimit ishte në vlerën 17,098 milionë Lekë ose rreth 134 milionë Euro, ndërkohë buxheti i rishikuar me Aktin Normativ nr.2 datë 02.10.2019 dhe Aktin Normativ nr.11, datë 24.12.2019 “Pwr disa ndryshime në ligjin nr 99/2018 “Për Buxhetin e vitit 2019” te ndryshuar buxheti faktik arrin në vlerën 14,633 milionë Lekë nga të cilat:

- **5,370 milionë lekë** janë financim i huaj, për programet në vazhdim dhe të reja, në zbatim të marrëveshjeve qeveritare të nënshkruara me donatorë të huaj;
- **6,635 milionë lekë** janë financim i brendshëm, investime publike në vazhdim dhe të reja, si dhe përfshihet kosto lokale, TVSH;
- **2,400 milionë lekë** janë financim i brendshëm, në kuadër të Fondit për Zhvillimin e Rajoneve dhe do të shërbejë për financimin e projekteve të reja, si edhe për shlyerjen e detyrimeve për investime të kontraktuara në periudhën 2014-2017;

Realizimi i buxhetit, për vitin 2019 është në masën 90 %. Më poshtë tabela e realizimit për çdo kategori të zërave të buxhetit.

Realizimi i Buxhetit për vitin 2019

Kategoria	Totali i Përgjithshëm		
	Buxheti vjetor (Lekë)	Realizimi viti 2019 (Lekë)	%
Punime Civile	13,080,205,523	12,245,074,978	94%
Design&superv.	728,654,144	501,828,099	69%
Asistence Teknike	111,295,333	100,733,323	91%
Training	25,665,000	13,377,088	52%
Investime &Paisje FSHZH	20,537,000	2,937,524	14%
Kosto Operative	451,593,000	341,807,841	76%
Kosto menaxhimi 2017-2018	205,719,000	-	-
Rezerve	4,000,000	-	-
T o t a l i	14,627,669,000	13,205,758,854	90%



Pasqyrat financiare që paraqiten më poshtë, përmbajnë të dhëna të cilat krijojnë një skenar të qartë të mjedisit ekonomiko-financiar dhe të performancës së aktivitetit të FSHZH-së, si dhe një analizë në nivelin strukturor të shpenzimeve dhe të të ardhurave duke paraqitur në këtë mënyrë raportin si dhe peshën specifike të donatorëve, kategorive dhe komponentëve të veçantë gjatë këtij viti.

Gjatë këtij viti, në zbatim të udhëzimeve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, janë përgatitur Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin ushtritor 2018, të cilat në datë 31 Mars 2019 janë dorëzuar në MFE, si dhe në Degën e Thesarit.

Kompania e auditimit të jashtëm Grant Thornton, e përzgjedhur nga MFE ka filluar në muajin Janar 2019, procesin e auditimit të Pasqyrave Financiare për vitin ushtritor 2017, proces i cili ka përfunduar me dorëzimin e raportit përfundimtar nga kompania e përzgjedhur.

Është përcjellë pranë MFE, në cilësinë e institucionit që kryen përzgjedhjen e kompanisë audituese, kërkesa si dhe Termat e Referencës për auditimin e

Pasqyrave Financiare për vitin ushtrimor 2018. Gjithashtu është përcjellë dhe shqetësimi lidhur me vonesën e fillimit të auditimit për vitin ushtrimor 2018 pasi në marrëveshjet respektive me donatorët raporti duhet të ishte dorëzuar brenda muajit Qershor 2019. Kompania është ende në proces auditimi dhe ende nuk është dorëzuar raporti përfundimtar.

Gjatë vitit 2019, Njësia e Audit të Brendshëm ka kryer një proces auditimi për programin “Zhvillimi i Integruar Urban dhe Turizmi”, financuar nga Banka Botërore për periudhën 2017 - Mars 2019, për programin “Rehabilitimi i Rrugës së Lumit të Vlorës” financuar nga Fondi Kuvajtian si dhe për Programin “Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale III” financuar nga KfW, Departamenti i Financës ka vënë në dispozicion të gjithë informacionin e kërkuar.

Gjatë këtij viti në FSHZH kanë qënë dy grupe auditimi nga Kontrolli i Lartë i Shtetit për programet si më poshtë:

- Mbi zbatimin e rekomandimeve për projektin “Zhvillimi i Alpeve dhe Zonave Bregdetare” si dhe për projektin “Fondi i Investimeve Sociale IV”;
- Për programet dhe projektet e financuara nga buxheti i shtetit për periudhën 2017- Qershor 2019, lidhur me vlerësimin e aktivitetit ekonomik-financiar për ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e përdorimit të fondeve të përdorura, për të cilin kanë dorëzuar dhe raportin përfundimtar dhe rekomandimet mbi gjetjet gjatë periudhës së auditimit.

Në zbatim të Udhëzimit nr. 8, datë 28.02.2019 dhe Udhëzimit 21 datë 10.07.2019 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2020 - 2022” të MFE, pas punës përgatitore me departamentet është përpunuar informacioni lidhur me përmbylljen e fazës së parë dhe fazes së dytë, PBA 2020 - 2022, e cila është dorëzuar në MFE në përputhje me afatet kohore të përcaktuara.

Departamenti i Financës, gjatë këtij viti, ka raportuar në mënyrë periodike pranë MFE dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit, sipas kërkesave lidhur me:

- Monitorimin e investimeve publike me financues të huaj etj;
- Disbursimet dhe shpenzimet sipas programeve dhe donatorëve respektivë;

Njëkohësisht janë dërguar raportet periodike të raportimit pranë Banka Botërore, KfW dhe CEB në përputhje me formatet sipas marrëveshjeve respektive lidhur me burimin dhe përdorimin e fondeve për vitin 2018 si dhe vitin 2019.

Pranë MFE, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit dhe Drejtoria e Përgjithshme të Thesarit, është dërguar kërkesa me detajimin e buxhetit për çdo program me financim të huaj, si dhe për çdo kod për objektet me financim të brendshëm për vitin 2019, si dhe është ndjekur në vazhdimësi sipas rastit çdo kërkesë për rialokim në nivel programi dhe kapitulli.

Aktualisht FSHZH ka në ndjekje financiare këto programe:

- Programi PK IV, “Zhvillimi i Alpeve Shqiptare dhe Zonave Bregdetare”, financuar nga CEB, WBIF dhe Qeveria Shqiptare;
- Programi “Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale III”, financuar nga KfW, IPA 2013, WBIF, Qeveria Shqiptare dhe përfituesit e drejtpërdrejtë;
- Programi “Rehabilitimi i Rrugës së Lumit të Vlorës”, financuar nga Fondi Kuvajtian, Fondi Saudit dhe Qeveria Shqiptare;

- Programi “Për Zhvillimin e Integruar Urban dhe Turizmin”, financuar nga Banka Botërore;
- Programi “Rrugët Lidhëse Rurale dhe Rajonale” financuar nga Banka Botërore;
- Programi “Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale IV” - Himarë, Orikum financuar nga KfW;
- Programi IPA Adrion, Intereg-Med, Vip Dinarica CBC – Kosovo dhe Ipa Trilateral;
- Programi Infrastruktura Vendore dhe Rajonale në kuadër të Fondit të Zhvillimit të Rajoneve.
- Programi për Rehabilitimin e Segmenteve Rrugore Prioritare, financuar nga Qeveria Shqiptare;

Disbursimi i Fondeve gjatë vitit 2019, sipas programeve

Gjatë vitit 2019, FSHZH ka menaxhuar fondet e akorduara nga donatorët e huaj, Qeveria Shqiptare si dhe Fondi i Zhvillimit të Rajoneve.

Për periudhën Janar - Dhjetor 2019, në kuadër të programeve me financim të huaj janë disbursuar rreth 6,630 milionë Lekë respektivisht për secilin program si më poshtë:

- Programi Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale III, janë disbursuar nga KfW kredi 1,110 milionë Lekë, nga KfW Grant 44 milionë Lekë dhe nga IPA 2013 janë disbursuar 560 milionë Lekë.
- Programi “Për Zhvillimin e Integruar Urban dhe Turizmin” janë disbursuar nga Banka Botërore 874 milionë Lekë;
- Programi “Rehabilitimi i Rrugës së Lumit të Vlorës”, janë disbursuar nga Fondi Kuvajtian 1,142 milionë Lekë;
- Programi “Rrugët Lidhëse Rurale dhe Rajonale” janë disbursuar nga Banka Botërore 1,796 milionë Lekë;
- Programi PK IV, “Zhvillimi i Alpeve Shqiptare dhe Zonave Bregdetare” janë disbursuar nga CEB 1,092 milionë Lekë;
- Programi “IPA Adrion, Intereg-Med dhe Vip Dinarica CBC - Kosovo” janë disbursuar rreth 12 milionë Lekë;

Fondet e akorduara nga Qeveria Shqiptare:

Për programet me financim të huaj si bashkëfinancim për Kosto lokale dhe TVSH janë disbursuar rreth 1,468 milionë Lekë si dhe rreth 6,977 milionë Lekë nga përfituesit për investime;

Të ardhura të tjera

Gjatë aktivitetit ekonomik-financiar të saj, FSHZH realizon të ardhura në vlera monetare nga aktivitetet dytësore, si shitja e dokumentave të tenderit, interesa depozitë me afat, konfiskime garancish etj. Gjatë vitit 2019, janë arkëtuar rreth 3.51 milionë Lekë të ardhura nga shitja e dokumentave për tender si dhe 1.14 Lekë të ardhura nga interesat e depozitave me afat.

Shpenzimet dhe Realizimi i Zërave të Buxhetit për vitin 2019

Gjatë vitit 2019, FSHZH ka menaxhuar një fond prej rreth 13,257 milionë Lekë, me një realizim financiar në masën 90 % kundrejt buxhetit të rishikuar me Akt Normativ, pasqyruar sipas komponentëve si më poshtë:

Infrastruktura


Ky zë përbën aktivitetin kryesor të institucionit dhe përfaqëson investimet në infrastrukturë për:

- punime civile për rikonstruksion dhe përmirësim të infrastrukturës rrugore,
- gjelbërim të infrastrukturës rrugore dhe objekteve të tjera,
- rehabilitim të zonave urbane,
- rehabilitim dhe ndërtim të ujësjellësave ruralë,
- restaurimin e objekteve të trashëgimisë kulturore etj.

Investimet në infrastrukturë për vitin 2019 janë realizuar në masën 12,245 milionë Lekë ose rreth 94 % e buxhetit të rishikuar. Gjatë këtij viti kanë qenë në proces zbatimi rreth 34 kontrata punimesh, nga programe me financim të huaj, nga të cilat 7 janë kontrata të reja. Gjithashtu në kuadër të Programit të investimeve të Qeverisë Shqiptare, janë në zbatim rreth 34 kontrata dhe janë nënshkruar 3 kontrata të reja për të cilat nuk ka pasur financim gjatë vitit 2019. Në kuadër të programit Infrastruktura Vendore Rajonale gjatë 2019 kanë qenë në zbatim 7 dhe janë nënshkruar 5 kontrata të reja për të cilat nuk ka pasur financim.

Realizimi financiar për periudhën Janar - Dhjetor 2019 për kategorinë “Investime”

Programet	Pesha specifike në % kundrejt realizimit	Realizimi në vlerë (Lekë)
PK IV Zhvillimi.Alp.Shqiptare Zona Bregdetare CEB	8.93%	1,093,214,990
Rehabilitimi i Rrugës së Lumit të Vlorës Fondi Kuvajtian	8.70%	1,065,429,770
Programi për Zhvillimin e Integruar Urban dhe Turizmin BB	2.07%	253,501,271
Programi Furnizimit me Ujë III KfW	11.98%	1,466,914,543
Programi Rrugët Lidhëse Rajonale	2.74%	335,903,031
Programi “IPA Adrion, Intereg-Med dhe Vip Dinarica CBC - Kosovo”	0.01%	1,787,995
Investime Qeveria Shqiptare+TVSH+FZHR+Kosto Lokale	65.56%	8,028,323,378
Totali	100%	12,245,074,978



Projektim - Supervizimi

Gjatë këtij viti ky zë është realizuar në vlerën rreth 501 milionë Lekë ose 69 përqind kundrejt buxhetit të rishikuar dhe përfshin shpenzime për projektim dhe supervizion të punimeve civile sipas programeve përkatëse:

- Programi PK IV, “Zhvillimi i Alpeve Shqiptare dhe Zonave Bregdetare” janë financuar nga CEB rreth 28 milionë Lekë;
- Programi “Për Zhvillimin e Integruar Urban dhe Turizmin”, janë financuar nga Banka Botërore rreth 50 milionë Lekë;
- Programi “Rrugët Lidhëse Rurale dhe Rajonale”, janë financuar nga Banka Botërore rreth 6 milionë Lekë;
- Programi Segmentet Rrugore Prioritare, janë disbursuar rreth 133 milionë Lekë për supervizion dhe kolaudim;
- Programi “Rehabilitimi i Rrugës së Lumit të Vlorës”, janë disbursuar rreth 77 milionë Lekë;
- Programi “Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale III”, janë disbursuar rreth 195 milionë Lekë;
- Programi “Infrastruktura Vendore dhe Rajonale”, në kuadër të Fondit të Zhvillimit të Rajoneve janë disbursuar rreth 12 milionë Lekë;

Asistenca Teknike

Është realizuar në vlerën rreth 100 milionë Lekë ose 91 përqind kundrejt buxhetit të rishikuar dhe përfshin shpenzime në kuadër të:

- Programit “Për Zhvillimin e Integruar Urban dhe Turizmin”, në vlerën 27.40 milionë Lekë;
- Programeve IPA Adrion, IPA Trilateral dhe Intereg Med në vlerën 18 milionë Leke;

- Programi PK IV, “Zhvillimi i Alpeve Shqiptare dhe Zonave Bregdetare,në vlerën 4.42 milionë Lekë;
- Programi “Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale III” në vlerën 47 milionë Lekë;
- Qeveria Shqiptare si bashkefinansues për projektet me financim të huaj ne vlerën 3.2 milionë Lekë.

Kualifikime

Është realizuar në vlerën rreth 13.37 milionë Lekë ose 52 përqind kundrejt buxhetit të rishikuar dhe përfshin shpenzime te financuara nga IPA Adrion, Interreg Med dhe VIP Dinarica Kosova dhe me bashkefinansim nga Qeveria Shqiptare,kryesisht për pjesëmarrje në takime me përfaqësuesit e programeve.Gjithashtu eshte organizuar dhe trajnimi për 31 persona staf FSHZH, me temë “Menaxhimi dhe administrimi i kontratave “FIDIC “ financuar nga CEB Grant.

Investime dhe pajisje

Gjatë vitit në këtë komponent janë disbursuar rreth 2.93 milionë Lekë ose 14 përqind kundrejt buxhetit të rishikuar, për rehabilitimin e zyrave të katit të dytë të FSHZH-së, për blerjen e kondicionerëve,mobilje orendi dhe paisje kompjuterike për nevoja të stafit.

Shpenzime operative

Shpenzimet operative administrative gjatë vitit janë realizuar në vlerën 342 milionë Lekë ose rreth 76 përqind kundrejt buxhetit të parashikuar.

Realizimi i zërave të shpenzimeve të kësaj kategorie kundrejt buxhetit vjetor është paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Realizimi i kostos operative kundrejt buxhetit faktik 2019 Analiza e shpenzimeve të kostos operative

REALIZIMI KUNDREJT BUXHETIT 2019 (Kosto operacionale) Lekë				
Nr.	Zërat	Buxhet 2019	Realizimi 2019	Përqindja e Realizimit
1	Kanceleri	4,420,000	2,750,488	62%
2	Karburant	13,000,000	5,312,334	41%
3	Servis makinash/siguracion	9,500,000	6,484,504	68%
4	Pagat	354,023,000	293,696,898	83%
5	Dieta	5,350,000	3,501,281	65%
6	Telefon dhe PT	3,400,000	2,102,793	62%
7	Internet	1,700,000	832,815	49%
8	Energji Elektrike/Ujë	3,600,000	2,850,280	79%
9	Zyra me qera	8,450,000	6,998,668	83%
10	Mirembajtje/Sigurim godine	11,199,000	8,934,556	80%
11	Te tjera/Petty cash	6,056,000	2,279,552	38%
12	Publikimi & Promovime	5,103,000	2,477,579	49%
13	Kontrata Sherbimi	20,398,000	885,073	4%
14	Shp. gjyqesore/perkthime	4,294,000	677,608	16%
15	Servis kompjuter dhe fotokopje	1,100,000	855,750	78%
16	Bank charges		1,075,303	
	TOTAL	451,593,000	341,715,482	76%

a. Shpenzimet për kancelari

Shpenzimet kryesore në këtë zë janë kryesisht për blerje materiale zyre, kancelari të ndryshme, letër, bojra për fotokopje dhe printera, etj. Buxhetit vjetor për këtë zë është parashikuar 4,4 milion Lekë. Shuma e përdorur gjatë këtij viti është 2.8 milionë Lekë.

b. Shpenzimet për karburant

Buxheti vjetor për këtë zë të shpenzimeve është 13 milionë Lekë. Kontrata për këtë shërbim është lidhur gjatë muajit Qershor 2019, gjatë kësaj kohe shuma e shpenzuar për karburant është 5.3 milion Lekë

c. Shpenzimet për mirëmbajtje dhe siguracion të automjeteve

Këto shpenzime përfshijnë shërbimet periodike, shërbimet e veçanta, blerjen e pjesëve të këmbimit, gomave dhe siguracionin e mjeteve. Buxheti i parashikuar për këtë zë është rreth 9,5 milionë Lekë. Realizimi gjatë këtij viti është rreth 6.50 milionë Lekë ose në masën 68 përqind kundrejt buxhetit vjetor të parashikuar.

d. Shpenzimet për paga, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore

Shpenzimet për pagat dhe sigurimet shoqërore për vitin 2019 janë parashikuar në shumën 354 milionë Lekë. Ky zë është realizuar në masën 83 përqind kundrejt buxhetit të miratuar. Në këtë zë është përfshirë edhe sigurimi i jetës, shendetit dhe pensionit suplementar si dhe trajtimi ushqimor.

e. Shpenzimet për dieta e shërbime

Shpenzimet për dieta dhe shërbime për vitin 2019 janë parashikuar në shumën 5.35 milionë Lekë. Ky zë shpenzimesh është realizuar në vlerën 3.5 milion Lekë ose 65 përqind kundrejt buxhetit të parashikuar dhe mbështet kryesisht aktivitetin e kryer nga Departamenti i Infrastrukturës për mbikqyrjen e objekteve në terren si dhe ndjekjen e realizimit të objekteve të investimit të FZHR-së në gjithë vendin.

f. Shpenzimet e komunikimit

Në këtë zë përfshihen shpenzimet për komunikim si dhe shpenzimet e shërbimit postar. Ky zë është parashikuar 3,4 milionë Lekë dhe është realizuar në vlerën 2.1 milion Lekë ose 62 përqind kundrejt buxhetit vjetor të parashikuar.

g. Shpenzime të tjera

Në zërin shpenzime të tjera përfshihen shërbim interneti, facilitete dhe qera rajonale të FSHZH-së, energji elektrike, ujë, ruajtje e godinës, mirëmbajtje e sistemeve të zyrave qendrore, siguracione, seminare të stafit, blerje të vogla etj. Për këtë zë në buxhetin 2019 janë parashikuar rreth 31 milionë Lekë. Ky zë është realizuar në vlerën 20.8 milionë Lekë ose 67 përqind kundrejt buxhetit të parashikuar.

h. Publikime & Promovime

Në këtë zë përfshihen shpenzimet për analizat periodike të stafit, dizajne, printime, publikime, përgatitje video dhe dokumentarë dhe njoftime të ndryshme në shtyp (njoftime për tendera, punësime, etj). Në buxhetin e vitit 2019 për këtë zë janë parashikuar rreth 5.1 milionë Lekë. Gjatë këtij viti janë realizuar shpenzime në masën 2.50 milion Lekë ose rreth 49 përqind kundrejt buxhetit të parashikuar.

i. Kontrata shërbimi dhe shpenzime gjyqësore, përkthime, noterizime

Në këtë zë përfshihen shpenzime gjyqësore dhe asistencë juridike si dhe pagesa për kontrata shërbimi. Për këtë zë në buxhetin 2019 janë parashikuar rreth 24.69 milionë Lekë. Gjatë këtij viti shpenzimet për këtë zë janë në vlerën 1.60 milion Lekë ose 6 përqind kundrejt buxhetit të parashikuar.

j. Servis kompjuter dhe fotokopje

Në buxhetin e vitit 2019 për këtë zë janë parashikuar rreth 1.1 milion lekë për mirëmbajtjen e pajisjeve kompjuterike dhe fotokopjeve. Shpenzimet për këtë zë janë realizuar në vlerën 856 mijë lekë ose rreth 78 përqind kundrejt buxhetit të parashikuar.

9.2 Marrëdhëniet me Grupet e Interesit

Gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2019 Njësia e Marrëdhënieve me Grupet e Interesit është fokusuar në formalizimin dhe përmirësimin e komunikimit të brendshëm, ndërkohë që ka vazhduar intensivisht puna për komunikimin e jashtëm në funksion të konsolidimit të reputacionit të organizatës.

Ndër risitë e periudhës së fundit të vitit është dhe krijimi i Newsletter-it, gazetës elektronike të FSHZH-së e cila përmban informacion të përmbledhur lidhur me projektet në fokus, të reja nga projektet në zbatim, si dhe mbi tematikat shëndeti dhe siguria në punë e mjedisi.

Newsletter-i është dygjuhësh (shqip dhe anglisht) dhe shpërndahet në një rreth të gjerë aktorësh dhe partnerësh të FSHZH.

NjMGI është angazhuar në mbështetje të organizimit të aktiviteteve publike nga dhe ka dhënë mbështetje me përgatitjet përpara eventeve, por edhe me publikimin e tyre përmes kanaleve të komunikimit të FSHZH.

Komunikimi i brendshëm

NjMGI në bashkëpunim me Njësitë e tjera të Departamente të ndryshme ka përpunuar dhe finalizuar produkte për tu përcjellë te publiku. Po ashtu, në bashkëpunim me njësitë e tjera të DFM u finalizuan edhe udhëzimet e detajuara të komunikimit të brendshëm mes Departamenteve, Njësive për një komunikim sa më efikas dhe korrekt me bashkëpunëtorët e jashtëm. Këto udhëzime së bashku me formatet e shkresave u shpërndanë te të gjithë anëtarët e stafit.

Komunikimi me jashtë dhe marrëdhëniet me publikun

Për ruajtjen dhe konsolidimin e reputacionit përballë palëve financuese, partnerëve, aktorëve të interesit dhe publikut të gjerë, komunikimi dhe marrëdhëniet me publikun kanë synuar të sigurojnë një komunikim dinamik dhe mbi të gjitha të ndershëm. Komunikimi me audiencat e jashtme nuk mund të jetë i suksesshëm nëse informacioni nuk koordinohet mirë së brendshmi. Për këtë arsye NjMGI në bashkëpunim me të gjitha departamentet dhe PMU-të është siguruar që informacioni që ofrohet për të gjitha audiencat jashtë FSHZH të jetë i saktë dhe me cilësi.

Gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2019 janë publikuar 167 artikuj dhe njoftime në Eëbsite-in e FSHZH, nga të cilat 10 janë histori njerëzore dhe 15 produkte audiovizuale të cilat prezantojnë programin e Qeverisë për zhvillimin e infrastrukturës vendore rajonale. Publikimet synojnë që të nxirret në pah impakti real i projekteve që FSHZH zbaton. Artikujt e publikuar në eëbsite-in e FSHZH janë përkthyer në mbi 1050 raportime mediatike. Qëllimi është që FSHZH dhe mediat e saj të kthehen në burim e parë të informacionit për projektet që zbaton vetë, duke synuar orientimin e gazetarëve dhe publikut drejt faqes zyrtare të internetit apo platformave sociale të FSHZH kur u nevojitet informacion.

Faqja e FB të FSHZH është shpesh porta kryesore e kërkesave apo ankesave të qytetarëve të thjeshtë që preken nga zbatimi i një projekti të caktuar. Kërkesat/ankesat e ndryshme vijnë nëpërmjet mesazheve, të cilat kanë marrë përgjigje nga ana e NjMGI pas konsultimit me njësitë apo departamentet përkatëse brenda 24 orëve. Në rastet e raportimeve jo pozitive apo të pabazuara në informacion të saktë mbi projektet që FSHZH zbaton, NjMGI në bashkëpunim me Departamentin e Infrastrukturës dhe Departamentin e Menaxhimit të Projekteve ka përgatitur artikuj informues që më pas janë shpërndarë përmes kanaleve të komunikimit të organizatës dhe janë replikuar nga mediat.

Kërkesa për informacion

Gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2019 janë administruar 25 kërkesa për informacion nga media, zyra avokatie dhe qytetarë. Kërkesat për informacion janë administruar në bazë të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit” në bashkëpunim edhe me Departamentin Juridik dhe të Prokurimeve, si dhe me Njësinë e Arkivës.

Kërkesat kanë konsistuar në ecurinë e objekteve në zbatim, aktet e dorëzimit të objekteve të përfunduara, ankesa të banorëve të zonave të projekteve lidhur me cilësinë e punimeve, etj.

Përgjigjet e të gjitha kërkesave për informacion janë reflektuar në regjistrin e kërkesave që është publikuar në faqen e internetit të FSHZH.



Faqja zyrtare e internetit dhe faqja në Facebook, Instagram dhe YouTube janë kanalet që FSHZH përdor për të komunikuar dhe aktorët e interesit, partnerë, bashkëpunëtorë, përfitues direktë ose indirektë dhe me publikun e gjerë.

Platformat e komunikimit online janë përdorur si një instrument, për të konsoliduar reputacionin dhe imazhin e organizatës si zbatuese të projekteve në terren, por edhe orientuese e zhvillimit ekonomik afatgjatë.

- Gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2019 në Facebook në total ka patur 309 postime.
- Komuniteti i ndjekësve në Facebook ka pësuar rritje të konsiderueshme dhe është tashmë mbi 13,723.
- Në çdo lajm ditor shënohen adresat zyrtare të institucionit, duke gjeneruar trafik dhe në faqen zyrtare.

Postimet kanë qenë të përditshme dhe është dhënë informacion konkret, për secilin objekt dhe projekt për të cilin FSHZH është përgjegjëse. Kjo në bashkëpunim me departamentet e tjera për të marrë informacionin më të fundit dhe fotot nga terreni.

Në to janë të prezantuar pjesa më e madhe e programeve, prej ujësjellësave ruralë, ecuria ditore e çdo kantieri në vend dhe eventet apo bashkëpunimet me donatorët.

Ka një tendencë në rritje për numrin e ndjekësve, ndarjen e postimeve nga institucione të tjera qendrore dhe lokale, si dhe nga agjenci të tjera.

- E njëjta gjë vlen edhe për Instagram-in, 169 postime që tashmë ka shkuar në mbi 1,462 ndjekës.

Cilësia e informacionit dhe fotove apo videove të përdorura ka qenë burimi kryesor i rritjes së numrit të ndjekësve.

Krijimi i Instagram Stories me 3-4 foto me informacion specifik për secilën prej tyre ka rritur

ndërveprimin e FSHZH-së me ndjekësit e saj

- 36 korrespondenca në rrjetin social Facebook, të ndjekura në bashkëpunim me departamentet përkatëse mbi problematika dhe shqetësime të caktuara nga qytetarët.

Një pjesë e mirë e postimeve rishpërndahen nga partnerë dhe institucionet financuese, çka rrit vizibilitetin dhe audiencën. Vëmendje u është kushtuar edhe komentuesve të ndryshëm, të cilët kanë marrë përgjigje në kohë reale për pyetjet apo kërkesat e drejtuara.

Gjithashtu janë zhvilluar “Histori Njerëzore” deri më tani, në 6 lokacione të ndryshme:

- “Dumreja e liqeneve”
- Puka- “parajsa e fshehur e turizmit dhe aventures”
- “Ndërtoj sepse jam grua”- artikull mbi festën e 8 Marsit
- Duke filluar me ndërhyrjet për të shmangur përmbytjet në Shkëmbin e Kavajës në zonën e plazhit dhe rehabilitimin e Përroit të Durrësit. Takime me banorë të zonës të gatshëm për të treguar eskperienat personale para dhe pas punimeve në terren. Janë zhvilluar 7 intervista para përgatitore për shkrimin e materialit.
- Në Pukë për rikualifikimin urban të këtij qyteti duke i ofruar një qendër të re. Janë zbardhur 3 intervista mediatike me përfaqësues të agjencive turistike, banorë të zonës dhe sipërmarrës që kanë investuar në qytet dhe vijonin punën e përditshme në reklamimin e vendit elementevë turistikë që qyteti ofron. (materiale 1- 2 orë).
- Në Shëtitoren “Taulantia” komunikimi me bizneset pranë vijës së detit, qytetarët e rastësishëm, të cilët ende nuk kishin ndijeni specifike mbi projektin. Janë zhvilluar 4 intervista dhe në bashkëpunim me menaxherët dhe teknikët në terren, përgatitëm një artikull informues të plotë, me të gjitha ndërhyrjet teknike, hapësirën ku do të zhvillohej, duke sqaruar për të gjitha përmirësimit dhe zgjidhjet që ofroheshin për komunitetin.
- Qendra e Turizmit Valbonë komunikimi me turistët e shumtë në zonë, me bizneset lokale dhe si ju ka ndikuar në rritjen e të ardhurave. “Konkurrenca e shtuar” për banorët e zonës, për të ndërtuar bujtinën me kushtet më të mira duke rritur numrin e këtj shërbimi. Janë zhvilluar 4 intervista paraprake, për përgatitjen e materialit.
- Projekti për rehabilitimin e Lumi Zezë - Fushë Krujë një ndërhyrje e pritur nga banorët e zonës prej vitesh. Një numër i lartë intervistash nisur dhe nga skepticizmi mbi funksionimin e projektit. Komunikimi me banorët pranë shtratit në të dy anët e lumit, me sipërmarrës në tregun e qytetit, me familjarë të cilët kishin përjetuar peripeci ekstreme deri në frikën për jetën ndër vite. Janë zhvilluar rreth 11 komunikime me persona, të gjendur rastësisht në terren por që njëkohësisht të interesuar për informacion nga stafi i institucionit.
- Faza II - Rehabilitimi i qendrës Tamarë, rikonstruksioni i rrugës Vermosh - Doganë si dhe mbrojtja lumore dhe ura mbi përroin e Budacit. Ky investim zhvillohet në kuadër të programit “Punët në Komunitet IV: “Zhvillimi i Alpeve dhe Zonave Bregdetare”.
- Rruga “Agim-Babunje” – akses për banorët e zonës

Në kuadër të prezantimit të programit të Qeverisë për zhvillimin e Infrastrukturës Vendore Rajonale janë përgatitur 15 produkte audiovizuale:

- Material audiovizual për segmentin Gusmar - Kuç që lidh Tepelenën, Gjirokastrën dhe Përmetin me rrugën e Lumit të Vlorës dhe Bregdetin. Ky


segment krijon lidhje mes turizmit bregdetar me turizmin natyror, kulturor dhe historik.


- Në Lushnje për xhirime në aksin rrugor Babunjë - Agim për të nxjerrë në pah impaktin që ka sjellë rruga e re për fermerët dhe bizneset e asaj zone. Në intervistë Adriatik Rrasa, skulptur i zonës që tregon lehtësitë që i ka sjellë rruga për transportin e materialeve që i duhen për punën e tij dhe produktet përfundimtare.
- Material audiovizual 'Transformimi nga Jugu në Veri - Shqipëria po punon' i cili pasqyron pothuajse të gjitha objektet në punë e sipër të Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe impaktin që ato kanë në jetën e përditshme për qytetarët dhe thirrjen që ju bëjnë turistëve për t'i vizituar në çdo kohë.
- 'Puka - Ndryshimi rrenjësor i parajsës së fshehur të Veriut' - Material audiovizual mbi rikualifikimin urban në Pukë nëpërmjet programit 'Punët në Komunitet IV, Zhvillimi i Alpeve shqiptare dhe zonës bregdetare' financuar nga qeveria shqiptare dhe Banka e Këshillit të Evropës. Ky material pasqyron punën e Fondit Shqiptar të Zhvillimit në qytetëzën alpine për rikonstruksionin e rrugëve lidhëse të spitalit, rehabilitimin e sheshit të qytetit dhe fasadave të objekteve pranë sheshit të Bashkisë, mbrojtjen e liqenit të vogël dhe ndërhyrjet e tjera plotësuese në parkun pranë ish-Hotel Turizmit.
- Ura e Zezës - Fushë Krujë - Material audiovizual mbi rikonstruksionin e plotë të Urës si dhe rehabilitimin e lumit Zezë për të treguar impaktin e ndërhyrjes në një gjatësi lumore prej 4 kilometrash për të zgjidhur njëherë e mirë problemin e përmytjeve për 1,800 familjet dhe 100 bizneset e zonës. Materiali tregon të dhënat konstruktive të urës së re, detajet teknike të sistemit të shtratit të lumit dhe intervista të banorëve për besimin që ata kanë tek ekipi i Fondit Shqiptar të Zhvillimit për zgjidhjen e problemit të përmytjeve.
- Në Durrës - 'Investimet në Infrastukturë - Impakt i menjëhershëm në turizëm'. Përgatitja e një materiali audiovizual të plotë, me punën në vazhdim për 'Shëtitorën Taulantia', transformimin në Shkëmbin e Kavajës dhe transformimin në plazhin e Golemit. Materiali nxjerr në pah punën e Fondit Shqiptar të Zhvillimit në shndërrimin e këtyre zonave në atraksione turistike.
- Gjirokastër, 'Qyteti i Argjenditë rrëzë Malit të Gjerë' - Video promovuese rreth punës së Fondit Shqiptar të Zhvillimit për investimet e kryera tek 'Qafa e Pazarit' në kuadër të projektit 'Zhvillimi i Integruar Urban e Turistik në Shqipëri' financuar nga qeveria shqiptare dhe Banka Botërore.
- Programi i infrastrukturës vendore dhe rajonale 2019 - 2021 - Material audiovizual rreth investimeve në 34 projekte të integruara me impakt në turizëm dhe bujqësi. Impakti social trajtohet me rëndësi për të kuptuar lehtësitë që investimet e Fondit Shqiptar të Zhvillimit iu ofrojnë qytetarëve.
- Programi i furnizimit me ujë i zonave rurale FUZR3 - Material audiovizual rreth ndërhyrjeve për furnizimit me ujë të pijshëm 24 orë ,në zonat rurale nga Veriu në Jug për 83,000 banorë në 15 bashki.

- Video promovuese rreth Qendrës së Turizmit në Valbonë që shtrihet në 4180 m² hapësirë me 2 ndërtesa kryesore me destinacion zyra dhe ambiente shërbimi për turistët si dhe 4 shtëpiza të reja druri për akomodimin e turistëve. Intervistë me një turist të huaj, i cili tregon pëlqimin e tij për natyrën shqiptare dhe projektin e ri të Fondit Shqiptar të Zhvillimit.
- Roskovec - Material i shkurtër audiovizual, i cili tregon punën në vazhdim për 'Rikualifikimin urban Roskovec, blloku nr.2' dhe impaktin që ka për baonrët e zonës.
- Material i shkurtër audiovizual mbi punën e Fondit Shqiptar të Zhvillimit në rikualifikimin urban të Bulevardit Maliq - Drithas dhe impaktin që ky projekt ka për Maliqin në daljen më shpejt në treg në një zonë bujqësore dhe me potenciale të mëdha agroturistike.
- 3 Materiale audiovizuale rreth aktiviteteve të Fondit Shqiptar të Zhvillimit.

Në vijim kemi suportuar zyrën e IPA me përgatitje informacioni, gjatë dhe në përfundim të aktivitetit. (Shkrime për shtyp dhe artikuj përmbledhes, konkretisht për konferencën në Ancona - Projekti 4 helix +, përmes programit Interreg Med mbi sektorin e ekonomisë detare të Mesdheut.) Si dhe përgatitje e njoftimeve për shtyp (press release) mbi evente të caktuara.

*Shënim: Duke theksuar suporti nga (teknikët në terren dhe menaxherët e kontratave, në marrjen e informacionit teknik, për shkrimet përkatëse.)






Faqja zyrtare e Fondit Shqiptar të Zhvillimit - www.albaniandf.org


Gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2019 në faqen e Internetit janë publikuar 167 artikuj ne gjuhën shqipe dhe angleze në rubrikën Info&lajme/lajme, ndër të cilat 10 janë histori njerëzore dhe 15 materiale audiovizuale. Artikujt e shpërndarë nëpërmjet faqes së internetit dhe platformave sociale të FSHZH-së janë përkthyer në 1,050 raportime mediatike.

Gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2019, ka pasur 37,212 vizitorë në faqen e internetit. Koha mesatare e qëndrimit për këtë vit është 3m 12s. Ka pasur 80.6% vizitorë të rinj ndërsa 19.4% janë vizitorë besnikë që kthehen përsëri.

Klikimet në faqen e internetit vijnë nga kërkimet organike 51.8%, kërkimet nga rrjetet sociale 23.3%, kërkimet direkte 22,3% dhe pjesa tjetër janë nëpërmjet faqeve të tjera.



Top Channels



Krahas motorit të kërkimit Google, platformat sociale kanë qenë një rrugë nëpërmjet së cilës vizitorët kanë aksesuar faqen e internetit të FSHZH-së. Faqja e internetit është gjithmonë në përmirësim me rubrika të shtuara dhe informacion të përditësuar rregullisht në të dyja gjuhët: shqip dhe anglisht. Në funksion të përmirësimit të faqes së internetit janë shtuar rubrika të reja. Këto risi janë përqëndruar në strukturë dhe në përmbajtje. Ndër to mund të përmendim riformatimin e seksionit të projekteve IPA sipas standardeve të BE-së për komunikimin dhe vizibilitetin. Lidhja e faqes së projekteve IPA në faqen e internetit të FSHZH-së me faqet zyrtare të secilit projekt. Rubrika e praktikave të punësimit është një tjetër element i shtuar që do të shërbejë për informimin e studentëve dhe jo vetëm, në praktika seminare apo intership-e të mundshme për këtë target grup. Pasurimi i rubrikës së prokurimeve më rregjistrin e kontratave është një element që do të ofrojë transparencë etj.

Identiteti Korporativ dhe brandimi

Identiteti korporativ është pjesë e rëndësishme e Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe përfaqëson mënyrën sesi organizata prezantohet përpara të gjithë aktorëve të interesit, përfshirë edhe punonjësit e saj. Identiteti korporativ i FSHZH përbëhet nga Logo, tipografia, imazhet & materialet promociionale dhe rregullat e design-it korporativ.

Të gjithë elementët e mësipërm janë zbatuar në të gjithë aktivitetin e FSHZH që nga formati i shkresave deri te prezantimet publike në evente apo në media.

Në kuadër të identitetit korporativ është përgatitur dhe design i disa posterave t për ambientet e brendshme të Fondit Shqiptar të Zhvillimit (sallës së mbledhjeve) me të dhëna të përgjithshme mbi 4 rajonet dhe projektet që FSHZH ka implementuar.

Është përgatitur design për Neësletter dygjuhësh duke respektuar identitetin korporativ i cili dërgohet tek të gjithë aktorët e interesit.

Janë përgatitur materialet promociionale të fundvitit si kalendarë, axhenda, planer dhe kartolina elektronike.

Janë përgatitur Visitor Badges dhe Staff Badges me një design të ri për të paraqitur më mirë identitetin korporativ të FSHZH-së.

Është përgatitur një material leaflet A4 me instruksione për realizimin e fotografive sa më kuptimplote për objektet në punim e sipër, dërguar menaxherëve të kontratave.

Janë përgatitur disa postera sensibilizues për Sigurinë në Punë të cilat janë dërguar stafit të FSHZH-së dhe janë printuar për ambientet e brendshme të zyrave. Është konceptuar dhe design-uar një leaflet informues mbi projektet e FSHZH-së me fokus Turzimin për projektet IPA.

9.3 Monitorimi dhe Vlerësimi

Gjatë vitit 2019, ka vijuar monitorimi i ecurisë së projekteve kryesore në zbatim nga FSHZH. Puna për monitorimin e tyre ka konsistuar në marrjen, përpunimin, vlerësimin dhe raportimin e të dhënave dhe treguesve kryesore të ecurisë, duke përfshirë avancimin teknik dhe atë financiar. Me kërkesë të donatorëve, ministrive të linjës dhe të interesuarve të tjerë janë përgatitur raporte periodike dhe informacione që lidhen me ecurinë dhe indikatorët e performancës.

Puna për monitorimin dhe vlerësimin e projekteve është fokusuar në dy drejtime kryesore:

- Ndjekjen, monitorimin, raportimin dhe vlerësimin e projekteve në zbatim dhe atyre që janë drejt përfundimit;
- Përgatitjen e kuadrit të monitorimit dhe vlerësimit të projekteve që sapo kanë filluar apo pritet të fillojnë;

Është ndjekur nga afër ecuria e Projektit për Zhvillimin e Integruar Urban dhe Turizmin, Projektit “Punët në Komunitet IV”, “Projekti i Rehabilitimit të Segmenteve Rrugore Prioritare”, “Projekti i Investimeve Prioritare me impakt të lartë në zhvillimin dhe promovimin e turizmit, 2018 - 2019”, “Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale III”, “Fondi i Zhvillimit të Rajoneve”, Rruga e Lumit të Vlorës. Monitorimi bazohet në treguesit periodikë të komponentëve kryesorë të projekteve duke i krahasuar me planet e punës. Një vëmendje e veçantë i është kushtuar monitorimit dhe vlerësimit të projekteve që sapo kanë filluar nga puna apo pritet të fillojnë.

Në kuadër të Projektit për Zhvillimin e Integruar Urban dhe Turizmin, vijon puna për fazën e dytë të vlerësimit të impaktit. Njëkohësisht janë mbledhur të dhëna statistikore dhe informacione mbi sektorin e turizmit në zonën e shtrirjes së projektit.

Në kuadër të projektit Punët në Komunitet IV, financuar nga CEB, janë përgatitur Termat e References për Vlerësimin e Përfituesve dhe ka përfunduar përgatitja e dokumentacionit shoqërues për hapjen e procedurave të tenderimit.

9.4 Auditimi i brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm, zhvillon aktivitetin bazuar në planin strategjik dhe vjetor të auditimit të miratuar në Këshillin Drejtues, si dhe në programet e aprovuara për çdo mision auditimi nga Drejtori Ekzekutiv. Planet e auditimit bazohen në qëllimin dhe misionin e Auditit të Brendshëm të përcaktuar në standardet ndërkombëtare për praktikën profesionale të Auditimit të Brendshëm si dhe në analizen e riskut të projekteve/programeve në implementim në FSHZH.

Gjatë vitit 2019, Njësia e Auditimit të Brendshëm ka realizuar:

- 1) Hartimin e Raportit të aktivitetit të Njesisë së Auditimit të Brendshëm (deklarimin në Ministrinë e Financave, raportimin për analizë vjetore dhe mbledhje Bordi);
- 2) Ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme për


- Rehabilitimin e Lumit të Vlorës (në terren) ;
 - Programin Zhvillimi i Alpeve Shqiptare dhe Zonave Bregdetare (në terren);
- 3) Ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH gjatë vitit 2018 për:
- Programin SIF IV;
 - Projektin e Lungomares (përputhshmëria e rregullshmëria mbi projektet “Gjelbërimi i shëtitorës së vijës bregdetare të Vlorës” dhe “Mbushja me rërë e plazhit Vlorë”, si pjesë integrale e projektit “Vija bregdetare e Vlorës-Lungomare”);
 - Programin Punët në Komunitet IV, (përputhshmëria e rregullshmëria mbi projektin “Zhvillimi i Alpeve Shqiptare dhe Zonave Bregdetare”).
- 4) Auditimin me temë: “Vlerësimi teknik dhe financiar i ciklit të plotë të nënprojekteve të përfshira në Projektin e Zhvillimit të Integruar Urban Turizmin, të financuar nga BB”, të miratuar nga DE me 26.03.2019 deri me 26.05.2019;
- 5) Auditimin me temë: “Verifikim në terren dhe vlerësimi i projekteve infrastrukturore pas periudhës së garancisë dhe marrjes në dorëzim nga NJVV dhe ARRSH”, të miratuar nga DE me 06.06.2019 deri me 23.08.2019;
- 6) Hartim përgjigje-raporti në lidhje me auditimet e KLSH “Mbi verifikimin e zbatimit të detyrave dhe masave të rekomanduara në auditin e mëparshëm”:
- Projekti “Zhvillimi i Alpeve Shqiptare dhe Zonave Bregdetare”;
 - Projekti “Fondi i Investimeve Sociale IV”;
- 7) Hartim përgjigje-raporti në lidhje me auditimin e KLSH me temë: “Fondi Shqiptar i Zhvillimit, për Programet dhe Projektet e Financuara nga Buxheti i Shtetit”;
- 8) Hartim program auditimi me temë: “Vlerësimi i fazës së prokurimit dhe të zbatimit të punimeve për Projektin Furnizimit me Ujë i Zonave Rurale III, financuar nga KfW dhe IPA 2013 si dhe “Vlerësimi i fizibilitetit dhe dokumentacionit të planifikimit për Projektin e Furnizimit me Ujë i Zonave Rurale IV, financuar nga KfW, WBIF dhe QSH”;
- 9) Auditim me temë: “Vlerësimi i cilësisë të zbatimit të punimeve të projektit “Rikonstruksioni i rrugës së Beratit (Plasmas-Karbunarë), si dhe testim me prova laboratorike në terren. Hartimi dhe ndjekja e Marrëveshjes së Bashkëpunimit me ARRSH dhe kërkesë për aprovim nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- 10) Ndjekje në terren e vlerësimit të objekteve të dëmtuara nga tërmeti 26.11.2019 sipas grupeve të punës e specialistes teknike të Auditit nga periudha 01 Dhjetor 2019 - 10 Janar 2020, bazuar në Urdherin e Ministrit Nr.4 datë 15.12.2019 nga Komiteti i Emergjencave Civile;
- 11) Hartim i Planit Strategjik dhe Vjetor 2020-2022 të NJAB , sipas kërkesës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e harmonizimit të Audit të Brendshëm.

9.5 Burimet Njerëzore


Strategjia e Burimeve Njerëzore është pjesë e strategjisë së FSHZH, në mbështetje dhe realizim të filozofisë dhe vizionit të institucionit, për një strukturë organizative efiçente dhe rritje të performancës në nivel individual dhe institucional.

Veprimtaria e Njesisë së Burimeve Njerëzore konsiston në:

- ✓ Rekrutimin dhe mbajtjen e profesionistëve më të mirë :
Për të arritur këtë qëllim për pozicionet e mbetura vakante nga Njësia e Burimeve Njerëzore është ndjekur procedura e rekrutimit në zbatim të legjislacionit në fuqi si dhe Manualit të Procedurave të FSHZH. Gjatë vitit 2019 u rekrutuan 41 punonjës të rinj, 40 profesionistë dhe 1 me arsim të mesëm.
Stafi i FSHZH në janar 2019 ishte 125 punonjës, dhe në fund të vitit 2019 arriti në 130 punonjës, nga të cilët 3 me kohë të pjesshme.



Një vëmendje e veçantë nga Njësia e Burimeve Njerëzore i kushtohet aspektit gender në rekrutimin e stafit dhe arritjes së përbërjes gjinore përfaqësuese femra - meshkuj.



- ✓ Staf të motivuar dhe të kënaqur
 - Punonjësit e FSHZH i nënshtrohen vlerësimit periodik të performancës çdo tremujor, në këtë periudhë është realizuar vlerësimi në fund të muajve mars, qershor, shtator, dhjetor 2019;
 - Promovim mbi bazë arritjesh dhe vlerash individuale; Gjatë këtij viti u promovuan në detyrë 3 punonjës dhe në pagë 12 punonjës të tjerë.
- ✓ Trajnim i vazhdueshëm për përditësim dijet dhe staf proaktiv

- Stafi nxitet të zhvillohet profesionalisht si dhe të përmirësojë dhe përditësojë njohuritë e tij. Në këtë kuadër u realizua edhe testimi i stafit për Manualin e Procedurave të FSHZH;
- Nevojat për trajnim të stafit të FSHZH, të përditësuara edhe me të dhënat nga testimi, janë pasqyruar në një bazë të dhënash;

Në këtë kuadër FSHZH ka organizuar një sëri trajnimesh me qëllim përditësimin e vazhdueshëm të njohurive të stafit.

Gjatë vitit 2019, janë organizuar trajnime që lidhen kryesisht me administrimin dhe menaxhimin e kontratave FIDIC, inovacionin dhe sipërmarrjes, auditimin dhe tematika të lidhura me bashkëpunimin ndërkufitar. Gjithashtu është mundësuar pjesëmarrja në një numër udhëtimesh studimore, workshop-e dhe takime të organizuara në kuadër të zbatimit të projekteve. Janë trajnuar për dhënien e ndihmës së parë 25 punonjës të FSHZH.

- ✓ Staf etik dhe të përgjegjshëm, përforsim të vlerave njerëzore
 - Krijimi i një mjedisi të shëndoshë në punë për personelin ku dominojnë raportet korrekte të bashkëpunimit, respektimi i ligjeve e rregullave, kolegjaliteti, etika dhe objektiviteti në kryerjen e detyrave të punës;
 - Respektimi i disiplinës në punë është një proces që ndiqet periodikisht;
- ✓ Aktivitete periodike me bazë mujore:
 - Llogaritje paga, raporte mjekësore, dieta, vjetërsia në punë;
 - Deklarime dhe çdeklarime të punonjësve në sistem;
 - Urdhëra për vjetërsinë në punë, shpërblimet (një herë në 3 muaj), emërimet stafi në role të reja, ndryshim pozicioni dhe page, ndërprerje marrëdhënie pune, leje vjetore për t'u konsumuar, shoqëruar me relacionet përkatëse;
 - Vërtetime sipas kërkesave të stafit për të ardhurat mujore, vërtetime për bazën e vlerësueshme për përfitimin e pensionit, etj;
 - Hartime dhe nënshkrim kontratash punësimi;
 - Përpilim dosjesh të personelit të ri dhe përditësim të dosjeve të vjetra;
 - Hedhje e informacionit të stafit në software;
 - Përpilimi i kalendarit të harmonizuar të lëvizjeve të stafit gjatë javës dhe muajit dhe krahasimi me fingerprint;
 - Organizime trajnimesh dhe pjesëmarrje në trajnime;
 - Mirëmbajtje dhe përditësim i databazës së NJBNJ.

Performanca institucionale në fokus

Njësia e Burimeve Njerëzore përveç organizimit të punës për performancën individuale ka një fokus të veçantë edhe tek performanca institucionale. Në këtë kuptim po punohet për hartimin e pyetësorëve për matjen e performancës institucionale nga stafi, donatorët, përfituesit e projekteve të FSHZH, apo grupe të tjera interesi.

Raportimi ditor

Me qëllim ndjekjen e zbatimit të detyrave të realizuara në bazë ditore nga stafi si dhe për të gjykuar mbi ngarkesën e çdo pozicioni pune në FSHZH, Njësia e Burimeve Njerëzore përgatiti formatin e raportimit ditor. Gjatë periudhës qershor - tetor, u testua dhe u vu në përdorim, raportimi i aktivitetit ditor përmes një platforme on-line, në google form.

Praktikat studentore

Me dëshirën e mirë për të mundësuar realizimin e praktikave studentore për studentë në prag diplomimi, të cilët kanë nevojë të marrin disa aftësi praktike e të krijojnë një përvojë pune që t'u shërbejë më pas, FSHZH shpalli programin e praktikave të punës në muajin maj. Pas procesit të aplikimit dhe vlerësimit të kandidatëve nëpërmjet shqyrtimit të dokumentave dhe intervistave individuale, 15 studentë zhvilluan praktikën tremujore pranë FSHZH.

Përmirësimi i procedurave institucionale

Në këtë kuadër po shqyrtohen dhe ripunohen nga Njësia e Burimeve Njerëzore:

- Procedurat e Njesisë së Burimeve Njerëzore;
- Kodi i etikës;

Krijimi i një ambjenti social dhe solidar

- NJBNJ në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar që është organizata që nxit organizimin e dhurimit të gjakut për personat në nevojë, si dhe me gjithë stafin e FSHZH ka organizuar më datë 17 tetor 2019 aktivitetin “Të dhurojmë gjak falas” si alternativë e plotësimit të nevojave për gjak në Shqipëri. 21 punonjës të FSHZH dhuruan për fëmijët talamesikë.
- Në kuadër të rritjes së frymës së bashkëpunimit në grup si dhe vizibilitetit të institucionit, NJBNJ organizoi një ekip brenda FSHZH për të marrë pjesë në kampionatin e Ligës Amatore të Volejbollit të organizuar nga FSHV, ku u licensuan 14 lojtarë.

9.6 Misione të donatorëve

- **Misione të Bankës Bankës Botërore në kuadër të Programit për Zhvillimin e Integruar Urban dhe Turizmin**

Gjate vitit 2019, jane zhvilluar 2 misione te Bankes Boterore.

Misionet u zhvilluan në 23 Prill - 3 Maj dhe 4 Nëntor - 15 Nëntor 2019. Objektiv i kryesor i këtyre misioni ishte:

- ecuria e zbatimit të nënprojekteve fast-track;
- diskutim mbi përgatitjen e investimeve për vitet 2-5, përfshirë zbatimin e konsulencave;
- prokurimi, menaxhimi financiar, disbursimi dhe masat mbrojtëse;
- diskutimi i problematikave të dalta pas prishjes së ndërtimeve në Syrin e Kaltër;
- propozimi për financim shtesë të projektit, përfshirë vizitë në terren në site turistike me potencial turistik;
- Ecuria e konsulencave për projektimin dhe mbikqyrjen e Zhvillimit të Integruar Urban për qytetet e Beratit, Permetit, dhe Sarandës
- Ecuria e konsulencës për sitet turistike të Zvernec / Benjes
- Diskutime për shtesë financimi për projektin, përfshirë vizitat në terren
- Prokurimi, Menaxhimi Financiar
- Planet e shpronësimeve

Gjatë këtyre misionëve u zhvilluan takime me stafin e FSHZH, bashkitë përfituese dhe aktorë të tjerë në nivel qendror dhe lokal. Njëkohësisht u zhvilluan edhe vizita në terren për të parë nga afër objektet e financuara në kuadër të projektit.

Misioni konstatoi progres në aktivitetet e projektit veçanërisht në komponentin e parë. Progres u konstatua edhe në disa aktivitete të komponenteve 2 dhe 3. Misioni vlerësoi angazhimin e FSHZH në rolin e agjencisë zbatuese të projektit.

- **Mision i Bankës Bankës Botërore në kuadër të Projektit Rrugët Lidhëse Rajonale**

Një mision i Bankës Botërore vizitoi Shqipërinë në 3 - 4 maj 2019. Objektiv i misionit ishte vlerësimi i ecurisë së projektit, statusi i rrugëve të përgjeshura, disbursimet, çështjet mjedisore dhe sociale, mundësia e financimit të rrugëve të tjera në kuadër të zbatimit të projektit, etj. Gjatë këtij misioni u zhvilluan takime me stafin e FSHZH, dhe aktorë të tjerë në nivel qendror dhe lokal. Në fund të këtij misioni u konstatua se në tërësi ecuria e projektit është e kënaqshme, por duhet synuar rritja e nivelit të disbursimeve.

- **Misione të Bankës së Këshillit të Europës (CEB), në kuadër të Programit “Punët në Komunitet IV”**

Dy misione të Bankës së Këshillit të Europës (CEB), vizituan Shqipërinë në Mars dhe Maj 2019. Objektiv i kryesor i këtyre misioni ishte vlerësimi i ecurisë së projektit, planit të aktiviteteve, dhe një sërë çështjesh të tjera të lidhura me zbatimin e tij.

Gjatë këtyre misionëve u zhvilluan takime me stafin e FSHZH, bashkitë përfituese dhe aktorë të tjerë në nivel qendror dhe lokal. Njëkohësisht u zhvilluan edhe vizita në terren për të parë nga afër objektet e financuara në kuadër të projektit.

Në fund të këtij misioni u konstatua se projekti ka realizuar objektivat dhe detyrat e caktuara deri në këtë fazë të projektit.

- **Misione të KfW në kuadër të Programit “Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale III”**

Gjatë muajit Prill 2019, një mision i KfW-së, mori pjesë në ceremoninë e inagurimit të punimeve civile për LOT I në Rrajcë, (Prrenjas), ku ishin të pranishëm edhe përfaqësues të Qeverisë Shqiptare, Ambasadës Gjermane, Delegacionit të BE në Shqipëri, FSHZH dhe përfaqësues të qeverisjes lokale.

Ndërkohë nga data 10-13 shtator një mision i KfW-së për auditimin vjetor të Programit FUZR III, vizitoi Shqipërinë. Pjesë e kësaj vizite kanë qënë inspektimet në terren të punimeve në Lotin 4.

10. AKTIVITETE TE TJERA

10.1 Agjencia Ekonomike Mbështetëse

Agjencia Ekonomike Mbështetëse, një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar (SH.P.K), me ortak të vetëm FSHZH, operon prej korrikut të vitit 2018 si agjent ekonomik për FSHZH-në.

Misioni i Agjencisë është të jetë një aktor aktiv me interes publik në mjedisin e biznesit që nëpërmjet ndërhyrjeve të drejtpërdrejta financiare apo në partneritet me sipërmarrje publike apo private, vendase apo të huaja të nxisë zhvillimin ekonomik në nivel lokal, rajonal dhe qendror.

Funksionet e agjencisë:

- Menaxhon dhe operon investimet e kryera nga FSHZH në marrëveshje me përfituesin për të siguruar funksionimin dhe qëndrueshmërinë e tyre afatgjatë;
- Investon, përmes formave të ndryshme të partneritetit, në asete publike apo private, ndërmarrje tregtare publike dhe në sipërmarrje biznesi private, në shërbim të interesit publik me synim zhvillimin ekonomik në nivel lokal dhe rajonal;
- Vepron si agjent ekonomik për asetet publike të transferuara tek FSHZH nga Qeveria Shqiptare;

Fusha e veprimtarisë ekonomike të AEM-së mbulon kryesisht:

- Investimin dhe menaxhimin e aktiviteteve ekonomike në fushën e turizmit, kulturës, shërbimeve me interes publik, teknologjisë së informacionit, bujqësisë, energjisë së rinovueshme, aktivitet tregtar, import-eksport etj;
- Projektim, ndërtim, blerja, shitje, dhënia me qera, nën qera e pasurive të paluajtshme, duke respektuar dispozitat e ligjit në fuqi;
- Shoqëria mundet të realizojë çdo lloj operacioni financiar apo tregtar që lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda limiteve të parashikuara nga legjislati në fuqi;

Aktiviteti i agjencisë 2019

Gjatë vitit 2019, Agjencia Ekonomike Mbështetëse fokusoi aktivitetin e saj në dy drejtime, organizimi i brendshëm, krijimi i strukturave, procedurave dhe burimeve njerëzore dhe së dyti në identifikimin dhe zbatimin e sipërmarrjeve ekonomike që do të garantojnë qëndrueshmërinë financiare në fazën e fillimit të aktivitetit.

Aktivitetet kryesore kanë qënë:

- Zbatimi i marrëveshjes me Qendrën Spitalore Universitare për kalimin në administrim dhe funksionimin e parkimit;
- Ndjekja e zbatimit të punimeve për Ngritjen dhe Menaxhimin e Qendrës së Turizmit Valbonë (2019);
- Ndjekja e zbatimit të punimeve për Ngritjen dhe Menaxhimin e Qendrës së Turizmit Vermosh (2019);
- Kalimin e zyrave të shoqërisë AEM shpk dhe të njësisë rajonale të Zhvillimit Tiranë në godinën e qendrës multifunksionale të shërbimeve për sipërmarrjet e reja;

Zbatimi i marrëveshjes me QSUT dhe kalimi në administrim dhe funksionimit i parkimit brenda territorit

Gjatë kësaj periudhe janë kryer punime për “Përmirësimin e Sinjalistikës Horizontale dhe Vertikale”, brenda territorit të QSUT. Janë vendosur tabela rrugore, janë rifreskuar vijëzimet rrugore dhe janë lyer të gjitha bordurat e trotuareve. Gjithashtu janë kryer edhe punime riparimi të ndryshme për të përmirësuar aksesin e mjeteve dhe këmbësorëve brenda territorit të QSUT.

Bazuar në planin e veprimit të dakordësuar midis AEM shpk dhe QSUT për vitin 2019, duke filluar nga muaji Prill 2019 nisi të aplikohet tarifa e përshkallëzuar e parkimit, që kishte si qëllim disiplinimin e territorit, dekurajimin e qarkullimit të mjeteve në QSUT, sidomos të bizneseve në afërsi të objektit dhe banorëve përreth, por në të njëjtën kohë edhe rritjen e të ardhurave.

Sistemi i ri tarifor dha efekte duke pakësuar qarkullimin, rreth 200 mjete më pak në ditë si dhe duke rritur të ardhurat me rreth 13-15%.

Gjithashtu janë realizuar dy investime të rëndësishme për ecurinë dhe qëndrueshmërinë e këtij aktiviteti: sistemi i ri i parkimit, pasi pajisjet ekzistuese kanë qënë të marra me qera nga operatori i mëparshëm, dhe studimi i fizibilitetit si fazë e parë e masterplanit të QSUT.

Ndjekja e zbatimit të punimeve për Ngritjen dhe Menaxhimin e Qendrës së Turizmit Valbonë (2019)

Bazuar në Vendimin Nr 8, datë 10.12.2018 për “Miratimin e Buxhetit për Vitin 2019” të Asamblesë së AEM dhe FSHZH, Agjencia Ekonomike Mbështetëse, ka monitoruar zbatimin e kontratës për objektin “Qendra e Zhvillimit të Turizmit në Valbonë”, me qëllim përdorimin dhe menaxhimin e kësaj qendre pas përfundimit.

AEM ka monitoruar ecurinë e punimeve duke bërë komente dhe sugjeruar ndryshime projekti për të qënë sa më afër “Planit të Menaxhimit të Destinacionit Valbonë”, plan ky i hartuar nga konsulentë ndërkombëtarë.

Qendra e Zhvillimit të Turizmit në Valbonë, në planin e biznesit të saj, është cilësuar si një inkubator i turizmit shumëfunksional, prandaj sugjerimet kanë qënë të karakterit arkitekturor dhe funksional dhe kanë për qëllim riorganizimin e ambienteve të brendshme të objekteve të shërbimit dhe arredimin e tyre si nga ana funksionale ashtu dhe me cilësinë e paisjeve duke ju përshtatur funksionit.

Për realizimin e këtij objekti, AEM ka kryer 10 inspektime në objekt, të shoqëruara edhe me raporte përkatëse monitorimi, projekt-ide për ndarje funksionale dhe relacione të ndryshme.

Paralelisht AEM ka investuar në ngritjen e kapaciteteve dhe formimit profesional të stafit për sa i përket produktit turistik dhe menaxhimit të destinacionit duke u bërë pjesë e aktiviteteve ndërkombëtare për promovimin e produktit VIA DINARICA mbi konsolidimin e strukturave strategjike rajonale, si dhe trajnimin nga IPP mbi Alpet Shqiptare.

Ndjekja e fillimit të punës për Ngritjen dhe Menaxhimin e Qendrës së Turizmit Vermosh (2019)

Me të njëjtën praktikë sikurse u monitorua “Qendra e Zhvillimit të Turizmit Valbonë”, po monitorohet edhe zbatimi i kontratës për “Qendrën e Akomodimit Rural në Vermosh”.

Objektivi kryesor i AEM në misionet e monitorimit ka qënë ai i të parit të zbatimit të kontratave të punimeve në sinkron me qëllimet e përcaktuara nga planet e menaxhimit të hartuara nga konsulentët dhe bazuar në to ka bërë pranë FSHZH raporte dhe propozime. Edhe për këtë objekt janë kryer inspektime paraprake në terren.

Marrja në përdorim të Qendrës Multifunkionale Betahaus

Me vendimin nr 75. Datë 04.12.2019 të Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH), “Për kalimin e zyrave të shoqërisë AEM sh.p.k. dhe të Njesisë Rajonale të Zhvillimit Tiranë në Godinën e Qendrës Multifunkionale të Shërbimeve për Sipërmarrjet e Reja”, u vendos transferimi i zyrave të Shoqërisë AEM në këtë godinë.

Nisur nga përvoja një vjeçare në menaxhimin e suksesshëm të hapësirës publike të QSUT “Nënë Tereza”, si dhe pas një analize biznesi të kryer, AEM propozoi të marrë nën përgjegjësi menaxhimi dhe administrimi Qendrën “Betahaus Tirana”. Ndërhyrja kishte si qëllim administrimin me rentabilitet të hapësirës funksionale të QMF, rehabilitimin e sipërfaqes dhe mbikqyrjen e kësaj qendre. Njëkohësisht kjo mund të ndihmojë në gjenerimin e të ardhurave alternative dhe përdorimin për zyra për agjencinë në funksion edhe të minimizimit të kostove të qerave në ushtrimin e aktivitetit.

Vendimi për transferimin e zyrave u mor në mënyrë të menjëhershme nga FSHZH, si pasojë edhe e tërmetit të shkaktuar më datë 26 nëntor 2019. Riparimi i dëmeve në këto ambiente kërkonte shpenzime të paparashikuara, të cilat paraqisnin një kosto financiare shtesë për AEM në një pronë jo të sajën. Vendimi për transferimin e aktivitetit të AEM pati një efekt pozitiv financiar, duke përjashtuar pagesën e qerasë dhe kostot për riparimet e dëmeve në ambientet e marra me qera.

AEM brenda një kohe të shkurtër arriti të kryejë transferimin e aktivitetit të saj në ambientet e kësaj qendre, duke marrë të gjitha masat e nevojshme për përshtatjen e ambienteve në zyra për stafin, sistemimin dhe rehabilitimin e territorit të jashtëm.